



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË
KOSOVËS, E MBAJTUR MË 23 PRILL 2014 (Ora 10:00)**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 23. APRILA 2014. GODINE (10:00 sati)**

**PRILL - APRIL
2014**

Rendi i ditës

1. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes ndërkombëtare ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian mbi Misionin e Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë dhe
2. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që ndërlidhen me mandatin e Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Republikën e Kosovës.

Dnevni red

1. Razmatranje Nacrta zakona o ratifikaciji Međunarodnog sporazuma između Republike Kosova i Evropske unije o Misiji Evropske unije za vladavinu prava na Kosovu, i
2. Prvo razmatranje Nacrta zakona o izmeni i dopuni zakona koji se nadovezuju sa mandatom Misije Evropske unije za vladavinu prava u Republici Kosova.

Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, z. Jakup Krasniqi.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,
I nderuar kryeministër,
Zëvendëskryeministra,
Ministra të Kabinetit qeveritar,
Të nderuar ambasadorë e diplomatë,
Mysafirë të nderuar,
I hap punimet e mbledhjes plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, sipas rendit të ditës, të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare.

Të nderuar deputetë,
Ju njoftoj se në ndërkohë, më 22 prill 2014, Qeveria e ka proceduar në Kuvend edhe Projektligjin për ratifikimin e marrëveshjes ndërkombëtare ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian mbi Misionin e Bashkimit Evropian për sundimin e ligjit në Kosovë.

Andaj, në pajtim me marrëveshjen e arritur të mbledhjes së Kryesisë së Kuvendit me kryetarët e grupeve parlamentare, të mbajtur më 18 prill 2014, propozoj që të radhitet për shqyrtim në seancën e sotme plenare si pikë e parë e rendit të ditës.

Para se të fillojmë me shqyrtimin e pikave të rendit të ditës, Kuvendi duhet të deklarohet për shmangie nga Rregullorja e Kuvendit.

Fjalën e ka kërkuar deputeti Behar Selimi.

BEHAR SELIMI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Kryeministër,
Kabinet qeveritar,
Të nderuar kolegë deputetë dhe deputete,
Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, në bazë të nenit 84 të Rregullores së Kuvendit, i paraqet Kuvendit për miratim këtë propozim-vendim për shmangie nga Rregullorja e Kuvendit për shqyrtimin dhe miratimin e Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që ndërlidhen me mandatin e Misionit të Bashkimit Evropian për sundimin e ligjit në Republikën e Kosovës, si në vijim:

1. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që ndërlidhen me mandatin e Misionit të Bashkimit Evropian për sundimin e ligjit në Republikën e Kosovës, të bëhet në seancën plenare më 23 prill 2014.

2. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që ndërlidhen me mandatin e Misionit të Bashkimit Evropian për sundimin e ligjit në Republikën e Kosovës bëhet nga Komisioni për Legjislacion menjëherë pas miratimit në parim në seancën plenare, më 23 prill 2014.

3. Shqyrtimi i dytë dhe miratimi i Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që ndërlidhen me mandatin e Misionit të Bashkimit Evropian për sundimin e ligjit në Republikën e Kosovës do të bëhet në seancën plenare të pasdites, më 23 prill 2014.

Faleminderit, kryetar!

KRYETARI: Në emër të Lidhjes Demokratike, e do dikush fjalën? Atëherë shkojmë në votim. Urdhëro! Ne e kemi për shmangie. Mirë, atëherë vazhdojmë. Deputeti Arsim Bajrami e ka fjalën.

ARSIM BAJRAMI: Faleminderit, kryetar!

Propozoj në emër të Grupit Parlamentar që krahas votimit për shmangie në këtë proces të shmangies të përfshihet edhe propozimi i Grupit Parlamentar, me të cilin ne kërkojmë nga Qeveria e Republikës së Kosovës që në seancën e sotme, d.m.th. në këtë seancë t'i propozojë Kuvendit ligjin për krijimin e një fondi të veçantë shtetërorë me të cilin do të ofrohet mbrojtja juridike dhe mbrojtja materiale për të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës, të cilët do të përfshihen nga juridiksioni në gjykatën speciale, si dhe për të gjitha rastet tjera që kanë të bëjnë me mbrojtjen e luftës së drejtë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Ne vlerësojmë se një ligj i tillë duhet të propozohet nga Qeveria në seancën e sotme dhe kërkojmë mirëkuptimin e të gjitha grupeve parlamentare që të lejojnë shmangien - diskutimin edhe në leximin e dytë, në mënyrë që mbrojtja juridike e të gjithë personave të bëhet nga një fond shtetëror, sepse me këto procese nuk po mbrohen individët, por mbrohet lufta e drejtë e Ushtrisë Çlirimtare e Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Kryetari i Grupit të “Vetëvendosjes”, deputeti Visar Ymeri e ka fjalën.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryetar!

Desha t'i ngre disa çështje. Së pari mendoj që nuk duhet të thuhet që ka pasur marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare, sepse ka pasur edhe kundërshtim në mbledhjen e Kryesisë dhe kjo duhet të theksohet që nuk kanë qenë të gjithë kryetarët e grupeve dakord për shmangie të procedurave.

Çështja e dytë është se mendoj që këto çështje kaq të ndjeshme dhe të rëndësishme për Kosovën nuk bën në asnjë mënyrë të kalojnë me kaq pak debat, siç po propozohet këtu, pra që t'i shmangim procedurat për të gjitha këto çështje, aq më tepër kur e dimë që për shumicën prej tyre nuk kemi kurrfarë materiali, ose materiali i cili na është dorëzuar është jashtëzakonisht i varfër në informata, në mënyrë që deputetët ta kenë mundësinë të vendosin për një çështje me votën e tyre.

Dhe, e treta është që Lëvizja “Vetëvendosje” e ka propozuar një rezolutë të cilën insistoј që të futet në votim, gjithashtu. Është e protokolluar dhe kjo duhet të votohet për shkak se ka të bëjë me pikat për të cilat po flasim.

KRYETARI: Ne po bëjmë shmangie për shkak të kohës të afateve që duhet të respektohen. Për këtë është shmangia. Shmangia nuk po bëhet për t'ia ndalë debatin askujt.

Edhe kërkesa juaj mund të hyjë me shmangie. Do të thotë, ju e keni bërë rezolutën që e keni protokolluar. Po, edhe kjo shkon me shmangie, por një herë ta përfundojmë debatin për këtë çështje.

Fjalën e ka deputeti Hydajet Hyseni.

HYDAJET HYSENI: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Unë dua ta kontestoj propozimin për aplikimin e instrumentit problematik në praktikën tonë dhe asnjëherë të trajtuar drejt të shmangies nga procedurat parlamentare.

Shmangia nga procedurat parlamentare në parlamentet demokratike është e mundësuar, por është e precizuar në cilat rrethana. Në rrethana të jashtëzakonshme të krijuara ndërkohë dhe sidomos në rastet kur në Parlament ka konsensus për çështjen që kërkohet të kalohet me procedurë të shpejtuar, ose të thjeshtuar.

Te ne shmangia nga procedurat parlamentare praktikisht është kthyer në suspendim të procedurave parlamentare. Madje, në suspendim total të procedurave parlamentare dhe kjo është difektoze, ka filluar kështu dhe po mbaron kështu. Nuk do të ishte mirë t'i lihet kjo praktikë edhe legjislaturës së ardhshme. Nuk shoh asnjë arsye që çështjet që kemi sot të trajtohen me procedurë pa procedurë, me procedurë të përsheptuar, duke i shkelur afatet, duke pamundësuar debatin dhe qasjen kreative në këtë çështje.

Po vijmë në një situatë, ose të votojmë për diçka për të cilën s'pajtohemi, dhe shumica nuk pajtohen, zonja dhe zotërinj, ose të kundërshtojnë diçka që ka brenda, të cilën nuk duam ta kundërshtojmë. Me debat dhe qasje proaktive mund t'i korrigjojmë këto.

Prandaj, edhe propozimi im është të mos ngutemi. Çështja që është shtruar ka katër muaj, madje katër vjet që pret. Nuk ka asgjë emergjente, nuk ka asnjë arsye që kjo të trajtohet në këtë procedurë. Për më tepër, ka grupe parlamentare që e kanë kërkuar një qasje tjetër. Suspendimi i procedurave është suspendim i parlamentarizmit, është suspendim i demokracisë. Këtë nuk ka të drejtë ta bëjë askush. Nuk kemi të drejtë ta bëjmë as ne, zonja e zotërinj deputetë.

Prandaj, propozoj që le ta trajtojmë në procedurë të rregullt parlamentare, le të mundësojmë që të veçojmë në çka pajtohemi, në çka nuk pajtohemi dhe të synojmë ta gjejmë konsensusin. Unë besoj në funksion të synimit të përbashkët që kemi edhe ne këtu, edhe me partnerët tanë ndërkombëtarë, për tejkalimin e situatës dhe avancimin e demokracisë dhe proceseve në Kosovë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Ne po procedojmë sipas Rregullores. Rregullorja e parasheh shmangien me votat e 2/3 të deputetëve të pranishëm. Nëse 2/3 e deputetëve të pranishëm janë të gatshëm për shmangie, unë nuk jam kundër. Do të thotë, vendimi është i deputetëve, nuk është imi. Detyrë dhe obligim imi është ta respektoj Rregulloren e Kuvendit.

Fjalën e ka kërkuar deputeti Sasha Gjokiq.

SAŠA ĐOKIĆ: Hvala gospodine predsjedavajući!

Želim da istaknem da vi vrlo perfidno želite da provucite nešto što nije apsolutno po zakonu.

Mi danas ovde imamo pred nama, što nam je dostavljeno 18.-og, Zakon o ratifikaciji. Mi ne možemo da kršimo Poslovnik i da vi mimo jednog kršenje Poslovnika ubacujete još neke tačke. Znači to apsolutno ne postoji u Zakonu Republike Kosova.

Tako da ja tražim od vas da budete vrlo precizni i prevod da bude precizan, da mi mogli da razumemo o čemo glasamo. Znači ovde mi glasamo Zakon, a ne ratifikaciju. Procedura zakona je jasna. Ne možemo mi ad-hoc da usvojimo zakon, mora da ide u redovnom proceduru.

KRYETARI: Fjalën e ka kryetari i Grupit të Lidhjes Demokratike, Ismet Beqiri.

ISMET BEQIRI: Kryetar, unë veç do të doja kur ju do ta hidhni në votim, ta hidhni në votim atë që e kemi në rend të ditës, dhe të jemi të qartë për shmangie. E bëjmë për pikat dhe për materialet që i kemi në rend të ditës sot. Kaq!

KRYETARI: Ne shmangien e bëjmë për pikat e rendit të ditës që i keni përpara, për pikën e parë dhe për pikën e dytë, të cilat i lexoj deputeti Behar Selimi, të tjerat mund të hyjnë edhe Zakon në mbledhjet tjera dhe nuk konsideroj se janë të ngutshme.

Adem Grabovci e ka fjalën.

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, kryetar!

Mendoj dhe vlerësoj, në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, se propozimi i zotit Bajrami është në përputhje të plotë me pikën e parë të rendit të ditës.

Ne e kemi një pikë të rendit të ditës, me dëshirë a pa dëshirë, nuk dua të komentoj fare, por kemi të bëjmë me formimin e një gjykate, që ka të bëjë me njerëz dhe ne, asnjëri prej këtyre njerëzve që janë akuzuar deri më sot, por edhe sot, nuk kanë të bëjnë me veten e tyre, por kanë të bëjnë me mbrojtjen e pastërtisë së luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, dhe ne nuk po kërkojmë as më shumë e as më pak, por shteti ynë ka të drejtë dhe obligim që t'u garantojë mbrojtje ligjore këtyre njerëzve dhe kurrësi këta njerëz nuk kanë mundësi financiare ta sigurojnë mbrojtjen, t'i shtyjme të bëjnë gabime.

Prandaj, për hir të kësaj, ne kemi kërkuar dhe kërkojmë nga deputetët që të mbështetet propozimi i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës që ky ligj të kalojë dhe ta obligojmë Qeverinë e Republikës së Kosovës që t'i marrë mbi vete të gjitha shpenzimet për mbrojtje ligjore. Nuk po kërkojmë diçka tjetër, por mbrojtjen e të gjithë të akuzuarve.

KRYETARI: Ne për dy pikat, që duhet t'i shmangemi Rregullores, e kemi materialin. Për këtë që po thua zoti Adem Grabovci, ne nuk kemi kurrfarë materiali, përveç fjalëve. Ne fjalë nuk mund të vëmë në rend dite. Prandaj, ju lutem! Silleni ligjin, pa ligj ne nuk mund të administrojmë fjalë në Kuvend. Urdhëro kryeministër, e ke fjalën!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Sa i përket materialit, i nderuar kryetar, të nderuar deputetë, Qeveria veç e ka të përgatitur Projektligjin, të cilin, nëse ju pajtoheni, mund ta sjellim për pak minuta, nëse jo mund të nxirret rezolutë, që është e përgatitur gjithashtu. Mund ta lexojë profesori.

KRYETARI: Unë mendoj që ligji mund të vijë edhe pas kësaj seance dhe kur të vijë, ne merremi ligjin. Në anën tjetër, konsideroj që rezoluta nuk bën kurrfarë zgjidhjeje. Ne kemi plot rezoluta që nuk jemi duke i respektuar. E kemi një rezolutë edhe për këtë që ne po flasim sot, por edhe ajo nuk është në rend dite. Prandaj, nëse duam vërtet ta bëjmë një punë dhe ajo të jetë e qëndrueshme, këtu Kuvendi mund ta nxjerrë një ligj që e sjell Qeveria, ose Qeveria ta zgjedhë këtë çështje me vendim të veçantë. Kështu janë mundësitë, por tani për tani nuk kemi asgjë të shkruar në këtë drejtim.

Ardian Gjini, kryetar i Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, e ka fjalën.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryetar!

Mendoj se ne duhet fillimisht që të votojmë për shmangie për atë që na ka ardhur edhe në letër, mirëpo procedurat për shmangie nuk precizojnë se a mund të hyjë diçka në rend dite edhe sot, nëse e propozojnë grupet parlamentare. Do të thotë, kur hyjmë në shmangie, atëherë nuk e kemi ndonjë problem.

Unë mendoj se, nëse grupet parlamentare e kanë të rëndësishme që të shkojnë në këtë mënyrë, ne mund të shkojmë. Do të votoj Kuvendi se çka duam të bëjmë sot, por nuk ka ndonjë procedurë që e parasheh se për çka bën të ketë shmangie e çka jo, kur vetëm hyjmë në shmangie. Tani propozimi im është që ne të votojmë fillimisht për shmangie për dy pikat të cilat i kemi para vetes, pastaj mendoj se nëse ka mocion për shmangie, duhet të votojmë për shmangie edhe për dy pikat tjera. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Konsideroj që sipas regjistrimit elektronik, në sallë janë të pranishëm 112 deputetë. Gjithashtu edhe sipas pranisë fizike është një më shumë, pra 113.

Atëherë shkojmë për shmangien, ose e bëjmë një votim për praninë. Lus regjinë dhe deputetët që të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Dikush është pa kartelë, por megjithatë numri i pranisë fizike është 112. Atëherë shkojmë për shmangien e dy pikave të rendit të ditës. Nëse ka kërkesa tjera mund të vazhdojmë edhe me ato që mund të bëhen të reja.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Konstatoj se me 93 vota për, 18 kundër dhe 1 abstenim, Kuvendi vendosi për shmangien nga Rregullorja e Kuvendit për shqyrtimin dhe miratimin e Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që ndërlidhen me mandatin e Misionit të Bashkimit Evropian për sundimin e ligjit në Republikën e Kosovës.

Vazhdojmë me pikën e parë të rendit të ditës:

1. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes ndërkombëtare ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian mbi Misionin e Bashkimit Evropian për sundimin e ligjit në Kosovë

Projektligji është proceduar nga Qeveria në Kuvend më 22 prill 2014.

E ftoj përfaqësuesin e Qeverisë, kryeministrin zotin Thaçi, në cilësinë e propozuesit, që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe arsyetojë Projektligjin për ratifikimin marrëveshjes ndërkombëtare ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian mbi Misionin e Bashkimit Evropian për sundimin e ligjit në Kosovë. Kryeministër, e ke fjalën!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Faleminderit, i nderuar kryetar Krasniqi!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Mysafirë të nderuar,

Ambasador i Shteteve të Bashkuara të Amerikës,

Ambasadorë të Bashkimit Evropian, të shteteve të rajonit,

I nderuar kryetar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, zoti Mustafa,

I Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, zoti Haradinaj,

Të nderuar të gjithë të pranishëm,

Kabinet qeveritar,

Së pari dua të bëj të qartë se kërkesa e bashkësisë ndërkombëtare ndaj Kosovës për ta themeluar një gjykatë speciale, e cila do ta trajtojë ndonjë akuzë të mundshme, e cila do të mund të rezultojë nga hetimet e task-forcës speciale hetuese, e themeluar nga Bashkimi Evropian për t'i adresuar pretendimet e dala nga raporti i Dik Martit, është padrejtësia dhe fyerja më e madhe që mund t'i bëhet shtetit të Kosovës dhe shoqërisë kosovare.

E them këtë për shumë arsye.

Qytetarët e Kosovës, Ushtria Çlirimtare e Kosovës ka zhvilluar luftë çlirimtare për çlirimin e Kosovës nga okupimi i regjimit të Slobodan Milosheviqit.

Lufta jonë ka qenë e drejtë dhe në përputhje me normat ndërkombëtare të luftës. Pikërisht për shkak të kësaj, ne jemi ndihmuar edhe nga shtetet aleate të NATO-s dhe kemi arritur të fitojmë luftën. Ne nuk kemi bërë luftë pushtuese, por çlirimtare.

Kosova nuk ka qenë dhe nuk është boshti i së keqes në Ballkan. Dihet shumë mirë, dhe ju e dini shumë mirë se si është përgatitur raporti i Dik Martit. Dihet shumë mirë se kush e ka financuar dhe për çfarë arsye është bërë.

Po ashtu është e qartë se lidhur me pretendimet e raportit të Dik Martit janë bërë disa herë hetime ndërkombëtare, të cilat i kanë hedhur poshtë ato pretendime.

Janë zhvilluar edhe gjykime ndaj figurave të shquara të UÇK-së, dhe është dëshmuar pafajësia.

Ne e kemi pranuar formimin e Task-Forcës së Bashkimit Evropian apo SITF-it për të hetuar lidhur me pretendimet e raportit të Dik Martit dhe krejt kjo është bërë nën ombrellën e Bashkimit Evropian, saktësisht të EULEX-it.

Institucionet e Kosovës, konkretisht Qeveria e Republikës së Kosovës ka qenë tërësisht e përjashtuar nga puna e task-forcës.

Tani institucionet e Kosovës janë të ballafaquara me një imponim krejtësisht jo të ndershëm dhe jo të drejtë nga bashkësia ndërkombëtare.

Kërkohej nga ne të nxjerrim ligje të veçanta, bile ta ndërrojmë edhe Kushtetutën e Kosovës, vetëm e vetëm që të mundësojmë krijimin e një gjykate speciale, e cila do të gjykojë ndonjë rast të mundshëm, i cili mund të rezultojë nga hetimi i SITF-it lidhur me pretendimet e Dik Martit.

Është një gjë shumë e vështirë, e cila do të rëndojë në ndërgjegjen tonë derisa të jemi gjallë për secilin nga ne.

Por, ndërgjegjja jonë do të mbetet e njollosur në rast se ne nuk i japim përgjigje adekuate kërkesës së BE-së dhe SHBA-së për themelimin e gjykatës speciale për t'i trajtuar pretendimet për pretendimet e ngritura të raportit të Dik Martit, i miratuar nga Këshilli i Evropës në vitin 2010.

Të nderuar deputetë,

Ne, sa herë kemi qenë së bashku në momente të vështira, si lidhshmëri kosovare, gjithmonë kemi dalë faqebardhë. Kemi ditur ta gjejmë rrugën e duhur për të ecur përpara.

Unë kam besim se përsëri do të jemi në gjendje ta bëjmë të njëjtën rrugë dhe ta marrim vendimin e përbashkët si Parlament i Kosovës.

Dje, Qeveria e Kosovës e ka aprovuar Projektligjin për ratifikimin e kësaj marrëveshjeje.

Besoj se partnerët tanë që i kemi pasur në krah në ditët më të vështira, pra Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimin Evropian, do të jenë përsëri në anën e drejtë, dhe do ta ndihmojnë Kosovën për ta pastruar këtë barrë të madhe që i është vënë në shpinë, krejt padrejtësisht. Në të njëjtën kohë, nuk do të lejojmë rishkrimin e historisë. Nuk do të lejojmë njollosjen e luftës së drejtë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Ne duhet ta ruajmë, deputetë të nderuar, besimin e plotë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe në Bashkimin Evropian sepse jemi zotuar t'i ndajmë të njëjtat vlera humane dhe civilizuese.

Fundja, ne e kemi vetëm një synim, integrimin në Bashkimin Evropian dhe në NATO, dhe miqësinë e përgjeshme me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Kjo nuk ka alternativë.

Për ta arritur këtë objektiv, ne duhet ta kalojmë këtë sfidë të padrejtë të radhës, duhet ta kalojmë bashkërisht. Duhet ta pastrojmë emrin e Kosovës nga pretendimet e bëra të padrejta në raportin e Dik Martit.

Dhe, sot nuk kemi shumë opsione. Në fakt, e kemi vetëm një opsion dhe ai është që të bashkëpunojmë ngushtë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, me Bashkimin Evropian, NATO-n dhe ta formojmë këtë gjykatë speciale, e cila do të jetë nën juridiksionin e Kosovës, dhe një seli do ta ketë në Kosovë dhe një tjetër jashtë Kosovës, ku do të zhvillohen procedura të ndjeshme që ndërlidhen me dëshmitë e dëshmitarëve të mbrojtur.

Ky është opsioni i vetëm, deputetë të nderuar, i cili është shumë i vështirë, por ky opsion na mundëson që gjykata të funksionojë me ligjet e Kosovës dhe në partneritet me Bashkimin Evropian dhe me Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Opsioni i dytë, të nderuar deputetë, qytetarë të Republikës së Kosovës, të cilin nuk duhet as ta marrim në konsiderim fare, është ai që të refuzojmë themelimin e kësaj gjykate.

Refuzimi eventual i themelimit të gjykatës nga Kuvendi i Kosovës, përpos që do të forconte dyshimet se Kosova po pretendon ta pengojë dhe ta fshehë verifikimin e pretendimeve që përmban raporti, kjo do të kishte pasoja tjera të rënda politike për Kosovën në arenën ndërkombëtare.

Një veprim yni i tillë negativ eventual do t'i mundësonte Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara që në mungesë të vetos nga shtetet mike të Kosovës ta miratojë një rezolutë për Kosovën për themelimin e një tribunali ndërkombëtar për Kosovën nën ombrellën e Organizatës së Kombeve të Bashkuara për të gjykuar pretendimet e Dik Martit. Një e tillë do të kishte pasoja historike për Kosovën dhe për imazhin e saj në arenën ndërkombëtare.

Të nderuar deputetë,
Kabinet qeveritar,
Qytetarë të Republikës së Kosovës,
Ju mysafirë të nderuar,

Dua të sqaroj se kritikën paushalle se kërkesa për themelimin e gjykatës speciale është si rrjedhojë e dështimeve eventuale të Qeverisë së Kosovës, apo edhe të sistemit të drejtësisë në Kosovë, janë kritika pa shije, të paqëndrueshme, të padrejta, shumë të ulëta, jo morale dhe krejt me kuptim elektoral prej kujt do që vijnë. Edhe ata që thonë një gjë të tillë, e dinë shumë mirë që kjo nuk është e vërtetë, mirëpo paturpësisht e thonë një gjë të tillë, duke pretenduar ta fitojnë një grusht votash më shumë.

Mirëpo, unë ju them këtu sot të gjithëve se votat nuk mund të fitohen kurrë duke hedhur baltë dhe mohuar punën serioze dhe të guximshme të institucioneve tona shtetërore në veçanti të atyre të drejtësisë.

Votat nuk fitohen duke hedhur baltë mbi bashkëpunimin tonë të ngushtë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Bashkimin Evropian dhe NATO-n. Pikërisht, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Bashkimi Evropian dhe NATO na mundësuan tani edhe vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për formimin e ushtrisë së Kosovës, Forcat e Armatosura të Kosovës.

Qeveria e Kosovës ka marrë këtë vendim dhe Gjykata Kushtetuese ka kthyer rekomandimet e veta, tani neve na takon të marrim vendime për themelimin e ushtrisë, këtij Kuvendi dhe këtij Kuvendi po i mungon kuraja për ta marrë vendimin për themelimin e ushtrisë, Forcat e Armatosura të Kosovës.

I njoh aspektet teknike, procedurale të cilat i kemi përballë, por nuk ka procedurë që duhet ta thyej vullnetin popullit të Kosovës, Qeverisë së Kosovës, institucioneve tona për të themeluar Forcat e Armatosura të Kosovës dhe këtë vendim është duke e pritur edhe populli i Kosovës, por edhe Uashingtoni dhe Brukseli.

Fundja edhe nëse do të ishte diçka të vërteta sa i përket kritika që përmenda më herët, atëherë dihet mirëfilli se drejtësia në Kosovë që nga përfundimi i luftës e deri në ditët e sotme gjithmonë ka qenë përgjegjësi e ndërkombëtarëve. Për më tepër ne kemi kërkuar dhe pranuar që kjo Gjykatë Speciale të themelohet në përputhje me ligjet e Kosovës dhe të funksionojë vetëm në Kosovë dhe e njëjta të jetë e përbërë nga gjykatës dhe prokurorë ndërkombëtar të EULEX-it.

Por, as ky opsion nuk është pranuar në tërësi nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimi Evropian, sepse sipas bindjes së tyre duhet patjetër Gjykata Speciale të ketë një dhomë të saj jashtë Kosovës, ku do të zhvillohen seancat e mundshme të ndjeshme që ndërlidhen me dëshmitarët e mbrojtur.

Kjo është mundësia e vetme që procesi të jetë kredibil dhe që të mos vihet në dyshim nga askush. Vetëm në këtë mënyrë ne mund të lejojmë drejtësinë ta thotë fjalën e vetë dhe përfundimisht të spastrohet kjo njollë e zezë që i është vënë Kosovës padrejtësisht.

Prandaj, ne si lider të Kosovës kemi përgjegjësi institucionale që të marrim vendime të rënda për këtë periudhë. Duhet të marrim një vendim të tillë edhe sot dhe duhet të bëjmë këtë në interes të vendit dhe në interes të gjeneratave të ardhshme dhe kultivimit të

marrëdhënieve të përjetshme me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe ngadhënjimit . të vizionit tonë për të ardhmen evropiane të shtetit tonë.

Lufta jonë për liri ka qenë e drejtë dhe e pastër, dhe është përkrahur nga SHBA-të, Bashkimi Evropian dhe NATO. Elemente të caktuara të komunitetit ndërkombëtar kanë vënë dyshime serioze për ndershmërinë e luftës sonë, ndërsa ne duhet të kemi besim se e drejta është në anën tonë dhe këtë do ta provojë përsëri çdo gjykatë kurdo dhe kudo që të formohet.

Unë ju ftoj, të nderuar deputetë, të gjitha partive politike dhe etnive që jeni sot në Kuvendin e Kosovës që të votojmë pro ratifikimit të kësaj marrëveshje dhe themelimit të Gjykatës Speciale të Kosovës për të trajtuar pretendimet e raportit të Dik Martit të Këshillit të Evropës. Faleminderit!

KRYETARI: Radha tani është e kryetarëve të grupeve parlamentare. Në emër të Partisë Demokratike, fjalën e ka kryetari i Grupit, Adem Grabovci.

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, kryetar!

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës pas të gjitha konsultave të gjata dhe të gjithanshme që janë bërë, kemi ardhur në përfundim se ne së pari besojmë fuqishëm në pastërtinë e luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, si luftë e drejtë, e pastër dhe çlirimtare.

Besojmë fuqishëm në fuqinë argumentuese që do të dëshmojë pastërtinë e luftës sonë, besojmë fuqishëm në gatishmërinë tonë dhe obligimin tonë për të mbrojtur dhe dëshmuar kudoherë dhe kudo dhe para kujtdo që lufta jonë ka qenë luftë e drejtë dhe çlirimtare.

Po ashtu, besojmë fuqishëm tek partnerët tanë, tek Bashkimi Evropian dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës, me të cilët kemi pasur partneritet edhe në kohën e luftës që na kanë dhënë një mbështetje të fuqishme, na japin dhe sot dhe besojmë fuqishëm se do të kemi bashkëpunim dhe partneritet të afërt dhe do të na mundësojnë që vërtet të kemi një drejtësi të drejtë, të paanshme dhe jemi shumë të sigurt se ne do të dëshmojmë pastërtinë e luftës sonë çlirimtare.

Prandaj, Grupi Parlamentar i PDK-së, për këto arsye dhe shumë arsye të tjera, i jep mbështetje dhe e përkrah formimin e kësaj gjykate. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike kryetari i grupit, Ismet Beqiri e ka fjalën.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar ambasadorë, diplomatë,

Kryetar Mustafa,

Kryetar Haradinaj,

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, i vetëdijshëm për rëndësinë e projektligjit të sotëm që e kemi para vetes duke u bazuar në këtë ndjeshmëri dhe seriozitetin e çështjeve që përfshihen në këtë projektligj, ky për ratifikimin e marrëveshjes ndërkombëtare ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian për sundimin e ligjit në Republikën e Kosovës dhe themelimin e Gjykatës Speciale për krimet e pretenduara të luftës dhe pas analizimit të plotë të çështjes së vazhdimin të këtij mandati të EULEX-it dhe themelimit të kësaj gjykate, duke qenë të bindur se lufta jonë e gjithanshme, shumëvjeçare, politike dhe çlirimtare e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ka qenë e drejtë, për të cilën nuk kemi nevojë ta bindim askënd, as brenda dhe as jashtë vendit tonë, sepse qytetarët e Kosovës ishin ata që punuan, sakrifikuan dhe luftuan për lirinë e vendit.

Pra, bashkësia ndërkombëtare e udhëhequr nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe shtetet e Bashkimit Evropian, të bindur me luftën tonë të drejtë dhe për t'i dalë në ndihmë popullit tonë në momentet më vendimtare na ndihmuan dhe arritëm së bashku atë që kishim synim shumëvjeçar, lirinë dhe pavarësinë e vendit.

Jemi plotësisht të vetëdijshëm që opsioni për formimin e një tribunali nga Këshilli i Sigurimit është opsion shumë i keq dhe shumë i dëmshëm për vendin tonë, konsiderojmë me bindje të plotë se Kuvendi i Kosovës duhet të marrë përgjegjësinë mbi vete dhe të votojë për projektligjin në fjalë, gjegjësisht të bëjë ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian.

Andaj, duke u bazuar në të gjitha vlerësimet tona dhe besimin në ata që na dolën në ndihmë në momentet më kritike për popullin tonë, ne jemi përcaktuar që të mbështesim dhe të votojmë për projektligjin në fjalë, pra ratifikimin e marrëveshjes ndërkombëtare dhe po ashtu do të votojmë edhe Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që ndërlidhen me mandatin e misionit të Bashkimit Evropian për sundimin e ligjit në Republikën e Kosovës.

Faleminderit, kryetar!

KRYETARI: Në emër të Grupit Parlamentar “Vetëvendosjes” nënkryetari i Kuvendit, Glauk Konjufca e ka fjalën.

GLAUK KONJUFCA: I nderuar kryetar i Kuvendit! Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Krimet e Serbisë kundër popullit shqiptar të Kosovës jo vetëm gjatë luftës së fundit, por përgjatë gjithë shekullit të kaluar, përbëjnë krimet më çnjerëzore që mund të imagjinohen.

Krimet e Serbisë kundër nesh kishin karakter sistematik, shtetëror dhe gjenocidal. Spastrimi etnik dhe masakrimi i shqiptarëve nuk ishte një aksident historik që ndodhi për shkak të çmendurisë së Milosheviqit. Përkundrazi, vetë Milosheviqi dhe plani që ai e përpiloi dhe e ekzekutoi ishte mishërim i një ideologjie të trupëzuar në frymën shtetërore

serbe, të manifestuar në formën e saj institucionale si historiografi, akademi, kishë, administratë, ushtri, politikë dhe qeveri.

Të gjithëve na kujtohet kur në fillim të viteve të '90-ta miliona serb nëpër sheshet e Beogradit i kërkonin me ngul diktatorit dhe kryekriminelit Milosheviq që t'i pushtonte territoret e Kroacisë dhe të Bosnjës nëpër të cilat jetonte një pjesë e popullatës serbe.

Prandaj, Milosheviqi ishte mekanizëm i vullnetit kolektiv serb që përsëritet vazhdimisht prej Garashaninit, nëpërmjet Pashiqit e Çubriloviqit deri te Milosheviqi, kurse sot e qeverisë Serbinë trashëgimia e moderuar e Slobodan Milosheviqit.

Për të gjitha krimet e saj monstruoze ndaj shqiptarëve, Serbia si shtet as për së afërmi nuk e ka marrë ndëshkimin e merituar. Përkundrazi, pas tetorit të vitit 2000, kur u rrëzua Milosheviqi Serbia u rehabilitua shumë shpejt dhe lehtësisht. Qasja e Tribunalit të Hagës ishte ndëshkim individual i një grupi udhëheqësish nga Serbia, por mbi të gjitha balancim i shpërndarjes së dënimeve mes shqiptarëve dhe serbëve.

Është fatkeqësi që në Hagë nuk u ndëshkuan strukturat institucionale shtetërore të Serbisë dhe nuk u ndëshkua SPS-i si i tillë, një parti e cila ishte bartëse e tërë kësaj politike që rezultoi me shpërbërje, me gjakderdhje shumë të mëdha dhe me gjenocid të paparë që nga Lufta e Dytë Botërore.

Nëpër luftëra të ish- Jugosllavisë shkaktuar nga Serbia, ushtarët, policët dhe paramilitarët serbë vranë mbi 150 mijë njerëz, në Kroaci, në Bosnje dhe në fund në Kosovë.

Shumica e të vrarëve mbi 90% prej tyre janë civil të pafajshëm: gra, pleq dhe fëmijë. Serbia nëpër luftëra i kishte 80 mijë ushtarë, policë dhe paramilitarë. Ta zëmë se vetëm çdo i katërti prej tyre ka qenë i përfshirë nëpër krime dhe nëse është kështu përafërsisht atëherë në Serbi keni 20 mijë kriminelë të luftës, të cilët janë të pandëshkuar dhe të lirë. Bile këta njerëz janë edhe qytetarë të lirë të Bashkimit Evropian, sepse prej vitit 2009 Serbia e gëzon përkundër nesh edhe liberalizimin e vizave.

Institucionet e Kosovës, qeveritë e deritashme të Kosovë kanë pasur material që për çdo javë prej vitit '99 të dorëzojnë nëpër gjyqet ndërkombëtare nga një padi kundër Serbisë për plagët që ajo na i shkaktoi, të cilat kurrë nuk do t'i harrojmë dhe disa prej të cilave janë ende të hapura.

Përderisa Kosovës dhe UÇK-së po i dedikohet një gjykatë speciale për krimet e supozuara, në Serbi po zhvarrosen trupat e 300 shqiptarëve të mbuluar me asfalt. Prej vitit '99 Serbisë është dashur që institucionet tona t'ia përgatisin së paku 150 mijë padi, 12 mijë padi për vrasjen e qytetarëve të pafajshëm të Republikës së Kosovës, 20 mijë padi për përdhunime seksuale, 120 mijë padi për shkatërrimin e pronave dhe të shtëpive të shqiptarëve, si dhe mijëra padi për maltretime, si dhe për krime ekonomike që i ka kryer Serbia në Kosovë.

Pikërisht, pse institucionet tona nuk i ngritën këto padi, bashkësia ndërkombëtare e prioritzoi një gjykatë e cila padyshim që për nga objekti që do ta trajtojë paraqet një kërkesë këmbëngulëse dhe të kamotshme të shtetit serb.

Në vend që qeveria jonë të ndiqte rrugën e drejtësisë kundër krimeve të Serbisë, ajo e zgjodhi rrugën e afrimit me Serbinë, rrugën e negociatave e të kompromiseve. Po ta shihje kryeministrin tonë me Daçiqin që të dukej se Kosova dhe Serbia nuk kanë më kurrfarë problemi, të gjitha janë të shkuara dhe në këtë mënyrë Serbia kriminale u rehabilitua nga qeveria jonë, edhe pse një Serbi e cila na kishte shumë borxhe dhe ende na ka.

Në anën tjetër, vlerat e luftës sonë të drejtë çlirimtare u braktisën vazhdimisht. Lufta jonë e UÇK-së nuk njihet institucionalisht dhe me Kushtetutë. Kushtetuta e Republikës së Kosovës nuk e njeh luftën si luftë të kombit shqiptar për liri dhe çlirim, pastaj UÇK-ja u çarmatos dhe u shua.

Prandaj, në fund vetë UÇK-ja është ajo që po gjykohet. Ky mallkim u ndodh vetëm atyre që e harrojnë themelin e lirisë, që e keqpërdorin lirinë për përfitime personale.

Ky është një turp i madh, i cili duhet t'i faturohet mbi të gjitha kësaj qeverie të papërgjegjshme, që na e qiti faqen e zezë edhe si popull edhe si komb. Kjo qeveri e nisi dhe po e përfundon me dy ngjarje tejet të palavdishme.

Në mars të vitit 2011, dy muaj pasi e mori mandatin, i filloi negociatat me Serbinë dhe tash, në prill të vitit 2014 po e përfundon gati këtë mandat të saj, duke u themeluar një gjykatë për krimet e supozuara të pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Ky është një dëmtim shumë i madh i interesit tonë nacional.

Shtrohet pyetja, pse po na vjen tash në këtë moment një gjykatë për Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës? A mos po na vjen një gjykatë e tillë për shkak të insistimit të atyre shteteve që bombarduan Serbinë dhe që e ndihmuan Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës dhe që e njohën më pastaj pavarësinë e Kosovës, të shpallur në shkurt të vitit 2008. Unë nuk mendoj, që një kërkesë e tillë vjen nga këto shtete.

Një kërkesë e tillë vjen drejtpërdrejt nga Serbia. Po, shtrohet pyetja pse të fitojë, pse të ngadhënjë në fund një kërkesë e Serbisë dhe jo kërkesat tona? E, po kështu ndodh kur e keni një qeveri, e cila shumë më shumë është e zënë me “selfije”, se sa me mbrojtjen e interesit shtetëror.

Ne u bëjmë thirrje deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës, që ta kundërshtojnë krijimin e një Gjykate Speciale për krimet e supozuara të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. T'i thuash jo një gjykate të tillë, nuk do të thotë që je kundër hetimit për gjërat të cilat dyshohen se kanë qenë shkelje të ligjeve ndërkombëtare apo shkelje të konventave ndërkombëtare. Ne jemi për hetime dhe ne jemi për gjykime, por këto hetime dhe gjykime për çfarëdo që ka nevojë të realizohen në Kosovë, duhet të realizohen nga Kosova nga sistemi juridik i drejtësisë dhe i brendshëm i Kosovës dhe nga askush tjetër.

Pikërisht për këtë arsye Lëvizja “Vetëvendosje” do ta propozojë një rezolutë alternative, e cila kërkon që së pari të ketë gjykatë për Serbinë dhe për të gjitha rastet e nevojshme, për të cilat ka dyshime të bazuara, të iniciohen hetime dhe nëse ka nevojë edhe gjykime, por nga drejtësia e Republikës së Kosovës.

Kjo rezolutë do të prezantohet nga kryetari i grupit tonë parlamentar dhe do të harmonizohet, nëse ka nevojë, edhe me qëndrimet e grupeve tjera parlamentare.

Ju lusim që ta votoni rezolutën e Lëvizjes “Vetëvendosje” dhe jo letrën e presidentes për themelimin e një Gjykate Speciale për krimet e supozuara të UÇK-së.

KRYETARI: Rezolutën s’keni kërkuar ta futim në rend dite. Fjalën e ka në emër të Grupit të Aleancës, kryetari Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Mysafirë,

Miq,

Zakonisht, kur flasim gjithmonë mendojmë se cila është audienca, kush po na dëgjon dhe kujt po i drejtohem. Sikur audienca sot të ishte vetëm ky Kuvend i Kosovës, me siguri se çdo mendje racionale politike kishte për të menduar shumë thjeshtë, për të thënë: “nëse votojmë për, e bëjmë një gjykatë, e cila na le për të shpëtuar pak fytyrë, nëse votojmë kundër do ta kemi një tribunal ndërkombëtar për krime të luftës dhe atëherë, secili prej nesh do të kishte për të menduar se menjëherë pas atij tribunali do ta kuptonte vetë çfarë gabimi të madh ka bërë, që ka votuar kundër dhe do të përfundonte fjala me kaq. Do të thotë, duhet të votohet “për”, për shkak se dëmi është shumë më i madh, nëse votojmë “kundër”.

Kaq kishte për të përfunduar fjala, po sot audienca nuk është vetëm Kuvendi i Kosovës, sot audienca është populli i Kosovës, para së gjithash, janë të gjitha vendet që përcjellin se çka po ndodh në Kosovë. Disa presin që kemi për të votuar kundër edhe gëzohen, disa presin që kemi për të votuar për dhe lehtësohen pak, se na kanë lënë një rrugë për të shpëtuar pak fytyrën dhe paramendoni, kemi ardhur në pozitë t’u themi “faleminderit për atë çështje”, por ka edhe audienca tjera.

Po, këtu në Kuvend të Kosovës nganjëherë po shkohet në ekstreme të ndryshme. Përderisa, është ekstrem për të thënë që ne nuk kemi hiç faj, është ekstrem për të thënë ose me lënë shije te populli i Kosovës, se Kuvendi sot ka për ta votuar gjykatën edhe nëse nuk e voton nuk bëhet kurrëgjë. Nuk është përgjegjësi politike për të vepruar kështu.

Nuk është absolutisht, nuk ka asnjë minimum të përgjegjësisë politike, për t’i thënë popullit të Kosovës sot, se nëse ky Kuvend e voton kundër kësaj gjykate speciale, atëherë në Kosovë ka për t’u bërë më mirë. Po shpresoj që nuk do të kenë të drejtë ata njerëz.

Sot po flasim për imazh të Kosovës dhe prapë po lehet përshtypja, që imazhi i Kosovës është veç sa për imazh, është një etiketë.

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës dhe popull i Kosovës, imazhi i Kosovës ka ndikim drejtpërdrejt në jetën e qytetarëve të Kosovës, a mund të lëvizin lirshëm, a do të kenë ndonjë investim dhe ndonjë vend të punës, a do të jetojnë më mirë? Imazhi i Kosovës nuk është veç etiketë, imazhi i Kosovës drejtpërdrejt ndikon në jetën e qytetarëve të Kosovës. Dhe tani, jo vetëm imazhi i Kosovës, i cilitdo vend në botë, vendet që kanë imazh të keq, kanë probleme dhe ato probleme transmetohen te populli, zakonisht jo te politikanët, për shkak se ata e gjejnë rrugën e vet.

Tani, si është rrënuar imazhi i Kosovës deri në këtë ditë, unë nuk kam qare pa folur, për shkak se audienca është pak më e gjerë, nuk jemi vetëm ne. Sikur të ishim vetëm ne, mendje racionale, votojmë për dhe shkojmë në shtëpi. Mirëpo, ne kemi probleme këtu. Ne kemi probleme, për shkak se shembull ta marrim, ka deputetë, ministra, zëvendëskryeministra që kanë dalë në televizion, të incizuar “live” të përfshirë në afëra korruptive dhe asnjë prokuror vendor nuk ka guxuar të ngre aktpadinë.

Tani, ne po themi “qysh s’po na beson bota neve, qysh s’po i beson sistemit tonë të drejtësisë?”

A ka ndokush prej jush, që i beson këtij sistemi të drejtësisë? Shembull ta marrim, kisha dashur ta di a i beson ndokush këtij sistemi të drejtësisë, para se ta akuzojmë botën pse ata nuk po na besojnë neve.

Edhe diçka më duhet të them për shkak se audiencë mund të jetë edhe Dik Marti vetë, shembull ta marrim. Që 80 vjet shqiptarët për përzihen prej Kosovës, janë hipur në trena, i kanë lënë familjet, i kanë lënë miqtë, janë depërtuar, i kanë lënë shtëpitë e veta, fqinjët... dhe e kanë gjetur veten diku në Anadoll. Sikur njëfarë “Marrëveshje e Llozanës” si një “Llozanë twiti” vetëm e heshtur. Përzini prej këtu! Janë djegur, unë personalisht kam parë njerëz të djegur, plaka, pleq... ku? Në Luftën e fundit!

Edhe unë duhem t’ i them diçka, shembull ta marrim, e di që dikujt mund t’i duket patetike, më duhet t’i thënë gruas sime në shtëpi diçka, se ia kanë vra babanë ndër sy, i kanë detyrua me e këqyrë. Edhe kurrkush nuk është akuzuar për këtë, shembull ta marrim, nëse audienca sot është zoti Dik Marti.

Janë djegur shtëpitë, janë djegur njerëzit nëpër shtëpitë e tyre dhe ne nuk kemi qysh të mos i themi këto, duke ditur cila është audienca. Dhe, sikur të ishte audienca vetëm Dik Marti, kisha për të folur sikur Glauku, kisha për t’i treguar histori diçka. Por, nuk po mund të mos tregoj hiç histori, se njëfarë historie në Kosovë ekziston.

Gjyqësori jonë, definitivisht po dua të kthehem, nuk e kam pasur në plan të flas për këtë temë të gjyqësorit, se ndoshta është edhe e kotë, se po e dimë çka është tema, po kryeministri më nxiti të them, ka faj edhe këtu zoti kryeministër. Ka faj në Kosovë, se është korruptuar gjyqësori prej politikës, se fillimisht jeni dashur t’ i bëni të mos guxojnë t’ i akuzojnë njerëzit e juaj, më vonë keni përfunduar duke i bërë të mos guxojnë t’ i akuzojnë ata që ju mbajnë pakëz si në njëfarë forme, në borxh, edhe sot e kemi atë punë aktuale.

Edhe prapë po ju them, sikur për këtë raport të Dik Martit, këtë raport të Këshillit të Evropës, fundi i fundit se është zyrtar i atij institucioni, pasi që është votuar, sikur në Kosovë të kishte pasur institucione që i nisin hetimet, sot s'kishte për të na lypur dikush hetime, me siguri, por, nuk e kemi bërë dhe tash jemi para këtij akti të kryer.

Në fund, Grupi Parlamentar i Aleancës beson që është në të mirë të Kosovës ta votojë hapjen e dyerve për krijimin e këtij gjyqi, vetëm për shkak se e din, se nëse nuk e bëjmë, do të krijohet një tribunal ndërkombëtar për krime në Kosovë dhe atëherë dëmi do të jetë shumë më i madh.

Dhe prapë, nuk po flasim këtu për individë, po flasim për atë imazhin e Kosovës, po flasim për një proces tepër të gjatë, i cili do të ndikojë keq në jetën e qytetarëve të Kosovës, jo për ne, për jetën e qytetarëve të Kosovës.

Nëse dikush duhet të marrë pak faj, atëherë mendoj se është vendi këtu të themi, Qeveria e Kosovës duhet të pranojë një pjesë goxha serioze të fajit, nëse mendojmë për të këqyr veç jashtë dhe për t' i fajësuar të tjerët, nuk do të mbërrijmë ta bëjmë as për një centimetër më të mirë këtë shtet tonin. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Grupit Koalicioni për Kosovë të Re, kryetarja Myzejene Selmani e ka fjalën.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit! Përshëndetje për Kabinetin Qeveritar! Përshëndetje për deputetët! Njëkohësisht, përshëndetje për të gjithë mysafirët që janë sot në këtë seancë.

Koalicioni për Kosovë të Re ka shqyrtuar Projektligjin për ratifikimin e Marrëveshjes ndërkombëtare dhe formimin e gjykatës. Në rast se nisemi nga ajo a duhet të formohet kjo gjykatë, atëherë duhet të themi të gjithë, se të gjithë jemi po nga Kosova, këtu që është një sfidë për të gjithë neve si deputetë dhe një sfidë për shtetin e Kosovës, që po përballet me një gjykatë të tillë.

Mirëpo, duke marrë parasysh se Kosova e di që lufta e saj dhe lufta çlirimtare e Kosovës dhe lufta e qytetarëve të Kosovës ka qenë luftë për çlirim, atëherë besoj që edhe Qeveria edhe deputetët dhe gjithë qytetarët e Kosovës duhet të ndihen krenarë, për arsye se lufta jonë tregoi që është përkrahur nga shtetet më të mëdha, apo nga superfuqia më e madhe në botë, nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe vendet e BE-së.

Duke marrë parasysh se këto pretendime të ngritura në Këshillin e Evropës, mund të themi, se prapëseprapë në përfundim do të jemi këta deputetë, ose të tjerë, që do të shihet se lufta çlirimtare e Kosovës ka qenë luftë e pastër dhe nuk duhet të kemi frikë asnjë nga këto pretendime, të cilat në fund do të dalin që kanë qenë pretendime të kota.

Besoj dhe shpresoj shumë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe në shtetet e BE-së, që Kosova do të kalojë këtë test shumë të rëndë dhe do të tregojë që është shtet, shtet i cili vepron në të mirë të qytetarëve të vet, për arsye se duhet të hiqet imazhi i keq i Kosovës.

Dhe, besoj që ky imazh më shumë është nga pretendimet e disa personave, se sa është imazh në realitet.

Koalicioni për Kosovë të Re do t'i japë përkrahje me shpresë që pas këtij gjykimi prapëseprapë, qytetarët e Kosovës do të dalin të pastër dhe lufta e Ushtrisë Çlirimtare dhe e Kosovës do të jetë luftë e pastër. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të SLS-së, nënkryetari Petar Miletiq e ka fjalën.

PETAR MILETIĆ: Gospodine predsjedniče Skupštine,
Predsjedniče Vlade,
Članovi Vlade,
Koleginice i kolege poslanici,
Dragi gosti,
Govoriću u obe tačke dnevnog reda odjednom, obzirom da su povezane i da bih uštedeo vreme.

Najpre želim da objasnim prisustvo mojih kolega poslanika iz srpske zajednice na ovoj plenarnoj sednici. Naši zahtevi, da iniciramo razgovor o rezervisanim mestima za ne većinske zajednice u Parlamentu Kosova zbog kojih smo bili prinudeni da ne učestvujemo u radu plenarnih sednica skupštine i dalje nisu ispunjeni, niti je naša odlučnost u tom insistiranju manja.

Mi smo danas ovde da bih učestvovali u donošenju odluka od fundamentalnog značaja za budućnost društva na Kosovu, odnosa sa Evropskom Unijom i najvažnije, rešavanja bolne i osetljive teme, kao što je suđenje za učinjene zločine na Kosovu.

Naše insistiranje na rezervisanim mestima se nastavlja i prinudeni smo da nakon što Parlament donese odluke po ovim tačkama dnevnog reda nastavimo sa ne učestvovanjem u radu plenarnih sednica Parlamenta.

Imali smo u ovom mandatu važne i osetljive teme, ali danas se posebno oseća teška atmosfera i lično se trudim da nijednom rečju ne izazovem nečija osećanja ili da nekome pružim priliku da nečija osećanja zloupotrebi.

Naš stav je jasan. U potpunosti prihvatamo produženje Misije EULEX-a na Kosovu i donošenje zakona, koji će obezbediti vladavinu zakona.

Sebično bi bilo od predstavnika srpske zajednice, da današnju atmosferu ne razumeju, pogotovu što su međunarodni sudovi spor i bolan proces utvrđivanja pravde a što ne reči i subjektivni osećaj svakog građanina o odmerenim ili neodmerenim kaznama, ono što je iz temelja drmallo našu zajednicu.

Dakle, naša je obaveza kao poslanici nevećinskih zajednica da danas budemo dobronamerni.

Na osnivanje suda ne gledam kao nešto što je upereno protiv Kosova niti protiv Albanaca, pa čak ni protiv OVK-a, već protiv pojedinaca koji su počinili zločine.

Tema osnivanje specijalnog suda za ratne zločine međutim ne daje nikome od nas za pravo, da iza ove, iza osetljivosti situacije ili čak mogućih političkih posledica može ugroziti osnovnu civilizacijsku tekovinu da se za zločine mora suditi i zločin na sudu dokazati.

Svakodnevne su medijske zloupotrebe još ne osnovanog specijalnog suda za ratne zločine na Kosovu. One su tolike da je u drugi plan sklonjen osnovno pitanje – šta je od ovih zastrašujućih optužbi istina i ko je odgovoran.

Nema prosperiteta Kosova ali ni regiona dok se zločini koji opterećuju naše odnose ne individualizuju i prestanu da budu sredstvo manipulacije.

Zločina je na Kosovu bilo i to na sve strane, previše i nepotrebno. Kao što žrtve imaju imena i prezimena tako i oni koji su počinili zločine imaju imena i prezimena.

U ime pomirenja među narodima, ova imena moraju postati javna. Umesto da nas preplove emocije kada naši evropski prijatelji kažu da kosovsko pravosuđe po kriterijumima Evropske unije nije u stanju da se samostalno izbori sa ovim procesima imajući u vidu stanje pravosuđa i težinu optužnica, apelujem da odlučimo mudro i prihvatimo pomoć u zadovoljenju pravde.

Iz svega ovoga moramo izvući dva benefita: da pravda bude zadovoljena što je prioritet i da preventivno delujemo da se zločini više nikada ne ponove.

KRYETARI: Në emër të Grupit Parlamentar “6+”, kryetarja Mufera Shinik e ka fjalën.

MÜFERRA ŞİNİK: Teşekkür ederim sayın başkan,
Sayın başbakan yardımcılarım, bakanlarım, milletvekilleri, tüm ülkelerden gelen saygıdeğer büyükelçiler ve liderlerimiz, hepinizi saygıyla selamlıyorum

“6+” Parlamenter Grubu olarak her zaman Meclis’te Kosova’nın en iyisini, Kosova için en iyi olanı oylamıştır, çünkü her zaman da Meclisin yapıcı unsurudur. Gündem maddesini ve çoğunluğun iradesine saygıdan dolayı “6+” Parlamenter Grubu olarak sürece pozitif katkımızı sunacağız. Ben fırsattan faydalanarak aslında Meclis başkanımдан bekliyorduk, bugün 23 Nisan Kosova Türkleri Milli Bayramı olduğundan dolayı, tüm toplumumuzun 23 Nisan Kosova Türkleri Milli Bayramını kutlar, herkese saygılar sunarım.

Teşekkür ederim.

KRYETARI: Deputeti Faton Topalli e ka fjalën.

FATON TOPALLI: Të nderuar deputetë,

Në janar të vitit 2011, ish-senatori zviceran Dik Marti e paraqiti para Këshillit të Evropës raportin: “Trajtimi jonjerëzor dhe trafikimi i paligjshëm i organeve njerëzore në Kosovë”.

Raporti ngre dy çështje kryesore, trajtimin jo njerëzor, fjala është për të burgosur të supozuar dhe pengë të luftës dhe trafikimin e paligjshëm me organet njerëzore. Akuza drejtohet kryesisht kundër pjesëtarëve të UÇK-së.

Nuk dua të supozoj nëse motivacioni i zoti Martit për këtë hetim buron më shumë nga qëndrimi i tij kundër pavarësisë së Kosovës, apo nga një borxh njerëzor për të vënë para drejtësisë ata që kanë bërë krime.

Ajo që unë di nga historia është që në çdo luftë ka pasur trajtime jo njerëzore nga individë të caktuar dhe kësaj nuk i kanë shpëtuar as kombet më të zhvilluara në botë, por kjo nuk ka ulur imazhin e këtyre kombeve dhe nuk i ka ulur vlerat e luftës që i kanë zhvilluar ushtritë e tyre, nëse luftërat e tyre kanë qenë të drejta.

Nuk kam asnjë hamendje që asnjë krim, i bërë nga kushdo dhe prej cilitdo, pa gjyq dhe jashtë normave ligjore kombëtare dhe ndërkombëtare, duhet të zbardhet, ndërsa dorasit duhet të dënohen.

Ky është borxhi moral që një shoqëri e drejtë dhe humane e ka karshi viktimave të luftës, pavarësisht nëse ato kanë folur shqip, serbisht, turqisht apo një gjuhë tjetër.

Edhe pse ka shumë përpjekje të lihet kjo përshtypje, sot nuk po diskutojmë nëse duhet hetuar rastet e supozuara të keqtrajtimit dhe tregtisë së supozuar me organe njerëzore, sepse kjo është e vetëkuptueshme për çdo genie humane njerëzore.

Sot, në thelb po diskutojmë për faktin nëse Republika e Kosovës ka sistem gjyqësor funksional, nëse ka prokurorë dhe gjyqtarë të pa korruptuar dhe politikanë që nuk ndikojnë në gjyqësor dhe nëse jemi të gatshëm të heqim dorë nga një pjesë e sovranitetit të vendit tonë.

Vendimi për krijimin e Tribunalit për Kosovën vjen si rrjedhim i vlerësimit të miqve tonë evropianë dhe amerikanë se në Kosovë nuk ka sistem gjyqësor të avancuar, se prokurorët dhe gjyqtarët janë në një masë të caktuar të korruptuar dhe se prokuroria dhe gjyqtarët ndikohen dhe shantazhohen nga politika.

Nuk dua të fyej as qenin as ujkun, por fjala popullore: “qeni i keq e sjell ujkun në torishtë”, shpreh më së miri situatën e krijuar rreth tribunalit.

Vendimi për tribunalin vjen rrjedhim i dështimit të politikave të të dy palëve për të ndërtuar sistem gjyqësor që bazohet mbi parimet e drejtësisë.

Në gjithë këtë histori ka disa gjëra që nuk shkojnë.

Çështja e ngritur për themelimin e një Gjykate Speciale vjen 15 vjet pas përfundimit të luftës në Kosovë. Ky vend u administrua për 8 vjet me radhë nga Kombet e Bashkuara, vazhdoi pastaj me EULEX-in. Gjatë kësaj periudhe nuk u ngrit asnjëherë, asnjë akuzë për trafikim me organet njerëzore.

UNMIK-u dhe EULEX-i i kishin të gjitha mundësitë dhe autorizimet të fillonin hetimet, të arrestonin dhe dënonin cilindo qytetar të Kosovës, prej qytetarit më të thjeshtë e deri tek presidenti dhe kryeministri. Nuk e bënë. Atëherë përse duhet të krijohet një Gjykatë Speciale, me 14 vjet vonesë dhe me gjyqtarë ndërkombëtarë kur edhe hetuesit edhe gjyqtarët ndërkombëtarë ishin dhe janë edhe sot në Kosovë?

Nëse në Kosovë janë bërë krime, ato duhet të hetohen, por nga gjyqtarë të Kosovës dhe në kuadër të legjislacionit të vendit. Bashkimi Evropian dhe kushdo tjetër, mund të dërgoj vëzhgues, mund të ndihmoj, por si hetimi ashtu edhe gjykata duhet të jenë në Kosovë dhe të Kosovës.

Të nderuar deputete, të nderuara deputete,
Drejtnesit e të gjitha partive, përjashtuar këtu “Vetëvendosjen”, janë deklaruar se do ta votojnë vendimin për tribunalin me arsyetimin se nëse nuk e votojmë ne, ai do të imponohet nga Këshilli i Sigurimit të Kombeve të Bashkuara.

Që vendimi për tribunalin është i imponuar e pranojnë të gjithë dhe pa përjashtim. Mendoj që nuk ka ndonjë rëndësi të madhe se prej cilës anë vjen imponimi kur ai është imponim. Vetëm për Nazim Bllacën ka rëndësi se cila palë do të hetojë dhe gjykojë, por për shumicën e deputetëve dhe qytetarëve të Kosovës kjo nuk ka ndonjë rëndësi.

Meqë vendimi është i imponuar, atëherë pse duhet ne të luajmë: “lojën e djallit” dhe të bëhemi pjesë vullnetare e lojës së tij.

Nëse ne themi jo dhe çështja i mbetet Kombeve të Bashkuara, të drejtën e vetos nuk e ka vetëm Rusia, e kanë edhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Para se të votoni për tribunalin shpresoj të mos keni harruar se Serbia ka vrarë 13 290 shqiptarë në Kosovë, ka dhunuar 20 400 gra, ka djegur dhe shkatërruar 88 101 shtëpi, 5 kisha katolike dhe 215 xhami. Ndoshta nuk keni harruar që mes te vrarëve janë 1739 gra dhe 1 392 fëmijë, ndërsa 1716 persona nuk janë gjetur akoma.

Megjithatë, Serbia përkundër imazhit të keq që ka, po ecë drejt Bashkimit Evropian.

Nuk e di nëse z. Marti ka pyetur vetveten ndonjëherë, ç’është bërë me organet e 1716 shqiptarëve të pagjetur, a ka dyshuar të jetë bërë tregti edhe me organet e tyre dhe a i ka shkuar mendja të kërkoj themelimin e një Tribunali në Serbi për krimet e bëra në Kosovë. Këtë pyetje zoti Marti mund të mos e ketë shtruar kurrë, por familjet e 13 290 civilëve të vrarë në Kosovë, familjet e 1 716 personave të zhdukurve dhe 20 400 gra të dhunuara në Kosovë, të nderuar deputet, ju do t’ju pyesin çka keni bërë që të ndriçohen krimet që janë ndaj tyre?

Nëse kjo ju duket e drejtë, nëse mendonin që përparësi kanë rastet e supozuara karshi rasteve të dokumentuara, votoni për tribunalin. Vota juaj do të jetë një votë më shumë kundër pavarësisë së Kosovës, një votë më shumë kundër sovranitetit të vendit.

E di që këtu prapa meje, edhe para meje, janë disa që kanë shitur organe, i kanë shitur edhe zemrat, e kanë shitur edhe trurin, e kanë shitur edhe mendjen, por për këtë shitje nuk ka për t'i gjykuar Gjykata Speciale, por ka për t'i gjykuar historia.

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Hydajet Hyseni.

HYDAJET HYSENI: Faleminderit, zoti kryetar!

Të falënderoj posaçërisht për këto mundësi që e krijuat për debat, sepse ka qenë e supozueshme që kur suspendohen procedurat s'ka as debat, dhe po dëshmoni që megjithatë ju përshkon fryma e parlamentarizmit, por druaj që s'kemi krijuar hapësirë të duhur për ta implementuar sa e si duhet.

Zonja e zotërinj deputetë,

Të nderuar ministra e zëvendëskryeministra,

Unë do të dëshiroja që të jem që në fillim i qartë. Jam për drejtësinë, dhe nëse është brenda nesh le të funksionojë. Po drejtësisë.

Por, jam kundër padrejtësisë, dhe nëse ajo na përzihet me drejtësinë, le t'i themi jo padrejtësisë.

Në të vërtetë, në rastin që po e diskutojmë është pikërisht kjo. Dhe, rrezikojmë duke i thënë po të dyjave, të mbështesim edhe padrejtësinë politike historike që po bëhet hapur ndaj një populli, ndaj një lufte dhe ndaj të ardhmes së tij. Po t'i themi jo, rrezikojmë t'i themi edhe asaj që objektivisht nuk e kundërshtojmë, drejtësinë nuk e kundërshtojmë.

Prandaj edhe kërkesa ime ka qenë, le t'i ndajmë, le ta hapim debatin dhe le të jemi pjesë edhe e marrëveshjes edhe e procesit, sepse për ne flet përralla.

Dhe, kjo mendoj është e mundshme. Më lejoni vetëm shkurtimisht ta arsyetoj pse, dhe ta them që në fillim propozimin tim.

Kjo po drejtësisë, do të nënkuptonte që ne të marrim përgjegjësinë për të luftuar krimin edhe në të kaluarën tonë të lavdishme, nëse është kudo ku ka qenë, pa kompromis. Po duhet ta bëjmë ne, ta bëjmë vetë dhe këtë mund ta bëjmë.

Vendet tjera kanë përreth një praktikë, kanë dhoma të veçanta në gjykatat e tyre. Propozimi im është që kjo të jetë zgjidhja edhe për qasjen tonë.

Përsëri ne jemi të dëmtuar, sepse po barazohemi me diçka që objektivisht s'mund të barazohemi për nga pesha e përgjegjësisë e tjera.

Në rastin e Serbisë, që është mjaftuar me një Dhomë të Veçantë në sistemin e vet gjyqësor, pa asnjë prani ndërkombëtare, fjala është për gjenocid, zonja e zotërinj. S'po e themi ne. Një shekull më parë e ka thënë Dimitrije Tucoviq, tekstualisht: "Shteti serb është zënë në krimin në flagrancë të vrasjes në tentativë të një populli të tërë" E kishte fjalën për shqiptarë.

Është përsëritur së paku katër herë i njëjti fenomen dhe kurrë nuk ka funksionuar drejtësia siç duhet. Dhe në raportin e tij, Dik Marti thekson si motiv se nuk është mirë që në një konflikt një palë të jetë fajtores dhe tjetra të mos mbetet fajtores. Motivi është do të thotë politik.

Dik Marti konteston drejtësinë ndërkombëtare në Kosovë. Deputeti Dik Marti përzihet në ndarjen e drejtësisë ndërkombëtare, përsëri në Kosovë. Dhe kurrkush nuk i thotë atë që na e kanë thënë ne: e pse u përziekan deputetët në çështje të ndarjes së drejtësisë.

Për më tepër, deputetë rusë, kanë deklaruar publikisht në Dumen Ruse se kjo nismë me të vërtetë ka qenë e nismë e tyre dhe e mbështetur nga ata. Çka po mbështesim, zonja e zotërinj, në këtë rast? Drejtësinë apo luftën speciale, vazhdimësinë e një lufte të përgjakshme dhe të dhimbshme me pasoja për të gjithë. Dhe, çka thotë Dik Marti në raportin e tij? Çuditërisht, ne vazhdimisht i referohemi raportit. Nuk ndodh askund që referencë të jetë raporti. Raporti është bazë për rezolutën dhe rekomandimet.

Kurse në rezolutën dhe rekomandimet, nga Kosova kërkohet që të bashkëpunojë me misionin e EULEX-it. Kërkohet të bashkëpunojë edhe me autoritetet e Serbisë. Vini re, me autoritetet e Serbisë! Pra, është fjala për një raport që është bërë shumë vjet më parë.

Në Asamblenë Parlamentare të Këshillit të Kosovës, e cila Kosovën nuk e njeh as sa e njeh Serbia.

Në fusnotën e famshme, Serbia e njeh opinionin ndërkombëtar të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë. Asambleja Parlamentare e injoron madje edhe këtë. Dik Marti ka qenë i detyruar t'i përshtatet kësaj. A duhet t'i përshtatemi edhe ne?

Dhe, çka kërkon pastaj Dik Marti nga Serbia në këtë rast? Kërkon si kundërpeshë dorëzimin e Mladiqit edhe Karaxhiqit dhe pak bashkëpunim në çështjen e të pagjeturve. Çka ka lidhje Mladiqi dhe Karaxhiqi me krimet në Kosovë, për të cilat është fjala.

Dhe, unë mund të vazhdoj me një mori vërejtjesh, por nuk kërkon as Dik Marti gjykatë speciale. Pse, zonja e zotërinj, Gjykatë Speciale në Kosovë dhe vetëm në Kosovë? Pse të mos jetë edhe në Kosovë një Dhomë e Veçantë, siç e kemi në praktikën tonë, madje të diskutueshme edhe nga ana kushtetuese për privatizimin. Kemi modele, do të thotë e kemi kallëpin. Dhoma e Veçantë për privatizimin, le të jetë Dhoma e Veçantë për krimet e luftës dhe le të jetë në kuadër të sistemit tonë gjyqësor. Janë të mirëseardhur ekspertë ndërkombëtarë, përfaqësues të EULEX-it. Zaten, a nuk e kishim ne një bashkëpunim me EULEX-in? A nuk funksionoi dhe është vlerësuar në të gjitha raportet edhe progresi në drejtësi, edhe efektet e këtij bashkërendimi. Pse tani këto injorohen përnjëherë të gjitha?

Kishte madje një Gjykatë Ndërkombëtare për Krime të Luftës që i ka përfshirë figurat kryesore të Kosovës, me procedura skandaloze që janë dëshmuar pastaj të gabuara dhe askush nuk u ka kërkuar një falje madje atyre dhe familjeve të tyre.

Tani kemi procese gjyqësore që zhvillohen në Kosovë kundër figurave kryesore, po ashtu të luftës. Komandanti i UÇK-së është në procedurë gjyqësore tani dhe neve na thuhet 'Kosova nuk ka mundësi të përballet me sfida të tilla'. Po i dëgjojmë edhe prej kolegëve tanë. E çka t'i themi kësaj?

Në Kosovë gjykohen pikërisht ata që apostrofohen atje dhe megjithatë funksionon. Jo ndoshta më së mirë, por ma thoni një vend ku kjo funksionon siç duhet. Nëse ka të meta, gabime e lëshime le t'i luftojnë, le t'i korrigjojnë. Le të bëjmë dhe le të thërrasim përgjegjësi, po jo tani ta suspendojmë sistemin e drejtësisë së Kosovës, sepse dikush paska thënë që Kosova s'ka kapacitete e tjera. Nuk mund ne me duart tona ta mohojmë atë që e kemi ndërtuar me aq shumë sakrifica dhe me aq shumë mund dhe që raportet relevante e vlerësojnë si sukses.

Unë rrezikoj të zgjatem, zonja e zotërinj. Do të dëshiroja të kemi rast në ndonjë vend tjetër, t'i sqarojmë këto në gjerësi. Por, propozimi im është që t'i themi 'po' drejtësisë, por me qasje proaktive dhe kreative ta vendosim në suaza normale brenda sistemit tonë kushtetues, brenda sistemit tonë të drejtësisë, me modelet që janë të standardizuara në fqinjësi dhe le të kërkojmë edhe mirëkuptimin e miqve nëse janë miq. Miqtë duhet edhe ta kuptojnë edhe prirjen tonë për të dëshmuar ndonjëherë një dëgjueshmëri absurde. Është vullnetmirë, por është dëshmuar që është edhe kontraproduktive dhe do të duhej të dilni më në fund nga bindja se me një qasje servile, të nënshtruar, të dëgjueshme, pak a shumë hipokrite, dyfytyrëshe, të themi ndryshe është e vërteta dhe të gjithë e dimë se është e vërteta, por për t'ua bërë qejfin miqve ndonjëherë ua bëjmë qejfin armiqve tanë dhe armiqve të tyre, edhe armiqve të miqve.

Unë, prandaj, nuk e votoj këtë propozim kështu siç është. Nuk e mbështes as procedurën që është aplikuar. Angazhohem që të shkundemi dhe të vendosemi si të thuash në standarde të veprimit vërtet parlamentar.

Me marrëveshjen tonë, kemi mundësi që në marrëveshje ndërkombëtare të bëjmë rezerva, të bëjmë ndryshime. Ligji për marrëveshje ndërkombëtare është ende në fuqi.

Edhe Presidentja do të duhej ta respektonte dhe ta respektonte Kushtetutën.

Marrëveshja, ose si të them më saktë letërkëmbimi, që po na shitet si marrëveshje ka shumë shkelje kushtetuese e ligjore. As Presidenti nuk ka të drejtë ta shkelë Kushtetutën dhe nëse ne e legjitimojmë shkeljen e procedurave parlamentare, shkeljen e ligjeve, shkeljen e Kushtetutës për do motive politike të ditës, ne e rrënojmë bazën e sistemit në të cilin e kemi ndërtuar gjithë të sotmen dhe të ardhmen tonë. Nuk kemi të drejtë ta bëjmë këtë.

Prandaj, thirrja ime është që të shkundemi, të këndellemi dhe të veprojmë si përfaqësues të vërtetë të popullit.

Edhe mua më pëlqen t'ua bëjë qejfin miqve tanë nga të cilët edhe varemi bukur shumë. Por, më shumë se kësaj mendoj që duhet ta kemi parasysh vullnetin e qytetarëve, të votuesve që votojnë. A është vullneti i tyre për të votuar diçka të tillë, zonja e zotërinj? Nuk është? Pse të mos ua themi - 'jemi për funksionim të mirëfilltë demokratik, jemi për ta dhënë dhe për ta ndërtuar modelin më të mirë të trajtimit të pakicave, edhe sundimit të ligjit, edhe të luftës së krimit, në të gjitha format e saj. Na ndihmoni që ta bëjmë, por na ndihmoni ta bëjmë me ligjet tona dhe me sistemin tonë juridik...

(Ndërprerje nga regjia.)

KRYETARI: Fjalën e ka deputetja Rada Trajković.

RADA TRAJKOVIĆ: Poštovani predsjedavajući,
Poštovani kolege poslanici,

Danas je zaista jedan ja bi kazala vrlo osjetljiv dan što se tiče samog Parlamenta, u kome razgovaramo ovako o važnim zakonima. Ali ja sam se javila da vrlo kratko kažem: Hvala svim poslanicima koji su glasali za ove zakone, ili za ovaj zakon. To sam razumela kao da je ovaj parlament dominantno, sastavljen od Albanske većine, prihvatio i želi da sazna sudbinu svojih građana srpske nacionalnosti i ostalih nacionalnosti koji su kidnapovani, koji su nestalih, koji su ubijeni, bez želje da ikoga pozivamo bez procesa koji će se desiti.

Ja danas očekujem i zahvaljujem se svima koji će pomoći, a svi znamo da postoje Srbi koji su kidnapovani, svi znamo da se govori o trgovini organima, da će ta hipoteka koja ja nad određenim delom Albanske populacije kroz proces koji će se desiti najverovatnije identifikovati one koji su to činili. I u tom kontekstu, još jedan put hvala svima, koji znaju da se ovim glasanjem suštinski otvara pitanje pravog pomirenja između Srba i Albanaca, što je inače bila moja glavna strategija i cilj onog trenutka kada sam ušla u međunarodne institucije, odmah nakon dolaska međunarodne zajednice, pa normalno i do ovog trenutka. Hvala!

KRYETARI: Fjalën e ka deputetja Lumnije Morina.

LUMNIJE MORINA: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar deputetë,

Sot jemi para një vendimi shumë të rëndësishëm për fatin dhe imazhin e shtetit dhe kombit tonë, vendim ky që është i lidhur ngushtë dhe i pandashëm me të kaluarën, të tashmen dhe të ardhmen e shtetit dhe kombit tonë.

Dhe, nëse është kështu, e unë jam e bindur se është kështu, atëherë mendoj se të gjithë ne duhet të sillemi e të veprojmë në përputhje me interesin e shtetit dhe kombit tonë, sepse ky interes është dhe duhet të jetë interes i përbashkët i të gjitha partive - forcave politike të këtij vendi, të përfaqësuara në këtë Kuvend, por edhe të atyre që nuk janë të përfaqësuara në këtë Kuvend.

Duke e pasur parasysh këtë interes të përbashkët për shtetin, popullin dhe kombin tonë, unë mendoj se të gjithë ne duhet të jemi në nivelin e detyrës së të zgjedhurit dhe përfaqësuesit të denjë të popullit, shtetit dhe kombit tonë, sepse vetëm kështu mund ta arsyetojmë dhe përmbushim, ose jo, besimin e dhënë nga populli për ta përfaqësuar në organin më të lartë përfaqësues dhe ligjvënës të këtij vendi.

Sot ne jemi para një situate, kur duhet ta marrim një vendim, pa na pyetur fare se çka mendojmë për të, duke na sjellë para gjendjes që të “zgjedhim” ndërmjet të keqes më të vogël dhe të keqes më të madhe! Kjo situatë ka të bëjë më tepër me atë thënien e famshme “merre ose lëre”, se sa me ndonjë “zgjedhje” nga ne, sepse në këtë rast ne nuk po zgjedhim asgjë për vete, por për atë që po na e afrojnë të gatshme të tjerët për ne dhe nëse është kështu, atëherë zgjedhjen le ta bëjnë vetë ata, sepse edhe ashtu është zgjedhje ndërmjet të keqes më të vogël dhe të keqes më të madhe.

Kjo bëhet edhe më e rëndë kur partnerët tanë ndërkombëtarë na thanë se “dështimi për ta miratuar gjykatën me siguri se do të shpjerë në një proces në Kombet e Bashkuara, të cilin partnerët tuaj ndërkombëtarë nuk do ta bllokojnë, përmasat e të cilit mund të shkojnë përtej raportit. Ky do të ishte një proces më i gjatë dhe më i dëmshëm për imazhin e Kosovës”.

Nga kjo që na e thanë partnerët tanë ndërkombëtar, të cilët i respektojmë dhe i çmojmë për gjithçka që kanë bërë deri tash për ne, po del se nëse ne e miratojmë Gjykatën Speciale, ata do na falin - kursejnë për diçka që ne, ose nuk po e dimë se për çka do të na falin - kursejnë, ose, mbase, dikush edhe po e di se për çka do të na falin - kursejnë, sepse nuk ka si të shpjegohet ndryshe, kur na thuhet se mosmiratimi i kësaj gjykate nga ne “...me siguri se do të shpjerë në një proces në Kombet e Bashkuara, të cilin partnerët tuaj ndërkombëtarë nuk do ta bllokojnë, përmasat e të cilit mund të shkojnë përtej raportit”.

Të nderuar deputetë,

Unë mendoj se nuk duhet të lejojmë në asnjë mënyrë dhe në asnjë variant që kjo çështje të përfundojë si çështje e njëfarë pazari, kompromisi, marrëveshje apo çka di unë se çfarë tjetër, por që nuk ka dhe nuk mund të ketë kurrfarë lidhje me të drejtën, drejtësinë dhe ligjin.

Unë mendoj dhe, jo vetëm kaq, por jam e bindur se ne kemi pasur, kemi dhe do të kemi nevojë edhe tashti dhe në të ardhmen për përkrahjen, mbështetjen dhe ndihmën e vazhdueshme të partnerëve tanë ndërkombëtarë, të cilët na kanë ndihmuar, përkrahur dhe mbështetur në vazhdimësi, për çka u jemi mirënjohës dhe falënderues përgjithmonë.

Por, nëse ne mendojmë se lufta jonë për liri dhe pavarësi ka qenë luftë e drejtë çlirimtare, kurse të tjerët mund edhe të mendojnë ndryshe, ne nuk duhet të kërkojmë kurrë nga askush që të na falë për asgjë që ka të bëjë me luftën tonë të drejtë çlirimtare, qoftë edhe në rastin kur na thuhet se “ky proces është i fokusuar në individë”, sepse edhe në këtë rast nuk mendoj se mund të dëmtohet lufta jonë e drejtë çlirimtare dhe mu për këto arsye ne nuk duhet ta pranojmë asnjë gjykatë, qoftë ajo speciale, qoftë tribunal, apo çfarëdo qoftë tjetër dhe nga kushdo qoftë që e krijon, e kudo qoftë që krijohet.

Dhe, krejt në fund, unë deklaroj hapur se do të votoj kundër çfarëdo vendimi për këtë çështje dhe për çfarëdo çështje tjetër që mund të na vijë në formën e gatshme “merre ose lëre”, pa marrë parasysh se nga kush mund të na vijë diçka e tillë, për faktin e thjeshtë se për çështjet që kanë të bëjnë me vendin, me popullin, me kombin dhe shtetin tim, unë mendoj se, sado qofshin ato të rënda e të dhimbshme, përgjegjësia për marrjen e vendimit i takon vetëm shtetit tim dhe institucioneve të tij të zgjedhura nga populli i Kosovës.

KRYETARI: Deputetja Emilija Rexhepi e ka fjalën.

EMILIJA REXHEPI: Zahvaljujem predsedniče!

Poštovani predstavnici Vlade,

Narodnih poslanici,

Predstavnici međunarodnih institucija, ambasada, politički lideri,

Poštovani građani,

U posleratnom periodu stradalo je, odnosno je ubijeno ili kidnapovano veliki broj Bošnjaka iz Prizrena, Dragaša, Peći, Mitrovice, za koji se i dan danas ne zna gde su, a po rečima pravosudnih organa istraga je i dalje u toku. Dokle će tako biti?

Imamo ubijenu, odnosno zaklanu celokupnu bošnjačku familiju u naselju Tususu, u opštini Prizren, kao jednom od multietnički gradova na Kosovu. Poćinioci tog tragičnog događaja i dalje nisu poznati javnosti.

Kao predstavnik bošnjačke zajednice u potpunosti podržavam zakon o ratifikaciji međunarodnog sporazuma između Republike Kosova i Evropske Unije o misije Evropske unije za vladavinu zakona na Kosovu.

Bez prava vladavine zakona podjednako za sve nema mira i stabilnosti, nema multietničkog života, nema demokratskog i naprednog Kosova, i nema integracije prema Evropskoj Uniji.

Pitam se da li mi kao predstavnici naroda, bez obzira iz kojih političkih partija ili zajednica dolazimo, imamo pravo da glasanjem protiv ovog zakona štitimo pojedince, koji se za svoja djela moraju kazniti od strane organa pravde?

Poštovani predsedniče, takođe želim iskoristiti priliku da svim pripadnicima Turske zajednice na kosovu čestitam Dan Turaka!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja Vesna Nikiq.

VESNA NIKIĆ: Hvala gospodine predsedniče!

Uvaženi poslanici,

Predstavnici međunarodne zajednice,

Poslanice ispred Srpske zajednice, iz Jedinstvene srpske liste svakako da će podržati produžetak mandata EULEX-sa na ovim prostorima, ne za to što smo zadovoljni dosadašnjim angažovanjem ove misije, jer u nekoliko navrata ova misija imala strahovite

propuste kad su u pitanju zločini nad srpskom zajednicom, već za to što nam i dalje pruža nekakvu minimalnu sigurnost za naš dalji opstanak na Kosovu.

Podržaćemo iz razloga što sumnjam u kompetentnost domaćeg tužilaštva kada su u pitanju donošenje nekih ključnih odluka.

Otvaranjem sudskog procesa na Kosovu, odnosno produžavanje mandata EULEX-sa Srbi očekuje mnogo, i za njih je ovo veoma značajno, odnosno za sve nas, za celokupni Srpski narod, jer smatramo da će pravda koju čekamo već punih 15. godina biti konačno zadovoljena.

Smatramo da će produžetkom mandata biti pred lice pravde izvedeni svih zločinci koji su bili pripadnici tadašnje UČK-a, očekujemo da će biti adekvatno tretirani i kažnjeni, i odgovarati za svaku Srpsku nevinu žrtvu, za svaku silovanu Srpkinju, za svaki izvađeni srpski organ, za svaku spaljenu srpsku svetinju, za svaki oteti pedalj zemlje srpske imovine, za svako prognano lice koje već 15. godina živi na ivici egzistencije širom Srbije.

Ja vas molim gospodo iz EULEX-sa da u produženom mandatu budete zaista statusno neutralni i da konačno krenete sa jednakim tretiranjem svih zločina, jer zločin je zločin, bilo ko da ga je počinio, bilo da to dolazi iz Albanske, Srpske ili bilo koje druge zajednice.

Molim vas da konačno počnete da radite da ne samo Srbi već i ostale zajednice ne steknu utisak, kao što je bila praksa do sada, samo čisto demonstriranje moći i želja za kontrolisanjem političkog vrha u Prištini. Hvala!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Arsim Bajrami.

ARSIM BAJRAMI: Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit!

Me një diskutim racional të liruar nga emocionet që shkakton ky debat, sidomos nga emocionet patriotike, ne mund të hedhim me dhjetëra argumente kundër miratimit të kësaj Gjykate Speciale, sepse është vërtet një vendim që s'ka asnjë bazë juridike, por as bazë politike, as në praktikat ndërkombëtare dhe është e sigurt se kjo çështje dhe dy vendim do ta dëmtojnë imazhin e Kosovës, imazhin e shtetit të Kosovës dhe do të ndikojnë edhe në historinë që do të shkruhet për Kosovën, sepse është një tendencë e qartë, u vërejt sot edhe nga diskutimet euforike të disa kolegëve të komunitetit serb, është një tendencë për ta falsifikuar historinë, për të bërë disa balance dhe ekuilibra që shpeshherë i kemi parë edhe në bashkësinë ndërkombëtare.

Sikur harrohet këtu se kush ka pësuar gjenocid, kush ka qenë viktimë, kush ka qenë objekt i shkeljeve drastike, sistematike të të drejtave individuale dhe kombëtare dhe është e qartë se edhe kriteret e bashkësisë ndërkombëtare nuk janë unike sa i përket drejtësisë ndërkombëtare.

Për shkak se ka një tendencë që në emër të pajtimit, në emër të pajtimit kombëtar të bëhet një ekuilibër ndërmjet një populli që ka pësuar gjenocid dhe shkeljeve eventuale të supozuara dhe të përmendura në kuluare dhe qarqe ndërkombëtare.

Kështu që ne mund të hedhim me dhjetëra argumente kundër këtij kufizimi të sovranitetit, kundër kësaj tendence, e cila do ta dëmtojë shtetin e Kosovës në perspektivën e saj evropiane.

Dëshiroj t'u kundërvihem pak diskutimeve të dy kolegeve të mëparshme, të cilat nuk e shprehin euforinë dhe krenarinë, por nuk e marrin guximin për ta denoncuar gjenocidin dhe krimin që ka bërë shteti i tyre në Kosovë. Jo individ, jo presidenti i shtetit të tyre, por shteti i tyre në Kosovë, dhe ato sikur tani shprehin një kënaqësi, duke mos qenë korrekte dhe mos pasur guximin për të treguar krimin e vërtet që ka ndodhur në Kosovë.

Kështu që është vetëm një arsye që ndoshta duhet të na shtyjë për ta pranuar juridiksionin e kësaj gjykate. E vetmja arsye të jemi të sigurt se edhe kjo tentativë për ta denigruar luftën e drejtë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës do të jetë një tentativë e dështuar, siç kanë dështuar edhe rastet tjera në Gjykatën e Hagës, sepse jemi të sigurt se argumentet janë plotësisht në anën e luftës së drejtë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe janë të kota insinuatat apo tendencat për ta denigruar.

Në pjesën e dytë të diskutimit tim unë do të koncentrohem në diçka që është shqetësuese dhe që është pjesë e letërkëmbimit të Presidentes, të cilën e kemi lexuar me vëmendje dhe i cili letërkëmbim do të shndërrohet pastaj në ligje, por ndoshta më vonë edhe në ndryshime kushtetuese.

Brenda letërkëmbimit ka shumë çështje antikushtetuese, ka çështje që e rëndojnë rendin kushtetues që e rikthejnë procesin e statusit të Kosovës prapa. Ne kemi kaluar nga cikli i shtetit me mbikëqyrje ndërkombëtare në një shtet të pavarësisë së plotë. Por, disa kërkesa eksplicite që janë brenda letrës, e rikthejnë plotësisht një proces mbrapa dhe e dëmtojnë rendin kushtetues të Kosovës. Po bëhem më konkret - brenda letrës e keni një kërkesë, të cilin më herët kryetari i Gjykatës Kushtetuese ia ka dërguar jo këtij Kuvendit, por Bashkimit Evropian, dhe ajo kërkesë është edhe brenda letrës së Presidentes, me të cilën kërkohet vazhdimi i mandatit të pranisë ndërkombëtare në Gjykatën Kushtetuese.

Ne, vitin e kaluar, e kemi përfunduar mbikëqyrjen ndërkombëtare me një ligj, i cili ka treguar se në cilat institucione do të ketë prani ndërkombëtare.

Tani, në vend që këta dy përfaqësues të lartë të shtetit të Kosovës t'i drejtohen Kuvendit të Kosovës, ata e bëjnë një kërkesë që në fakt të vazhdojë mbikëqyrja ndërkombëtare në institucionet me të cilat me amendamente kushtetuese ka përfunduar dhe kjo nuk është korrekte, sepse procesi i statusit të Kosovës sikur po kthehet prapa, sikur ne tani po e rikthejmë mbikëqyrjen ndërkombëtare edhe në segmentet të cilat ne i kemi diskutuar si parlament dhe jemi marrë vesh që përfundon mbikëqyrja ndërkombëtare.

Mendoj që kjo nuk na duhet. Ne duhet të besojmë në shtetin tonë, ne duhet ta kemi një kulturë kushtetuese të komunikimit dhe nuk kemi nevojë që t'i drejtohem Bashkimit Evropian që ta kthejë praninë ndërkombëtare, ndoshta edhe për shkak të paaftësisë tonë për të ndërtuar institucione vendore.

Thjesht, ne të gjithë duhet të jemi të përgjegjshëm karshi shtetit tonë dhe të mos e lejojmë me asnjë segment dëmtimin e kësaj ecjeje të shtetit tonë, sepse cilado sjellje tjetër e vë në pyetje komplet procesin të cilin ne e kemi kaluar dhe mendoj që është një rast jashtëzakonisht jo i mirë dhe ne si Parlament duhet ta marrim guximin që t'i kundërshtojmë këto tendenca për shkak se ato seriozisht mund ta dëmtojnë plotësimin dhe ecjen përpara të shtetit tonë. Faleminderit!

KRYETARI: Deputetja Alma Lama e ka fjalën.

ALMA LAMA: Faleminderit, zoti kryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

Isha duke e respektuar vendimin për të mos pasur debat, por meqë u hap debat dhe jo vetëm debat, por pati mjaft provokime këtu në sallën e Kuvendit, nuk mund të mos flas.

Të them të drejtën, unë personalisht, për shkak pikërisht të këtij vendimi që do të marrim sot, e kam rillexuar edhe një herë historinë e shekullit XX të Kosovës dhe sërish jam tmerruar me krimet që Serbia ka bërë këtu.

Kam përshtypjen që është mirë që edhe këta deputetë të komunitetit serb që janë në sallë ta lexojnë. Ta lexojnë dhe t'i shohin të vërtetat se çfarë ka ndodhur në Kosovë.

Këtu na u tha që presim prej 15 vjetësh të bëhet drejtësi. E unë them që ne shqiptarët presim prej një shekulli që të bëhet drejtësi. Me qindra-mijëra, ndoshta edhe një milion shqiptarë janë vrarë gjatë këtij shekulli. Mjafton t'i mbledhim ato dhe jo nga dëshmitë tona dhe të historianëve tanë, por nga historianët ndërkombëtarë.

Shqiptarët kanë qenë këtu në shtëpitë e tyre, në Kosovë. Kanë ardhur ushtritë dhe i kanë vrarë. Por, ushtritë kanë shkuar edhe më tej. Nuk e kam thënë asnjëherë, por do t'jua them një fakt: në vitin 1915 ishte pikërisht ushtria serbe që i dogji kullat e të parëve të mi, dhe kjo ka ndodhur në mesin e Shqipërisë. Imagjinojeni se çfarë ka ndodhur në Kosovë, çfarë dëbimesh masive, çfarë vrasjesh, çfarë gjenocidi.

Për mua personalisht, rasti i Dik Martit është një konstrukt. Është shumë i ngjashëm me konstruktin e rastit Martinoviq, i cili e hodhi komplet Serbinë në histeri kolektive dhe politike.

Pse ne kemi vendosur që ta votojmë sot këtë? Natyrisht, vetëm e vetëm për t'u pastruar nga një konstrukt që unë mendoj që është një komplot ndërkombëtar, me prapavijë vetëm e vetëm për ta dëmtuar imazhin e Kosovës, por kjo është edhe një certifikatë ndërkombëtare që Kosova duhet ta marrë ashtu sikur e mori certifikatën ndërkombëtare

në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë për drejtësinë e vendimit për shpalljen e pavarësisë së Kosovës.

Prandaj, i nderuar kryetar, në rast se ka provokime këtu, do të kisha kërkuar nga ju që të mos lejoheshin në këtë debat, sepse e dimë shumë mirë se kush ka bërë krime në Kosovë. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Rexhep Selimi.

REXHEP SELIMI: Faleminderit, zoti kryetar!

Më duhet ta filloj fjalën time me atë që u përmend më së shumti këtu, me fjalën padrejtësi. Edhe nga vetë mbështetësit u tha që kjo është padrejtësi. Pra, kjo është pika e vetme që ne pajtohemi që është padrejtësi, edhe me ata që votojnë për, edhe me ata që votojnë kundër.

Është shumë e padrejtë që pas gjithë asaj që ka bërë, pas gjenocidit dhe spastrimeve etnike, pas masakrave që ka bërë, sot Serbia shkon drejt BE-së, Kosova shkon drejt gjykatores. Përnjëmend është shumë e padrejtë, përnjëmend është padrejtësi. Pra, ne e dimë po ashtu që njëkohësisht edhe Kosova nuk ka prodhuar drejtësi nga brenda, por mungesa e drejtësisë nga brenda nuk do të duhej të vinte si padrejtësi nga jashtë. Pra, nuk do të duhej që mungesa e drejtësisë për shkaqe krejt politike brenda të zëvendësohej me një padrejtësi nga jashtë. Edhe po ashtu u tha që është vendim i rëndë.

Kujt i hyn në punë kjo, nëse është vendim i rëndë? Kujt po i kryen punë kjo padrejtësi ndaj nesh? Pra, nëse qenka vendim i rëndë, kujt i hyn në punë kjo gjykatë, sido që të quhet ajo. Kundërshtimi për këtë gjykatë nuk nënkupton që ne votojmë kundër drejtësisë, por pikërisht kundër padrejtësisë, përderisa kështu është quajtur edhe nga mbështetësit e saj. U tha që kjo është një padrejtësi që po i bëhet Kosovës dhe kundërshtimi ynë është kundër kësaj padrejtësie, e cila do të shoqërohet po ashtu me votë kundër.

Ne, pra, njëkohësisht duhet ta konfirmojmë edhe një herë që të mos keqinterpretohet, ne nuk jemi kundër drejtësisë, por pikërisht jemi kundër padrejtësisë dhe po mbrohem nga ajo.

Nëse akuzat ndaj shqiptarëve për krime lufte janë drejtësi, atëherë do të duhej të thuhet - kërkohet nga Qeveria, nga kryeministri votoni për drejtësi kundër UÇK-së dhe shqiptarëve, por nëse këto akuza ndaj shqiptarëve, në përgjithësi, dhe ndaj UÇK-së, në veçanti, janë padrejtësi, atëherë do të duhej të kërkohet nga ne që të dalim të rreshtohemi të gjithë kundër kësaj padrejtësie.

Zotërinj dhe zonja deputete,

Kush prej jush e di se çka po votoni sot? Askush! Ne sot po votojmë diçka që nuk e dimë çka po votojmë. Nëse dikush e di, le të ma thotë. Pra, ne sot po e nënshkruajmë një çek 'blanko', por shuma e këtij çeku 'blanko' që ne sot po nënshkruajmë nuk do të bjerë vetëm mbi ne. Mbi të gjitha, do të bjerë dhe do t'i faturohet imazhit të shqiptarëve, në

përgjithësi. Pra, ndërmjet dy të këqijave, qoftë e keqja e madhe, qoftë e keqja e vogël, ne do të duhej sot t'i kundërshtonim të dyja.

Ne nuk jemi këtu që ta votojmë të keqen më të madhe dhe të keqen më të vogël, por ne jemi këtu që të bëjmë ligje për drejtësi. Ne nuk mund, as nuk do të duhej që me votën tonë ta rreshtonim Kosovën dhe kombin shqiptar në një rresht shumë të rëndë tjetër të gjykatave të ngjashme pas Luftës së Dytë Botërore. Prandaj, në një situatë kur themelimi i kësaj gjykate nuk ka bazë juridike, nuk ka bazë politike, e as morale, ne si Lëvizje "Vetëvendosje" nuk mund të dalim kundër këtyre tri parimeve të rëndësishme, prandaj vota kundër është zgjedhja jonë. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Fatmir Limaj.

FATMIR LIMAJ: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Shpresoj të jetë hera e fundit që institucionet e Kosovës, Parlamenti i Kosovës, që trajtohen në këtë mënyrë qysh po trajtohen, qysh janë trajtuar deri më tani. Shpresoj se përbërjet e reja të Parlamentit dhe të Qeverisë nuk do ta sjellin asnjëherë situatën që institucionet e Kosovës të trajtohen në këtë mënyrë, si sot.

Po e them këtë për arsye se ne sot po debatojmë për një çështje për të cilën më së paku këta deputetë këtu në sallë kanë informacione se për çka po flasim. Krejt temat më së shumti janë bërë në opinion, janë mediet dhe gazetatat që kanë folur dhe pothuaj 90% prej nesh jemi informuar nga mediet, atë që e kanë shpalosur ato. Dhe, fatkeqësisht, gati këtu po bëhet si rregull që gjithmonë Parlamenti të futet para një akti të kryer për një çështje për tema të rëndësishme, të ndjeshme, të cilat kanë nevojë një trajtim serioz profesional, një debat i cili do t'i shterte të gjitha argumentet dhe pastaj të vijë deri te një përfundim meritor.

Çështjen të cilën po e diskutojmë sot, besoj është një çështje tepër e rëndësishme dhe do të duhej të kishim si institucione një qasje shumë më serioze se sa nga kjo sot. Duke e konsideruar veten time nga mungesa e informacioneve të plota për këtë çështje, unë do të mundohem t'i jap disa nga opinionet e mia rreth asaj që kam krijuar, nga ato që kam parë ekskluzivisht nëpër media.

Jemi dëshmitarë të ditëve të fundit, nga debatet e ndryshme dhe opinionet e ndryshme që janë zhvilluar lidhur me këtë temë, nganjëherë krijohet përshtypja se në Kosovë pas 15 vjetëve pas lufte, për herë të parë po fillohet të hetohet lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Sikur 15 vjet të kaluara nuk ka ndodhur asgjë në hetime, nuk janë hetuar, nuk janë gjykuar, dhe tani po fillojmë për herë të parë hetimin e krimeve të luftës të supozuara, gjoja të kryera nga Ushtria Çlirimtare e Kosovës. Bile në funksion të saj thuhet që Kosova duhet të dëshmohet edhe një herë, Kosova nuk duhet të frikohet, Kosova duhet të dëshmojë që është për drejtësi, Kosova nuk duhet të frikësohet nga drejtësia, e shumë fluskula tjera. Në fakt, e vërteta është ndryshe.

Së pari, që nga paslufta janë bërë hetime të gjithanshme për krimet e supozuara të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, duke filluar nga UNMIK-u, ku ka me dhjetëra raste të procedura, të gjykuara. Ka dhjetëra aktgjykime, bile ka njerëz që janë në burgje e vuajnë dënime, pastaj kemi raste të Gjykatës së Hagës dhe, në fund, edhe të EULEX-it, që do të thotë për 15 vjet vazhdimisht në Kosovë janë bërë hetime, janë bërë gjykime për krimet e supozuara të luftës dhe nuk po fillon sot kjo çështje.

Prandaj, pse po e bëjmë ne këtë? Për të treguar se nuk ka asnjë vend në ish-Jugosllavi, i cili ka dëshmuar, sikur Kosova, që është e gatshme për t'u ballafaquar me çfarëdo pretendimi, supozimi për krime të luftës. Nuk ka asnjë qytetar, asnjë ushtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të cilin e ka thirrur drejtësia dhe nuk i është përgjigjur. As nga UNMIK-u, as nga Haga, e as nga EULEX-i. Nuk ka asnjë rast. E ju e dini se ka dhjetëra raste në vendet e ish-Jugosllavisë, të cilët i kanë ikur, kanë sabotuar, i ka fshehur vetë shteti të akuzuarit. Këta të fundit, 2008 a 2009, kur janë marrë në Gjykatën e Hagës.

Bile-bile, institucionet e Kosovës, ato që kanë qenë dhe që janë, i kanë hapur dyert që të hetohet çdo gjë për 15 vjet në këtë vend, ka pasur mbështetjen edhe të qytetarëve, ndërsa, në anën tjetër, shtetet e organizuara e kanë sabotuar të vërtetën, kanë prishur dhe falsifikuar dokumente shtetërore, siç është Serbia, nuk ka ofruar bile në kohën e Hagës dokumente që kanë provuar fajësinë e krerëve të tyre. Me një fjalë, në mënyrë të organizuar, shtetet tjera kanë bishtnuar dhe kanë tentuar të ikin drejtësisë.

Për ata, Kosova është shembull për 15 vjet, e cila ka qenë e hapur, që asnjëherë dhe për asnjë moment as të mos frikohet, por edhe do të dëshmojë që është e gatshme të ballafaqohet me të kaluarën e saj dhe pjesëtarët e UÇK-së kanë qenë të gatshëm dhe janë ballafaquar me të kaluarën e saj sa herë që kjo është kërkuar.

Prandaj, këtu duhet të jemi të qartë - mos kërkon nga Kosova çdo ditë të dëshmohet e të dëshmohet, e të mos frikësohet, sepse Kosovës po i shkon krejt jeta duke u dëshmuar, e duke provuar që as nuk frikësohet, e as nuk ka pse të frikësohet, e as nuk ka pse ta fshehë të kaluarën e saj.

Rasti konkret për të cilin jemi këtu, po ashtu e dëshmon një gjë të tillë. Sot po flasim për raportin e Dik Martit. Gjithashtu, në opinion krijohet përshtypja që hetimet po fillojnë sot dhe ne po frikësohemi t'i japim mbështetje fillimit të hetimeve. Të gjithë e dimë që hetimet për raportin e Dik Martit kanë filluar në shtator të vitit 2011. Të gjithë e dimë që të gjithë i kemi dhënë mbështetje hetimit të këtij raporti. Domethënë nuk ka pse të frikësohet. Ka hetuar sigurisht task-forca apo grupi që është duke hetuar, ka kërkuar në atë kohë që të jetë një ekip i veçantë i pandikuar dhe t'i jepet gjithë mundësia e mundshme për ta bërë një hetim të mirëfilltë të paanshëm. I është dhënë e gjithë hapësira e nevojshme.

Ne nuk kemi parë asnjë ankesë nga grupi hetimor, duke iu drejtuar Kosovës se po e bllokun në hetimin e saj. Ne nuk kemi parë asnjë ankesë nga grupi hetimor drejtuar shtetit shqiptar që po e bllokun hetimin e saj. Përkundrazi, kemi parë lëvdata nga grupi hetimor, i cili i ka lavdëruar institucionet, edhe të Kosovës, edhe të Shqipërisë për kooperim dhe

bashkëpunim. Domethënë hetimet plot tre vjet kanë vazhduar dhe ato sigurisht do ta keni përfundimin tyre profesional për të cilin besojmë që ashtu edhe do të bëhet.

Këtu nuk po bisedohet për hetime, por thjesht këtu tash kemi ardhur në diçka tjetër. Kemi kërkuar një hetim të veçantë special. Shumë mirë është bërë! Tash po e kërkojmë një gjykim special, një gjykatë speciale, nëse vjen deri te procedimi i rasteve, të gjykohen.

Shikoni, të nderuar kolegë,

Përsëri po them, këtë temë do të duhej ta trajtonin ekspertët me argumentime juridike, por fatkeqësisht ky debat ka munguar, sepse sigurisht edhe nuk kanë pasur informacione për ta bërë një debat dhe k duhet të zhvillohen debate në shoqëri demokratike, sepse vetëm një debat shterues do të na sillte në një konkluzion të qartë. Nuk është mirë sot të dalim e të flasim këtu ‘nuk është mirë të votojmë, por duhet votuar’. Mendoj se me këtë nuk e ndihmojmë esencën për çka kërkohen hetimet.

Jemi para një situatë kur thuhet se duhet të krijohet një gjykatë speciale për shkak të kredibilitetit. Ju e dini, të gjithë e dimë, këtu është EULEX-i, janë gjyqtarët ndërkombëtarë, prokurorët ndërkombëtarë, dhe atëherë shtrohet pyetja - për cilin kredibilitet po flasim. Si mund të trajtohen jokredibil gjykatësit perëndimorë me përvojë, në këtë rast të EULEX-it, ndërsa gjykatat serbe në Serbi të jenë kredibile.

Si mund të jenë kredibile gjykatat në Beograd, me gjyqtarë serb, me prokurorë serbë, me avokatë serbë, të cilët kanë qenë edhe në kohën e pushtetit të Milosheviqit, ato të cilësohen kredibile, të vlerësohen si kredibile, ndërsa gjymëtarët ndërkombëtarë në Kosovë të dyshohen se nuk janë kredibilë. Për mua, kjo është e paqartë. Nuk dua të lëshohem shumë këtu në çështje të drejtësisë, sepse nuk kemi edhe kohë, për faktin që nuk kemi pasur mundësi, por, megjithatë, po e prek si çështje: Pse Kosova duhet të trajtohet e veçantë nga vendet tjera të rajonit? Pse?

Gjykata Ndërkombëtare për Krime Lufte në Hagë i ka trajtuar krimet në ish-Jugosllavi. Ato që i ka trajtuar, i ka trajtuar, atë që nuk i ka trajtuar i ka kthyer në gjykatat vendore. Pse Kosova duhet të trajtohet e veçantë? Kjo për mua është e paqartë.

Të nderuar miq,

Është edhe një argument, përveç kredibilitetit, argumenti i dëshmitarëve. Janë 100 opsione për ta zgjidhur këtë shqetësim. Janë një milion mekanizma që mund ta zgjidhin këtë shqetësim. Janë të gjitha mundësitë për ta zgjidhur këtë shqetësim. Po, për shembull, a keni pyetur ndonjëherë cila është gjendja e dëshmitarëve në Serbi? Ne i kemi raportimet e medieve, në të cilat shteti vetë organizohet dhe ndalon...

(Ndërprerje nga regjia.)

KRYETARI: Vazhdoja edhe pak!

TATMIR LIMAJ:.. i persekuton dëshmitarët e tyre për të mos ardhur deri te zbulimi i krimit. Pasi këtu m'u ndal fjala dhe po duket se nuk kam shumë kohë për më gjatë, po e

përmbyll fjalimin tim: Unë për vete personalisht, kurrë nuk mund të votoj kundër një gjykate, e cila heton dhe ka për qëllim procedimin e krimeve të luftës. Unë mendoj që këtu, pa çështje vote, kemi dëshmuar edhe me veprime konkrete që ne i përgjigjemi drejtësisë, por krimi nuk mund të gjykohet selektivisht, nuk mund të ndiqet selektivisht.

Prandaj, si përfundim, unë dua të them që jam për vazhdimin e misionit të EULEX-it, që është shumë me rëndësi për Kosovën, dhe duhet të vazhdohet ky mision dhe unë do të jem gjithmonë pro një gjykate, e cila do t'i gjykonte krimet e kryera në Kosovës, në tërësi, pavarësisht nacionalitetit. Një gjykatë, e cila do të ishte e verbër nga përkatësia nacionale e atyre që supozojnë që kanë kryer krime, por derisa në Parlamentin e Kosovës nuk vjen dhe nuk shtrohet si çështje për të pasur një gjykatë e cila i gjykon, i procedon të gjitha krimet e supozuara në Kosovë, pavarësisht nga kush janë kryer, ne detyrohemi të abstenojmë, sepse mendojmë se kështu nuk ndihmohet drejtësia.

Dhe, në fund, po e përmbyll, nëse vërtet doni t'i ndihmoni këtij rajoni dhe Kosovës, e posaçërisht kësaj shumice shqiptare, Kosova më shumë se për këtë ka nevojë për një gjykatë tjetër. Ka nevojë për gjykatës profesionistë, prokurorë profesionistë, të cilët do ta ndërgojnë një dhomë ose një gjykatë të veçantë për krimin e organizuar dhe korrupsionin që e shkatërroi këtë vend. Mendoj se kjo është më e nevojshme për Kosovën tani për tani, që drejtohet drejtpërdrejt për shumicën shqiptare. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Albin Kurti.

ALBIN KURTI: Faleminderit, kryetar!

Deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Në vend se të kemi debat para marrëveshjeve eventuale, në Kuvendin e Kosovës, kemi debat pas marrëveshjeve dhe para ratifikimit. Kjo është shkelje e karakterit parlamentar të Republikës sonë. Do të duhej që për EULEX-in dhe Gjykatën e Veçantë të hapet debati në institucionet e Kosovës, në Parlamentin e Kosovës, dhe ky debat ndoshta të rezultojë me marrëveshje. Mirëpo, po ndodh e kundërta: po nis marrëveshja me pafund negociata në prapaskenë, pa kurrfarë transparence dhe, në fund, keqpërdoret Kuvendi i Kosovës për legjitimimin e marrëveshjeve nëpërmjet ratifikimit. Kosova nuk ka nevojë për këtë Gjykatë të Veçantë, por kjo Gjykatë e Veçantë ka nevojë për Kuvendin e Kosovës.

Asnjë zyrtar i EULEX-it asnjëherë për asnjë gjë nuk erdhi tash e gjashtë vjet që të raportojë në këtë Kuvend për punën që e kanë bërë, e që nuk e kanë bërë. Të gjithë ne e kemi parasysh në këta gjashtë vjet krerët e EULEX-it dhe zyrtarët e ndryshëm të tij japin raport të punës së tyre në ligjërata nëpër kolegje private e nëpër tryeza të OJQ-ve, por kurrë në Kuvendin e Kosovës. Pse duhet ripërtëritë dikush që nuk të jep llogari, nga ne që nuk marrim llogari? Nëse EULEX-i konsideron që nuk duhet të japë kurrfarë llogarie dhe përgjegjësie në këtë Kuvend, atëherë le të vazhdojnë pa këtë Kuvend, apo jo? Të ripërtërihet EULEX-i nga Kuvendi, të cilit EULEX-i refuzon t'i japë llogari do të thotë t'ia shtosh fyerjen plagës.

Përveç se nuk po shkon EULEX-i, po na vjen Gjykata e Veçantë. Pra, sundimi po trashet mbi Kosovën, e kjo është edhe e padrejtë, edhe e dëmshme. Do të duhej që pas Tribunalit

të Hagës të kemi Tribunal për Serbinë, ku vazhdimisht po zhvarrosen kufoma të të pagjeturve shqiptarë. Mirëpo, është Kosova ajo që po përfundon në tribunal.

Në vend se të diskutohet për dështimet e EULEX-it gjatë këtyre 6 vjetëve, në vend se EULEX-i të japë llogari për atë se çfarë ka bërë dhe çfarë nuk e ka bërë duke shpenzuar rreth 1,5 miliard euro të taksapaguesve evropianë, po kalohet në temën e radhës me shpejtësi, ku Kosova po gjykohet, me ç'rast kjo bëhet në emër të gjyimit të individëve të saj. 9 vjet e kishim UNMIK-un, 6 vjet e kishim dhe vazhdojmë ta kemi EULEX-in, dhe tash po shtohet Gjykata e Veçantë! Themelimi i Gjykatës së Veçantë për Krime Lufte në Kosovë do të shënojë shfajësimin e EULEX-it për dështimin e tij, duke ia faturuar këtë Kosovës në emër të dëshmitarëve që nuk mbrohen dot.

Në shumë vite të ardhshme, përdorimi i fjalës Kosovë e UÇK në të njëjtën fjalë me fjalët 'krim', 'krim lufte', 'krim kundër njerëzimit', 'trafikim organesh' do të proliferohet pafundësisht e globalisht nëpër media të ndryshme botërore dhe kjo do të jetë tejet e dëmshme për imazhin dhe reputacionin e Kosovës në botë. Pra, ky është një hap i madh prapa, që po i ndodh Kosovës gati 15 vjet pas çlirimit, e më shumë se 6 vjet pas shpalljes së pavarësisë.

Deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Unë nuk jam i bindur që Këshilli i Sigurimit të Kombeve të Bashkuara me aq lehtësi do të mund ta merrte këtë çështje, duke themeluar një tribunal për Kosovën. Shpeshherë më duket që një pretendim i tillë është më shumë shantazh, që Kosova vullnetarisht ta pranojë një gjykatë të veçantë, sesa që realisht një gjë e tillë do të mund të ndodhte. Dihet që tribunale ndërkombëtare krijohen për katër lloje të krimeve: krimet e gjenocidit, krimet e luftës, krimet kundër njerëzimit dhe krimet e agresionit. Nuk ka tribunale ndërkombëtare as për trafikim organesh, e madje as për terrorizëm. Pra, janë këto katër kategori për të cilat organizohen tribunale ndërkombëtare. Hetimet për trafikimin e organeve, në bazë të pretendimeve të senatorit Marti nuk mund të përfundojnë aq kollaj në tribunal ndërkombëtar. Të kalosh prej trafikimit të organeve në krim të luftës është një urë tejet e gjatë, e madhe dhe gjithësesi e paqëndrueshme. Prandaj, duke e ditur që janë të pasigurt që Këshilli i Sigurimit mund ta bënte një gjë të tillë, ne po ndodhemi në situatën me një trysni kaq të madhe që po i bëhet Kuvendi të Republikës. Fundja, ne të gjithë e dimë se edhe në luftë mund të ndodhin krime ordinere - jo çdo krim në luftë është krim lufte.

Dakordimi i këtillë i Qeverisë dhe i Presidentes, e tash kërkesa që këtë ta bëjë edhe Kuvendi i Republikës për Gjykatën e Veçantë do të jetë një çek 'blanko' i Kosovës për Gjykatën e Veçantë. Sepse, ne nuk e kemi parë as bazën e kësaj Gjykate të Veçantë, as përbërjen e saj, as rregullat, as misionin, as afatin e financimin, e as qëllimet e saj. Çfarëdo votimi në Kuvendin e Republikës së Kosovës për këtë Gjykatë të Veçantë është çek 'blanko', sepse ne nuk e kemi materialin e nevojshëm dhe të mjaftueshëm që të dimë se çka do të votohet. Në fakt ata që votojnë për, nuk e dinë se çka kanë votuar.

Votë e vërtetë është vetëm vota kundër si votë kundër imponimit dhe jo transparencës. Madje, që Holanda do të jetë nikoqire e asaj dhome të veçantë të kësaj gjykate të veçantë,

ambasadori holandez në Kosovë, Bosh, shprehu gatishmërinë e Qeverisë holandeze, por edhe nevojën për më shumë informacione. Ndërkaq, në Kuvendin e Kosovës thuhet që këtu s'ka nevojë më shumë informacione.

Holandës për atë dhomën e veçantë i duhen më shumë informacione, për neve nuk ka nevojë. tribunali apo gjykatë e veçantë nuk bëhet sikur ky kryeministër i Kosovës të mos donte por, Thaçi po e lejon tribunalin për shkak se beson që ai vetë nuk ka për të përfunduar aty.

Nëse e ka ndonjë mik ndërkombëtar që mund t'i ndihmojë Kosovës, do ta bënte këtë duke i treguar kryeministrit që edhe ky vetë do të përfundojë aty. Se po t'i thuhet kryeministrit të Kosovës që edhe ky vetë përfundon aty, s'ka tribunal. Por, shpresa e këtij që ky vetë s'përfundon, por shokët e tij shkojnë, thotë e kemi njëfarë sfide të madhe që duhet t'i përgjigjemi me përgjegjësi. Kjo është edhe e turpshme, përveçse e padrejtë.

Serviliteti i kryeministrit Thaçi dhe të tjerëve ndaj çdo burokrati ndërkombëtar, nuk bëhet për hir të shtetit dhe kombit, por nga motivet e qëllimet e ngushta personale. Këta nuk po nënshtrohen, sepse është interesi i Kosovës, këta po nënshtrohen sepse është interesi vetjak i tillë. Por, le të mos harrojmë që nuk mund të na e mbrojnë Republikën njerëzit që konsiderojnë veten dhe tjetrin dhe çdo tjetër shumë privatisht e personalisht.

Nuk ka Republikë pa publikën, e këta nuk janë njerëz publikë. Këta janë njerëz privatë, çdo kund e çdo herë privatë dhe vetëm privatë. Pas kapitullimit vjen tribunali, negociatat dhe marrëveshja e Thaçit me Serbinë ishte kapitullim. Serbia i fitoi integritet evropian, njëherë statusin e vendit kandidat e pastaj edhe negociatat për anëtarësim, Serbia e fitoi pushtetin në 10 komuna të Kosovës, miliarda janë dhënë për multietnicitet, partia e Daçiçit e mori më shumë se çerekun e komunave të Kosovës dhe natyrisht që tash Kosova e fiton gjykatën e veçantë për krimet e ushtarëve të UÇK-së.

Gjykata e veçantë është ekstradim i pavarësisë së Kosovës dhe luftës çlirimtare. Pavarësia dhe lufta kriminalizohen dhe dorëzohen jashtë, ndërkaq deklarata e Thaçit në Euronews se ka qenë larg fronteve të luftës, ishte asfalt për tribunalin. Kur e pyeti gazetarja e Euronews-it i tha: a ke dhënë ti ndonjë urdhër që me u vra ndonjë armik ose a e ke vra vetë ndonjë armik? Ky tha: “jo, unë kam qenë larg fronteve”. Me fjalë tjera: “ata që kanë qenë nëpër fronte, ata merrni ju shpirt, a unë kam qenë larg”.

Pas kësaj gjykate të veçantë do të thuhet që po, serbët kanë bërë më shumë krime, por krimet më monstruoze i kanë bërë shqiptarët, korren dhe trafikimin e organeve. Me të vërtetë për nga sasia do të thuhet që serbët kanë bërë më shumë krime, Serbia, ama krimet më monstruoze i kanë bërë shqiptarët. Teksa qeveritarët na thonë që e kemi të sigurt ardhmërinë me Bashkimin Evropian, ne e kemi gjithnjë e më të pasigurt të kaluarën tonë.

Dhe lufta në Kosovë tashmë shumë më tepër po kujtohet për bombat e NATO-s sesa për vuajtjet e shqiptarëve. Por, ka një botëkuptim e një mendim më të thellë në këtë nismë për gjykatën e veçantë e ky është kriminalizimi i luftërave çlirimtare dhe i kryengritjeve

të armatosura të popujve të shtypur gjithkrah nëpër botë, jo veç në Kosovë, jo veç për UÇK, por sidomos për UÇK- në e posaçërisht për UÇK- në, sepse është me kollaj se nuk kemi udhëheqje që e mbron popullin e historinë e tij, qytetarët dhe Republikën e tyre.

Deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Ato mbi 80 vota për amnistimin e kriminelëve serbë që u arritën këtu më 11 korrik të vitit 2013, po synojnë që t'i përsërisin për gjykatën e veçantë kundër pjesëtarëve...

(Ndërprerje nga regjia.)

KRYETARI: Rrumbullakoje, regjia vazhdoja fjalën!

ALBIN KURTI: Pra, prej juve që votuat për amnistimin e kriminelëve serbë tash pritet ta votoni gjykatën e veçantë, praktikisht kundër UÇK-së.

Dhe kjo do të duhej të ishte e palejueshme nga ana juaj si qytetarë të Republikës e aq më tepër si deputetë të Republikës, nëse e keni veten përnjëmend si deputetë dhe nëse e keni menduar seriozisht Kosovën si Republikë. Për fund, dua të them që ky kryeministër i cili po na e sjell këtë gjykatë të veçantë, ky me tri koncesione të mëdha erdhi në pushtet.

E para, braktisja e bashkimit kombëtar, e dyta çarmatosja e UÇK-së, edhe e treta privatizimin neoliberal. Kur i ka bërë këto tri koncesione të mëdha ky u bë kryeministër, mirëpo tash për të mbetur kryeministër duhet për të të vazhduar me koncesione, andaj janë ato pazaret e tij herë me Tadiçin, herë me Daçiçin, herë me Vuçiqin, por përherë me Serbinë.

Dhe, përfundimisht unë jam i bindur që ky kryeministër, personalisht më shumë ka kontribuar për kthimin e Serbisë në këto tre vjetët e fundit se sa për largimin e saj gjithnjë personalisht në vitet e '90. Unë i ftoj edhe Mustafën e Haradinaj, edhe deputetët e LDK-së e të AAK-së, mos iu nënshtroni këtij njeriu të nënshtruar. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputetja Donika Kadaj Bujupi.

DONIKA KADAJ BUJUPI: Faleminderit! I nderuar kryetar!

Jo për të replikuar, por po dua të theksoj që sot derisa na po flasim për këtë gjykatë speciale e cila është sjell, është e vërtetë që është sjell si dokument shumë i vonuar, i padiskutuar, pa informata e kam përmendur edhe më herët derisa Holanda, ka 10 -12 ditë, ministri i tyre i Jashtëm ka informuar me shkrim Parlamentin me dokumente përkatëse se cili do të jetë roli i Holandës, ne sot ende po flasim për pretendime, sepse kryeministri Thaçi asnjëherë nuk e pat guximin që të thotë të vërtetën mbi vendimet të cilat i ka negociuar dhe i ka marrë jo sot, jo dje, por shumë kohë më parë.

Sot, derisa po flasim janë 1 095 fëmijë shqiptarë të vrarë, për fatin e të cilëve as nuk dihet e as nuk është ngritur tribunal asnjëherë. Janë dhe vazhdojnë të gjenden kufoma në të gjitha anët, sikurse ato në Batajnicë në frigoriferë, për të cilat jo që s'është akuzuar

askush ose s'kemi pasur gjykatë speciale, por në fakt asnjëherë nuk kemi marrë përgjigje se si janë vrarë këta njerëz, kush i ka dërguar atje dhe pse janë në frigoriferë.

Pastaj kemi mbi 20 mijë gra të dhunuara, të cilat as sot nuk gëzojnë një përkujdesje institucionale në vend dhe për fatin e të cilave ose dhunuesit asnjëherë nuk është ngrit gjykatë speciale.

Kjo çështje në një qeveri ndryshe do të ishte e mbyllur, sikur të kishim një gjyqësor efikas, por ne kemi një kryeministër, kryeministrin Thaçi, i cili në të gjitha këto periudha asnjëherë nuk ka pasur vullnet politik që të mbajë duart lartë gjyqësorit dhe çdo herë ka ndikuar. Dhe me ndikimin e tij dhe të qeverisë së tij ka dështuar komplet sistemi i drejtësisë në vend.

Prandaj, në mungesë të drejtësisë nga brenda kemi mbërri dhe kemi ardhur në një moment kur duhet të instalojmë drejtësi nga jashtë. Dhe po ashtu, nuk kemi as tani informata të sakta se për çfarë bëhet fjalë, sepse asnjëherë nuk kemi pasur në Parlament një dokument kredibil i cili do të shpjegonte saktë se për çfarë bëhet fjalë.

Sot, Qeveria Thaçi na ka sjell si deputetë para një akti të kryer ku në mes të dy të këqijave, ne si deputetë të vetëdijshëm duhet të zgjedhim për të keqen më të vogël për Kosovën, dhe kjo është e vërteta.

KRYETARI: Deputeti Sasha Gjokiq e ka fjalën.

SAŠA ĐOKIĆ: Hvala gospodine predsjedniče, iako sam se prijavio među prvima, izgledaćemo mi vaše kršenje Poslovnika do kraja mandata.
Poštovani premijeru, gospodo poslanici

Ja neću ulaziti u diskusije sa mojim kolegama koji su izneli teške optužbe, ali ... preporučujem s obzirom da će de facto i de jure da specijalni sud o ratnim zločinima koji su činili svi, ja neću da pravim razliku po nacionalnoj osnovi, ako imaju validne dokaze preporučujem da i dostave sudu, inače ovo što se ovde iznosi u najmanje ruku je smešno. Mi sociodemokratija apsolutno podržavamo ovaj zakon, ali s obzirom da je u pitanju zakon, mora, odnosno treba da se ispoštuje zakonska procedura, a ovo o čemu je gospodin premijer pričao kada bude na dnevnom redu u Skupštini, gospodine premijeru razgovaraćemo i o tome. Da ne dužim dugo s obzirom da volim da pričam kratko, mi nemamo potrebe da se žurimo zbog toga što je za nas kao Skupštinu Kosova vrlo ozbiljna zakon i treba imati strpljenja, i zaključim mi sociodemokratija podržavamo ovaj zakon u cilju zadovalanja pravde za sve.

KRYETARI: I nderuar deputet, ju jeni deputet pa grup, dy deputetet serbe që gjithashtu ishin pa grup e kanë marrë fjalën dhe që ta dini ju e merrni fjalën më së mbrami, po megjithatë unë kam respektuar edhe përkatësinë tuaj nacionale.

Fjalën e ka deputeti Halit Krasniqi.

HALIT KRASNIQI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë të Parlamentit të Kosovës,

I nderuar kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar mysafirë

Fjala ime e përmbledhur do të jetë shkurtimisht e ndarë në dy pjesë, pjesa e parë do të jetë për audiencën e pranishme në këto hapësira të këtij Kuvendi dhe pjesa e dytë shkurtimisht, gjithashtu, do të jetë për protagonistët që do të trajtohen nga kjo gjykatë që sot po marrim vendim të krijohet.

Të nderuar deputetë dhe ju të pranishëm,

Dëgjuam nga parafolësit gjithçka, nuk do të ndalem te asnjëri veç e veç, do të prezantoj libër të botuar në Serbi, i cili flet për Serbinë e re 1880-1881, të gjithë të interesuarit, e botuar në Leskovc.

Të shohin krimet që i ka bërë Serbia, me autor Mita Rakiq. Librin tjetër gjithë ata që duan të shohin se çfarë ka bërë Serbia mbi shqiptarët duke i larguar nga trojet etnike të tyre deri në këto skuta, është i viti 1902, i cili është i Branislav Nushiqit, gjithashtu, i botuar në Novi-Sad.

Libri tjetër që është shumë, i botuar gjithashtu në Novi Sad, nga Branislav Nushiq, i botuar në Novi-Sad, më 1902, ku do të veçoj, ka foto origjinale të shqiptarëve duke vallëzuar në ditët e tyre të festave në Patrikanën e Pejës, asnjë me ‘shajkaçë’ kombëtare serbe, asnjë, krejt janë me veshje kombëtare shqiptare dhe plisa të bardhë. Foton tjetër të botuar, gjithashtu në këtë libër, pamje nga oborri para kishës së Graçanicës, të gjitha figurat kanë veshje kombëtare shqiptare, të cilët janë në festat e tyre të gëzimit edhe të festuara nga ata atëherë.

Këto janë tri libra të botuara në Serbi, në vitet e largëta në gjuhën e tyre dhe në alfabetin e tyre çirilicë. Këtu të gjithë të interesuarit që kanë kureshtje shkencore, dhe të gjithë ata që duan të interesohen për përplasjet në këto hapësira, i gjejnë përshkrimet se si kanë qenë shqiptarët deri thellë në Serbi me shumicë sovran, natyrisht i përshkruan të vrazhdë, të idhët në komunikim, po këto s’kanë rëndësi fare.

Në pjesën e dytë do të fokusohem për një audiencë shumë të ngushtë, për protagonistët e mundshëm që do të trajtohen nga kjo gjykatë që sot po vendosim të marrim vendim për ta themeluar, në këto hapësira i ka përfshirë edhe shumë luftëra, Lufta e Parë Ballkanike, Lufta e Parë Botërore, Lufta e Dytë Ballkanike, Lufta e Dytë Botërore. Për këto hapësira dhe për fatin tonë kanë vendosur shumë konferenca, kongrese, Kongresi i Berlinit, 1878, ua merr të drejtën shqiptarëve dhe tokat e tyre dhe ua përcjell tapitë Serbisë dhe serbëve.

Gjithashtu, edhe Konferenca e Londrës, më 1913, ia përcjell, ia përforcon Serbisë tokat e shqiptarëve dhe natyrisht që e bën ndarjen e shqiptarëve dhe tokave tyre. Gjithashtu edhe Konferenca e Jaltës vendos padrejtësisht mbi fatin tonë dhe tokat e shqiptarëve.

Në të gjitha luftërat shqiptarët ishin unik për t'i çliruar trojet e tyre, por asnjëherë nuk ia arritën për arsye se nuk e kishin faktorin ndërkombëtar në krahun e tyre asnjëherë. Tani, në këto kohë kur neve i kujtojmë, më 1998 dhe 1999, stërnipërit dhe nipërit e këtyre udhëheqësve, me përjashtim të Rusisë, përfaqësuesve të Rusisë, të këtyre konferencave, urdhërojnë shtetet e tyre, stabilizimet e tyre politike dhe ushtarak në përkrahje të vullnetit liridashës të shqiptarëve dhe të luftës së drejtë të tyre, për t'i përkrahur deri edhe në aktivizimin e bombardimeve të cilat i njohim neve si kapitullin më të rëndësishëm për fatin tonë.

Tani, përfaqësuesit e shteteve të Kuintit, po kërkojnë diçka shumë të rëndë prej neve, kanë vendosur një vullnet i cili nuk po pranohet krejt lehtë, siç e tha edhe kryeministri dhe shumë parafolës këtu në këtë Kuvend, por ngaqë neve duam të vazhdojmë kontratën me miqtë tanë të dëshmuar tani, me këta faktorë të cilët vendosim për fatin e planetit, dhe natyrisht edhe për këtë padrejtësi që do t'u bëhet atyre që do të ndiqen padrejtësisht në hetime nga kjo gjykatë, do të mundohem që të marrim mirëkuptimin e tyre dhe që dua ta kem mirëkuptimin e tyre, pavarësisht kush do të jenë të trajtuar nga hetimet e kësaj gjykate dhe jemi të detyruar shumica të paktën e grupeve parlamentare e veçanërisht e grupit tonë parlamentar që e kemi trajtuar shumë herë në mbledhjet tona të ngushta, kundër vullnetit tonë të pranojmë, të themelohet kjo gjykatë dhe të bëhen hetime për dyshime të mundshme të cilat janë të papërshkrueshme, të paimagjinueshme dhe të pamundshme absolutisht. Faleminderit!

KRYETARI: Deputeti Visar Ymeri e ka fjalën.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryetar!

Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Duke i dëgjuar këtu disa prej deputetëve që folën për çështjen që po e diskutojmë, po veçanërisht ata që ose më mirë të them apologjetët e votës së tyre për tribunalin, pra prej kryeministrit e deri te deputetët që e arsyetuan votën e tyre për, në fakt e krijova përshtypjen që nuk kanë bërë asgjë tjetër përveç se e kanë mësuar vjershën mirë. sepse, e dimë që është raportuar më herët në media se cilat kanë qenë udhëzimet se si të mbrohen para publikut për tribunalin.

Pra, vota për do të jetë sepse do të na e bëjë OKB-ja dhe kjo ishte pak a shumë kjo vjersha që e kishin mësuar. Edhe i përgëzoj për këtë recitim të them ashtu të përpiktë sa që mu dok që e kanë mësuar edhe më mirë se në shkollë fillore vjershën.

Dhe siç u përmend këtu natyrisht ky është më shumë shantazh se sa realitet, por më shumë është edhe duket si kërcënim kur thuhet në mënyrën se si u tha këtu nga kryeministri e si u tha nga deputetët.

Pra, qartazi e thanë si kërcënim, do ta bëjmë ne se na e bëjnë të tjerët, pra votojeni se na e votojnë të tjerët, pra nuk keni qare pa e votuar, sepse do të na e bëjnë ata. Dhe ky është kërcënimi që erdhi edhe nga kryeministri për deputetët, por edhe nga deputetët për deputetët. Dhe, është e vërtetë që siç u tha këtu edhe në formë të pyetjes edhe në formë të

konstatimit e mund ta bëjmë në secilin mënyrë, ky Kuvend nuk e din sot për çka po voton, nuk e dinë, sepse nuk është i informuar.

Pra, janë lënë shumë çështje jashtë dokumenteve, të cilat po quhen si detaje po që në fakt janë qenësia e kësaj gjykate. Për shembull për ta vazhduar renditjen e kësaj qenësie ose të këtyre detajeve që janë të rëndësishme për këtë gjykatë, unë do t'i pyes ata që po e mbrojnë gjykatën a e dinë se kush do t'i emërojë prokurorët edhe gjykatësit. Pra, kush do të jenë ata instanca që i emëron se rrjedhimisht instanca që i emëron do të jetë edhe instanca që e pranon llogarinë apo përgjegjësinë nga këta gjykatës edhe prokurorë, sepse nuk mund të kemi gjykatë që nuk jep përgjegjësi askujt apo jo.

Pra, kjo do të kishte me qenë një shkarje jashtëzakonisht e madhe edhe një keqkuptim flagrant i asaj, i pavarësisë dhe autonomisë së gjyqësorit. Çështja e dytë pastaj cila do të jetë koha edhe fushëveprimi. Pra, thuhet aty që do të nisë nga pretendimet e raportit të Dik Martit, thuhet aty që baza e hetimit do të jetë ky raporti i ri që do të përpilohet dhe prezantohet nga prokurori i task-forcës speciale, por nëse e lexoni me vëmendje edhe Ligjin për vazhdimin e mandatit të EULEX-it, shihet që në fakt nuk është i kufizuar vetëm këtu, sepse do të ketë prokurorë të cilët formalisht do të konsiderohen si brenda sistemit juridik të Kosovës, që do të kenë të drejtë të marrin çfarëdo rasti.

Pra, nuk përfundon fushëveprimi vetëm këtu dhe e keni vërejtur aty që është një ndryshim që mund të duket i vogël në Ligjin për vazhdimin e mandatit të EULEX-it, por që në fakt është shumë i madh, pra deri dje ose deri sot kemi folur për kompetenca ekskluzive të EULEX-it, tash po flasim për juridiksion të gjykatës.

Pra, juridiksioni e përfshin edhe kompetencën, por e përfshin edhe fushëveprimin, pra i përfshin të dyja bashkë, është një gjykatë e cila do ta ketë juridiksionin e ndarë nga sistemi gjyqësor i Kosovës.

Kush do ta financojë gjykatën është po ashtu e rëndësishme? Askund nuk është thënë edhe pse janë përmendur disa shifra se sa mund të kushtojë kjo gjykatë deri në fund, pra, supozohet se do të jetë diku 170 milionë euro e kështu me radhë, por nuk thuhet se prej kah do të vijnë këto pare, kush do ta financojë këtë gjykatë.

Edhe çështja më e rëndësishme për mendimin tim është se cilat do të jenë palët që do të kenë të drejtë të deponojnë dëshmi apo kallëzime penale në këtë gjykatë? Pra, prej cilave palëve do të pranojë kjo gjykatë këto çështje. A do ta ketë këtë të drejtë edhe Prokuroria e Serbisë, ta zëmë? Se nëse Prokuroria e Serbisë e ka këtë të drejtë, atëherë ne pak a shumë mund ta dimë që tash numrin e shqiptarëve që do të kalojnë përmes kësaj gjykate speciale, sepse e dimë që Prokuroria e Serbisë ka faktuar dosje artificiale për një pjesë të konsiderueshme të shqiptarëve të Kosovës.

Pra, nëse Prokuroria e Serbisë ka të drejtë të ketë komunikim me këtë gjykatë speciale, atëherë pak a shumë dihet se si do të jetë kjo gjykatë edhe çfarë do të veprojë kjo gjykatë.

Pra, po dihet që në bazë të letrave që i kemi, në bazë të letrave zyrtare që i kemi, të cilat i keni parë aty në versionin shqip janë përkthim jozyrtar, pra në bazë të letrave anglisht që i kemi, të cilat janë i vetmi version zyrtar që kjo gjykatë speciale do të jetë brenda, formalisht brenda sistemit gjyqësor të Kosovës, pra konsiderohet si e brendshme, por në fakt përbrenda sistemit gjyqësor të Kosovës ajo do të jetë e jashtme, sepse do të jetë super gjykatë.

Edhe njësia e hetimeve, edhe prokurorët, edhe gjykatësit nuk do t'u japin asnjë llogari institucioneve të vendit, as kryeprokurorit të shtetit, as institucioneve tjera relevante. Pra, do të jetë brenda, por do të jetë super gjykatë përmbi këtë sistem juridik, ose sistem të gjyqësisë në Kosovë.

Çfarë po ndodh këtu edhe me EULEX-in edhe me këtë gjykatë është në fakt përbrendësim i jashtësisë. Pra, po e përbrendësojmë, po e fusim brenda sistemit tonë një trup të jashtëm e cila gjithsesi do të funksionojë si e jashtme, madje-madje do të jetë edhe përmbi këtë sistem dhe kjo natyrisht që pastaj është përjashtim i së brendshmes, pra përjashtimi vendos. Ky është ai ndryshimi që po ndodh me këto që po kërkohet të votohet sot.

U fol shumë për krimet e Serbisë dhe natyrisht këto i dimë të gjithë, por duhet të përmenden shumë shpesh dhe nuk po dua t'i shtoj asaj asnjë gjë, asaj që u tha deri tash, pra nuk po dua që të përsëriten, vetëm një gjë mendoj që unë dhe që është shumë e rëndësishme që të ndodh. E keni parë që edhe Serbia i ka bërë disa gjykime të them ashtu për krime lufte të disa individëve. Pra, i kemi dy dinamika të ndryshme që kanë ndodhur pas luftës në Kosovë, në Serbi dhe në Kosovë.

Për sa kohë që në Serbi, krimet institucionale, pra të urdhëruara, orkestruara dhe ekzekutuara në mënyrë të centralizuar nga aparati shtetëror serb përmes gjykimeve janë individualizuar. Pra, Serbia nuk e ka pranuar që ka bërë vetë krime, por ka thënë “po ka disa individë që kanë bërë krime, po i gjykojmë ata”. Ndërkohë që tash çka po ndodh në Kosovë është që eventalisht krimet individuale që janë kryer po kolektivizohen, pra po i mveshen një trupe edhe një populli të tërë.

Pra, po thuhet që UÇK-ja dhe shqiptarët kanë bërë krime. Pra, a po e shini se çfarë dinamika të ndryshme që janë shumë të rëndësishme në atë se si siç u tha këtu si do të shkruhet historia për luftën e fundit në Kosovë.

Dhe, vërtet dua të flas diçka edhe për deputetin, mënyrën se si po sillemi ne, sepse është shumë e rëndësishme veçanërisht në këto çështje të ndjeshme që po i diskutojmë.

Pra, edhe siç e thotë Kushtetuta, edhe siç e thotë logjika e të kuptuarit të demokracisë parlamentare, deputeti do të duhej të ishte ai i cili nuk i nënshtrohet asnjë trysnie, siç thuhet edhe në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, pra i cili gjykon në bazë të parimeve dhe informatave që i ka, vepron vetëm për të mirën e përgjithshme, në bazë të vullnetit politik të sovranit dhe në të mirën e interesit të shtetit.

Pra, deputeti është dinjitoz, nuk është pa kurrizor, deputeti është njeri, është qenie politike, e jo amebë. Dhe në këtë drejtim, mua më së pari po më brengos dhe po më çudit fakti që në këtë Kuvend kemi alamet juristësh, ekonomistësh, të shkencave politike, madje edhe akademikë e profesorë dhe e gjithë kjo heshtje për një çështje kaq të rëndësishme dhe kaq të ndjeshme, me peshë kaq të rëndë për Kosovën.

Pra, kjo nuk po ma krijon përshtypjen që këtu kemi deputetë sot, e aq më pak deputetë që vijnë nga këto profesione dhe përvoja të ndryshme. Këtu sot, kemi disa njerëz të cilët po heshtin duke e ditur se çfarë po i ndodh Kosovës. Dhe, kjo nuk është e pranueshme, as për Kuvendin e veçanërisht nuk duhet të jetë e pranueshme për deputetët individualë. Po flas për ata, që nuk e hapën gojën sot.

Kryetar i Kuvendit të Republikës dhe ju deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, siç e përmenda edhe në fillim, Lëvizja “Vetëvendosje” e propozon një rezolutë për të njëjtën pikë për të cilën po diskutojmë, e cila është rezolutë alternative dhe që kërkon një zgjidhje tjetër nga ajo që po propozohet këtu, për çështjen e njëjtë.

Prandaj, nuk ka nevojë që të kërkojmë pikë të ndarë të rendit të ditës, i nderuar kryetar, sepse po flasim për pikën e rendit të ditës, në të cilën jemi duke diskutuar sot. Dhe, tekstin e kësaj rezolute do ta lexoj tash, duke kërkuar që kjo të votohet pasi që të përfundojë debati.

1. Kuvendi i Republikës së Kosovës, kërkon refuzimin e çdo kërkesë që pret nga Kosova pëlqimin për themelimin e Gjykatës Speciale për Krime të Luftës në Kosovë, jashtë sistemit të brendshëm të drejtësisë në Republikën e Kosovës dhe për Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës.

2. Kuvendi i Republikës së Kosovës i kërkon Qeverisë së Kosovës të mos marrë pozicionim apo të diskutojë zyrtarisht mbi këtë temë, pa marrë pëlqimin me votim të Kuvendit.

3. Kuvendi i Republikës së Kosovës i bën thirrje zyrtarisht Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, të unifikojë qëndrimet e veprimet me Kuvendin e Republikës së Kosovës, në refuzimin e kërkesës për ngritjen e gjykatës speciale si dhe dhënien e mbështetjes për sistemin e brendshëm të drejtësisë në Kosovë.

Ngarkohet Kryesia e Kuvendit ta komunikojë dhe bashkërendojë këtë kërkesë.

4. Kuvendi i Republikës së Kosovës i kërkon Qeverisë së Republikës së Kosovës t'i bashkërendojë veprimet me Qeverinë e Republikës së Shqipërisë në lidhje me kundërshtimin e kërkesës për formimin e gjykatës speciale.

Dhe, nën 5, pika e fundit, Raporti i hetimeve të Klint Viliamson, prokuror i Task-Forcës për hetime speciale në lidhje me pretendimet e senatorit Dik Marti, të përfshira në dokumentin 12462 të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës, i datës 7 janar 2011, duhet të trajtohet nga Prokuroria e Kosovës.

Institucionet shtetërore të Kosovës do ta mbështesin dhe përkrahin Prokurorinë e Kosovës, do t'i vijnë asaj në shërbim për të gjitha nevojat, si dhe shprehin gatishmërinë për bashkëpunim me faktorët ndërkombëtarë.

Pra, kjo është Rezoluta që propozon Lëvizja “Vetëvendosje”, të cilën kërkojmë nga ju që ta votoni, sepse merret, siç po e shihni, me të njëjtën çështje, po natyrisht, zgjidhja për çështjen edhe rrugëtimi drejt zbardhjes së pretendimeve...

(Ndërprerje nga regjia.)

KRYETARI: Deputeti Agim Kuleta e ka fjalën.

AGIM KULETA: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë dhe përfaqësues të ndryshëm,

Siç e dimë, deri më tani kompetencat për krime të luftës në Kosovë i ka pasur faktori ndërkombëtar, duke përfshirë Tribunalin e Hagës, pastaj UNMIK-un e deri në ditët e tashme që është në kuadër të EULEX-it.

Andaj, për ne në këtë drejtim është e paqartë pse kjo nevojë për të pasur një gjykatë tjetër ndërkombëtare, e cila do t'i trajtonte të njëjtat krime të luftës, por kësaj radhe do t'i trajtonte vetëm ato të supozuara, që janë bërë nga ana e shqiptarëve.

Për më tepër, këto si kërcënim në rast të refuzimit nga ana jonë, për pranimin e themelimit të kësaj gjykate, përmendet rreziku i themelimit të një gjykate nga Organizata e Kombeve të Bashkuara. Edhe kjo pra është një gjykatë ndërkombëtare.

Unë nuk e kuptoj pse qenka kjo gjë më e keqe se sa kjo që po na këshillojnë të bëjmë sot. Një Tribunal nga OKB-ja nuk mund të jetë përmbajtësisht ndryshe nga kjo gjykatë, kur që të dyja përmbajnë një të keqe të përbashkët e që është edhe arsyeja pse ne jemi kundër saj dhe kjo e keqe është drejtësia selektive.

Lëvizja për Bashkim konsideron se ndjekja e krimeve të luftës të kryera në Kosovë është në dobi të të gjithë qytetarëve të Kosovës, prandaj, vetëm krijimi i një gjykate, qoftë ajo vendore apo ndërkombëtare, që do t'i ndiqte të gjitha krimet e luftës në Kosovës, duke filluar nga trajtimi i të gjitha krimeve të kryera nga Serbia, do të mund të ishte në dobi të drejtësisë së vërtetë.

Misioni i drejtësisë do të duhej të ishte ndreqja e padrejtësive që bënë politika. Fatkeqësisht, kjo gjykatë është në funksion të politikës dhe një padrejtësie në raport me dhjetëra mijëra viktima, duke përfshirë edhe pjesën më të pafajshme të shoqërisë, si pleq, gra e fëmijë.

Drejtësia e pjesshme është padrejtësi, prandaj, Lëvizja për Bashkim pikërisht pse është për drejtësi të plotë, sot do të votojë kundër kësaj qasjeje të padrejtë ndaj saj.

Kemi dëgjuar shumë të thuhet e u tha edhe sot se kjo është e rëndësishme për ta përmirësuar imazhin e Kosovës tek opinioni ndërkombëtar, mirëpo, vetë themelimi i kësaj gjykate është dëmtim i imazhit, pavarësisht vendimeve të saj.

Megjithatë, unë u jam sinqerisht falënderues miqve tanë ndërkombëtarë për kujdesin e treguar për imazhin e Kosovës jashtë saj. Dhe, pikërisht duke qenë mirënjohës për këtë, konsideroj që duhet të ndjehemi edhe ne borxhlinj ndaj këtyre miqve dhe të kujdesemi për imazhin e drejtësisë ndërkombëtare te opinioni i brendshëm e një qasje e njëanshme e drejtësisë ndërkombëtare, padyshim që do ta dëmtojë shumë atë. Faleminderit!

KRYETARI: Deputeti Berat Buzhala e ka fjalën.

BERAT BUZHALA: I nderuar kryetar,
Kabinet Qeveritar,

Tregojnë për një rapsod popullor, Sali Bajramin, të cilit i kishin pas thënë: “mos fol, se po shanë edhe gjëmo, ofshaj demek kur të flasë ndokush muhalife”, sikur parafolësit, disa prej tyre, “veç ofshaj edhe mos ia kthe përgjigjen” edhe në një moment kish pas thënë “po, a i ofshahet kësaj, bre”.

Edhe unë, sigurisht, ky mund të jetë edhe fjalimi i fundit ndoshta në këtë legjislacion edhe mu duk pak e padenjë nëse nuk do të dilja dhe ta argumentoja, pse kjo nuk është një votë e dhunshme e imja, pro kësaj gjykate. Dhe, nuk e shihja të arsyeshme, që dikush të ma lexojë mua Kushtetutën dhe të më tregoj për dinjitetin.

Në Konferencën e Rembujesë është thënë: mos shkoni, se po e shitni Kosovën. Dhe, ai person është këtu.

Në Vjenë është thënë: mos shkoni, se në Vjenë po shitet Kosova.
Mos e pranoni Pakon e Ahtisarit, se po shitet Kosova.
Refuzoni gjykatën, se po shitet Kosova.

Dhe, ne sa herë kemi pranuar, ne jemi certifikuar para bashkësisë ndërkombëtare se ne nuk po e shesim Kosovën, po ne po e duam Kosovën.

Edhe në këtë rast, unë nuk mendoj që më shumë drejtësi për ne nënkupton më shumë padrejtësi për ne. Nëse ka në Serbi kriminelë të padënuar, ky nuk është problem imi, ky është problem i Serbisë.

Unë mendoj që ky do të jetë një problem afatgjatë i Serbisë nëse në gjirin e tyre edhe më tutje ka kriminelë, që nuk e kanë marrë dënimin e merituar. Pra, unë kujdesem veç për Kosovën, jo edhe për Serbinë. Është përgjegjësi e madhe imja për t’u brengosur cili do të jetë fati i Serbisë.

Pra, mos ia ngarkoni, burra, vetit atë barrë ku do të shkojë Serbia, ngarkojani vetit barrën, ku do të jetë Kosova? Unë mendoj që është e vërtetë që filtrat e drejtësisë për ne po janë

pak më të ngushtë edhe sita po është pak më e imë, mirëpo unë mendoj që kjo është në të mirën tonë.

Pra, hajde le të gjykohe mi dhe le të certifikohemi që lufta e ushtrisë çlirimtare të Kosovës ka qenë e pastër. Ky proces nuk erdhi, u tha edhe më herët, prej qiellit. Ne kurrkush nuk folëm kur dosjen e mori Klint Viliamson, një ish- prokuror, një person i cili e ka dërguar në Hagë, Slobodan Milosheviqin edhe kur ai filloi të punojë në këtë drejtim, ne thamë: “në rregull, se e ka marrë një amerikan”.

Tash, e çka t’i bëjmë asaj dosje, e cila është kompletuar edhe atë dosje është mirë dikush ta shqyrtojë, ka ardhur momenti për ta shqyrtuar. Pse, more po tutni, po paragjykoni që paska ndodhur krimi? Unë mendoj që gjatë luftës nuk kanë ndodhur krime të luftës, kanë ndodhur krime gjatë luftës, por s’kanë ndodhur krime të luftës.

Dikush ka rrahur e ka vra, e kanë bërë... por ato nuk kanë qenë krime të luftës edhe unë nuk mendoj që kjo ka qenë strategji e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Pra, nuk po besoj që ne kemi arsye t’ ikim ose t’i shmangemi drejtësisë, sepse nuk do të ketë kohë CNN-i dhe BBC-a të thotë që shqiptarët e Kosovës nuk e pranuan, sepse për këtë... ata do të raportojnë, që ne i ikëm drejtësisë. E në mënyrë që ne mos t’i ikim drejtësisë, ne i themi po këtij tribunali dhe unë i them kësaj me vullnet po, sepse unë kam qenë fëmijë, kam qenë edhe i parëndësishëm, jo relevant në kohën kur është mbajtur Rambujea, por kam qenë pro Rambujesë, kam qenë pro Ahtisarit, kam qenë pro Vjenës, kur ju keni qenë kundër.

Ku do të ishte Kosova sot nëse ne i kishim thënë jo Rambujesë, jo Ahtisarit, jo bashkësisë ndërkombëtare, jo asaj, jo secilës gjë që ka ndodhur mirë në këtë vend, i keni thënë jo dhe prapë po i thoni jo? Qorrazi nëse kisha votuar, si ju kisha parë ju duke i thënë jo, unë kisha thënë po. Nëse bash ishte dashur për të vendosur në mënyrë të verbër, sepse vazhdimisht e keni provuar që keni qenë gabim. Vazhdimisht, prej 1998-ës e tutje, e keni demonstruar, e keni mujt edhe statistikën, po mendoj ligjin, mundësinë e probabilitetit e keni dështuar se njeriu nganjëherë ia qëllon, nganjëherë s’ia qëllon, ju kurrë s’ia keni qëlluar.

Pra, kjo është. Unë mendoj që kurrkush s’ka këtu nevojë as ta ulë kokën, kjo është një proces, është një aktakuzë mund të jetë, hala nuk e dimë a është aktakuzë edhe e cila e ka kohën e vet. Ne do ta provojmë, personat që do të akuzohen ose nuk do të akuzohen, do të bashkëpunojnë me drejtësinë.

Prej kur ne të frikësohemi prej drejtësisë, lëreni Serbinë me halle të veta, i kanë problemet e veta, le të përballen me kriminelët e vet në gjirin e vet. Unë nuk mendoj që një kriminel që ka kryer krime në Kosovë, do të jetë i mirë në Serbi. Ai që ka kryer krime këtu, do të kryejë krime edhe atje.

Pra, është e rëndësishme për ne, për t’ u pastruar ndërkombëtarisht prej të gjitha akuzave që na bëhen. Mos ia leni fajin kryeministrit, që “për faj të kryeministrit ne po votojmë

vëlla, se s'kishim votuar", qysh po i dëgjoj do zëra. Duhet për të votuar se besoni ose nuk besoni. Unë për vete besoj. Faleminderit. Keni për të gabuar prapë..

KRYETARI: Regjia i bini ziles! Qeveria nëse e do fjalën, le të vijë në Kuvend dhe le ta thonë fjalën e tyre.

Të lajmëruar për diskutim s'ka, Berati i dha fund.

Prezenca fizike 102, po ka rritje më shumë. Prania elektronike është 114 deputetë.

Kryeministër, nëse doni fjalën, e keni. Mirë. Shkojmë në proces të votimit. Votojmë për prani. Votojmë tash!

114 të pranishëm.

I kam disa njoftime para se të shkojmë në proces të votimit.

Në bazë të nenit 18 të Kushtetutës të Republikës së Kosovës, Kuvendi i Republikës së Kosovës me votat e 2/3-ve e të gjithë deputetëve ratifikon marrëveshjen ndërkombëtare.

Të nderuar deputetë,

Bazuar në vendimin paraprak për shmangie nga Rregullorja e Kuvendit, neni 84 i saj, për shqyrtimin e Projektligjit për ratifikimin e marrëveshjes ndërkombëtare në mes Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian, mbi misionin e Bashkimit Evropian për sundimin e Ligjit në Kosovë.

Tani jemi te votimi. Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tash.

Konstatoj se me 89 vota për, 22 kundër dhe 2 abstenime, Kuvendi miratoi Ligjin për ratifikimin e Marrëveshjes ndërkombëtare në mes Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian mbi misionin e Bashkimit Evropian për sundimin e Ligjit në Kosovë.

Vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës:

2. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që ndërlidhen me mandatin e misionit të Bashkimit Evropian për sundimin e Ligjit në Republikën e Kosovës

Projektligji është proceduar nga Qeveria në Kuvend më 18 prill 2014. Kryesia e Kuvendit në mbledhjen e përbashkët me kryetarët e grupeve parlamentare të mbajtur më 18 prill 2014, ka vendosur që ky projektligj të shqyrtohet në seancën plenare të sotme.

E ftoj përfaqësuesin e Qeverisë, zëvendëskryeministrin dhe ministrin e Drejtësisë, në cilësinë e propozuesit që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe arsyetojë projektligjin për ndryshimet e plotësimet e ligjeve, që ndërlidhen me mandatin e misionit të Bashkimit Evropian për sundimin e Ligjit në Republikën e Kosovës.

Zoti zëvendëskryeministër e keni fjalën.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës!

I nderuar kryeministër,

Të nderuar deputetë,

Anëtarë të Qeverisë,

Zonja dhe zotërinj,

Më lejoni që në fillim t'ju falënderoj për mirëkuptimin që e patët, që të bëhet shmangie nga dispozitat dhe sot të bëhet edhe e Rregullores edhe leximi i parë dhe i dytë. Dhe, besoj që kjo lidhet edhe me funksionalitetin e rendit dhe ligjit në Kosovë, por mbi të gjitha me funksionalitetin e Kuvendit në ditët dhe javët që vijnë.

Fillimisht, dua të theksoj që qysh në qershor të vitit të kaluar, të vitit 2013, duke pasur në konsideratë përfundimin e mandatit të tanishëm të EULEX-it, në qershor të këtij viti sikur është paraparë me marrëveshje të ratifikuar në vitin 2012 dhe me vetë kërkesën e Parlamentit të nderuar të Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës ka propozuar strategjinë për transferimin e kompetencave të EULEX-it tek institucionet vendore.

Strategjia, me të cilën kemi shprehur gatishmërinë e plotë të institucioneve të Republikës së Kosovës për të marrë përsipër funksionimin e funksioneve të parapara me Kushtetutë dhe ligjet tona.

Kjo strategji, e cila u është shpërndarë në atë kohë edhe liderëve të partive politike dhe të institucioneve, ka qenë pikënisja e një procesi të gjatë të negocimit me BE-në, lidhur me prezencën e BE-së në Kosovë në fushën e sundimit të rendit dhe ligjit.

E kam përsëritur shumë herë dhe po e them prapë, që ne çmojmë punën e EULEX-it në Kosovë, që është bërë gjatë viteve të shkuara, por njëkohësisht e kam theksuar dhe po e them, që ne jemi shtet sovran dhe gjashtë vjet pas shpalljes së Pavarësisë së Kosovës, mendoj që duhet të krijohen parakushtet, që t'i marrim përgjegjësitë më të mëdha në ushtrimin e këtij sovraniteti.

Kjo ka qenë pikënisje e diskutimit të rishikimit të mandatit të EULEX-it dhe ky ka qenë insistimi ynë parimor, që t'i bindim partnerët tanë ndërkombëtar, në veçanti të BE-së, që të ndodhë një transformim i kompetencave të EULEX-it nga ato ndërkombëtare tek institucionet vendore.

Në diskutimet e shumta, përmes këmbimit të pikëpamjeve tona, por edhe gjatë takimeve direkte, që kemi pasur, por edhe përmes dokumenteve strategjike, si ai që është pozicioni i Qeverisë për këtë çështje, rishikimi strategjik i BE-së dhe qëndrime të tjera për transferimin e kompetencave, kemi ardhur deri te marrëveshja në mes të BE-së dhe Republikës së Kosovës, që mandati i misionit të tanishëm të EULEX-it me transformimet adekuate të vazhdojë deri në vitin 2016, më 15 qershor dhe me ndryshimet kryesore.

Më lejoni të theksoj, që gjatë gjithë punës sime në negocimin e kësaj pjese, kam pasur parasysh si të ushtrohet sovraniteti i plotë i institucioneve të Republikës së Kosovës, respektivisht i pushtetit gjyqësor dhe si të shfrytëzohet ekspertiza e domosdoshme dhe e nevojshme e atyre të BE-s.

Në këtë drejtim, Bashkimi Evropian ka vlerësuar progresin në Kosovë, po edhe në rishikimin e mandatit të EULEX-it në Kosovë, ka vlerësuar po ashtu të arriturat në fushën e sundimit të rendit dhe ligjit, duke u pajtuar kështu, që përgjegjësitë kryesore të institucioneve të rendit dhe ligjit në Kosovë të ushtrohen nga vendorët.

Në anën tjetër, duke respektuar Kushtetutën e Republikës së Kosovës, e cila garanton jo vetëm pavarësinë e sistemit gjyqësor dhe prokurorial në tërësi, po edhe pavarësinë e gjyqtarëve dhe prokurorëve në veçanti, në ushtrimin e funksionit të tyre dhe integritetin e rasteve, kemi arritur një pajtueshmëri, që rastet e tilla të një prokurori apo një gjyqtari nuk mund të merren, përveç nëse ekzistojnë dyshime të bazuara dhe përjashtime me pëlqimin paraprak të institucioneve vendore.

Më lejoni të theksoj që në ndryshime të shumta, që keni mundur t'i vëreni edhe në këtë draft-ligj, pikat kryesore do të konsistojnë:

E para do të jetë parimi normalisht, jo raste të reja - që nënkupton, parimisht EULEX-i nuk do të marrë raste të reja, përveç rrethanave të jashtëzakonshme, nëse është përcaktuar me ligj;

Po ashtu, të gjitha institucionet e Kosovës do të udhëhiqen nga stafi vendor, përfshirë edhe institucionet e Prokurorisë Speciale, që janë nën udhëheqjen aktuale të një prokurori të EULEX-it.

Të gjitha kolegjet, ku gjyqtarët e EULEX-it ushtrojnë funksionet, si rregull do të përbëhen nga shumica e gjyqtarëve kosovarë dhe do të kryesohen nga gjyqtarët vendorë.

Gjyqtarët dhe prokurorët e EULEX-it do të integrohen në institucionet vendore, ndërsa të gjithë ata do të riemërohen dhe emërimi i tyre do të konfirmohet nga presidentja e Republikës së Kosovës, pas aprovimit nga Këshilli Gjyqësor, respektivisht Këshilli Prokurorial për kryerjen e detyrave të tyre sipas ligjeve të aplikueshme në vendin tonë.

Po ashtu, edhe pjesëtarët e EULEX-it, të Policisë së EULEX-it do të koordinohen dhe konsultohen ngushtë me drejtorin e Policisë së Kosovës për aktivitetet e tyre, që i marrin.

Me qëllim të garantimit të zbatimit të plotë të marrëveshjes, të ushtrimit të stafit të punës dhe stafit të EULEX-it, ka qenë e nevojshme të përgatitet amendamenti i këtyre tetë ligjeve, respektivisht edhe i dy kodeve.

E para, Ligji për Prokurorinë Speciale në Republikën e Kosovës përmes këtij projektligji, në nenin 4 dhe 15, që ndërlidhet me Prokurorinë e EULEX-it është paraparë me amendamentimin e propozuar, neni 2 i projektligjit, fshihen dispozitat e nenit 15 të ligjit, ku parashihet që kryeprokuror i Prokurorisë Speciale do të jetë një prokuror i EULEX-it

dhe në vend të kësaj, siç parashihet në nenin 4 të amendamentuar, kryeprokurori i Prokurorisë Speciale do të zgjidhet një prokuror me mandat të përhjetshëm, që nënkupton prokuror vendor.

Për me shumë, në nenin 15 të amendamentuar të ligjit, parashihet që të ketë prokurorë të EULEX-it në Prokurorinë Speciale, numri i të cilëve do të vendoset me vendim të përbashkët me Këshillin Prokurorial të Kosovës, me prokurorë të EULEX-it dhe të gjithë do të jenë të integruar në Prokurorinë dhe në Këshillin Prokurorial të Kosovës.

Për arsye funksionale dhe të ruajtjes së integritetit të rasteve, është paraparë që Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës të ketë një zëvendëskryeprokuror të EULEX-it, i cili do të udhëheqë me raste në proces, të drejtuara nga prokurorët e EULEX-it.

Ligji mbi kompetencat për zgjedhjen dhe caktimin e lëndëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it është padyshim një ndër ligjet më të rëndësishme dhe më së shumti ndryshime që ka pësuar. Dhe ato më të rëndësishmet janë duke filluar nga vetë ndërrimi i emrit, nga Ligji për kompetencat për përzgjedhjen e emrit dhe caktimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, në Ligjin mbi juridiksionin dhe kompetencat e gjyqtarëve dhe prokurorëve, tregon se gjyqtarët dhe prokurorët e EULEX-it nuk do të kenë mundësi të përzgjedhin raste të reja.

Futja e një neni të ri 2, ku definohen rastet në proces me qëllim të definimit, mbi të cilat raste prokurorët e EULEX-it do t'i kenë kompetencat në bazë të marrëveshjes.

Për prokurorët si rastet, të cilat vendimi për hapjen e hetimeve është marrë para datës 15 prill të vitit 2014 dhe për gjyqtarët për rastet ku janë caktuar gjyqtarët e EULEX-it para datës në fjalë, ndryshimet në nenin 3 të ligjit aktual lidhur me kompetencat e gjyqtarëve të EULEX-it dhe procedurat penale, janë fshirë dispozitat e mëhershme në të cilat parashihej raste të shumta se kur një rast mund të caktohej nga një gjyqtar i EULEX-it, duke ndryshuar dispozitat që parashohin kompetencat e tyre në rastet e përcaktuara si në këtë proces.

Risi esenciale në këtë nen është padyshim përbërja e kolegjeve gjykuese, të cilat tani si parim do të përbëhen me shumicë të gjyqtarëve vendorë dhe do të kryesohen gjithmonë nga një gjyqtar vendor. Për shkak të rasteve specifike është lejuar mundësia, që në përputhje me marrëveshjen dhe autoritetin kompetent të EULEX-it, Këshilli Gjyqësor i Republikës së Kosovës do të vendosë që kolegji të përbëhet me shumicë të gjyqtarëve të EULEX-it.

Për më shumë, EULEX-i do të caktojë dhe do të ndihmojë implementimin e marrëveshjes së dialogut Kosovë-Serbi.

Në frymë të marrëveshjes janë përfshirë dhe riformuluar edhe dispozitat tjera, që EULEX-i gëzonte me kompetencat ekskluzive në rast të ekzistimit të kushteve për diskualifikim dhe kompetenca të presidentit të Asamblesë së gjyqtarëve, për të marrë raste të reja nga prokurorët vendorë.

Tani, është kryetari i gjykatës kompetente i cili përcakton, se cili gjyqtar do të jetë kompetent dhe do të caktohet në përputhje me rregulloret e brendshme të Këshillit Gjyqësor të Republikës së Kosovës.

Ngjashëm me rastet civile gjyqtarët e EULEX-it dhe ata ndërkombëtarë do të kenë kompetenca edhe në procesin e juridiksionit të panelit të gjykatës apo Dhomës së Veçantë të Gjykatës Supreme.

Në këtë kuptim, faktor i rëndësishëm është se gjatë ushtrimit të tyre, prokurorët e EULEX-it do të konsultohen dhe koordinojnë aktivitetet e tyre me prokurorin përgjegjës në zyrën ku ata janë vendosur.

Dy dispozita të rëndësishme janë neni 8 dhe 9, që janë shtuar, të cilat me përjashtim të rasteve të jashtëzakonshme, në asnjë rast tjetër prokurorët e EULEX-it, pa vendimin e përbashkët të kryeprokurorit të shtetit dhe autoriteti kompetent të EULEX-it, nuk mund të marrin raste të reja.

Ne kemi paraparë edhe një varg kompetencash tjera, që parashihen edhe në Kodin Penal, që parashihet sidomos në nenin 442 që ndërlidhet me juridiksionin e prokurorëve dhe gjyqtarëve të EULEX-it për raste penale duke definuar thjesht se këto kompetenca rregullohen në bazë të mandatit të EULEX-it, respektivisht marrëveshjeve dhe ligjeve në fuqi.

Po ashtu, edhe në Kodin e Procedurës Penale, ndryshimet janë në nenin 90 të referenca për Ligjin për EULEX-in, respektivisht në ndërrimin e emrit të ligjit. Edhe në Ligin për Dhomën Speciale të Gjykatës Supreme, si dhe në Ligjin për Departamentin e Mjekësisë Ligjore duke u bazuar se tani e tutje ky departament do të jetë vetëm nga udhëheqës vendorë.

Ne e kemi paraparë edhe ndryshime në Ligjin për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe në Kodin e doganës dhe akcizës. Mendoj se me këto ndryshime krijohet mundësia e qartë që gjyqtarët dhe prokurorët të punojnë bashkërisht nën ombrellën e sistemit të drejtësisë së Republikës së Kosovës dhe nën autoritetin e ligjeve dhe Kushtetutës sonë. Faleminderit, dhe ju ftoj që ta përkrahni këtë projektligj.

KRYESUESI: Faleminderit! Radha është e kryetarëve të grupeve parlamentare. Zoti Konjufca është paraqitur, në emër të Grupit Parlamentar “Vetëvendosje”.

GLAUK KONJUFCA: I nderuar nënkryetar,
Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,
Më herët për derisa ishim duke e bërë atë diskutimin e kaluar, e kërkoja fjalën për replikë, por nuk mu dha.

Replikën e pata me deputetin Buzhala dhe tash po e shfrytëzoj rastin që meqenëse mu bë e padrejtë ta shfrytëzoj bile këtë kohë timen që t’i përgjigjem.

Ky deputet tash, kohëve të fundit, e ka marrë një mision të ri që është me ia krehë bishtin Qeverisë, mirëpo ai në fjalimin e tij tha se Kosova nuk është duke u shitur.

Unë po i them që, zoti Buzhala, Kosova është shitur goxha shumë gjatë këtyre viteve dhe që më së shumti është shitur nëpërmjet mekanizmave që kjo Qeveri i ka zbuluar që parandë publike, parandë e qytetarëve të Kosovës për ta kthyer në para klanore, siç është duke e bërë partia e juaj.

Dhe pikërisht për shkak të këtyre mekanizmave ju jeni deputetë sot në Kuvendin e Kosovës.

Po t'i lexoj do kolumne aty në portalin 'Express' kur ti po shkruan që pas luftës ke pasur para vetëm sa për me e hëngër një byrek. A është ashtu? Ato kolumne po t'i lexoj dhe po shkruan që ke pasur para vetëm sa për një byrek. Tash i deklaron në konto 500 000 euro...

(Ndërhyrje)

Nejse, 400 000 ose 500 000. Këto para janë të fituara pikërisht në këtë mënyrë.

KRYESUESI: Mos dil jashtë rendit të ditës, Glauk!

GLAUK KONJUFCA: Dhe, pikërisht pse po shihet Kosova, në këtë mënyrë ju keni arritur një pasuri të tillë.

Po le t'i kthehem temës tash. Lëvizja "Vetëvendosje" prej fillimit dhe me kohë e ka artikulluar kritikën e vet ndaj misionit të Bashkimit Evropian - EULEX, dhe i ka shtruar disa prej argumenteve në fushën e sovranitetit dhe të demokracisë.

EULEX-in e karakterizojnë disa problem themelore.

Së pari, duhet të thuhet se vetë prania e një misioni të jashtëm në Kosovë, shikuar nga aspekti i sovranitetit shtetëror, del të jetë një mangësi dhe jo përparësi për një shtet me funksionalitet të plotë. Shtetet normale demokratike të Evropës nuk kanë EULEX, por po ashtu, në jemi rasti i vetëm nga shpërbërja e ish-Jugosllavisë si shtet i krijuar të cilit vazhdimisht i vendosen misione ndërkombëtare.

Në fillim ishte misioni i OKB-së - UNMIK-u, tash misioni i Bashkimit Evropian - EULEX-i.

Pra, prania në këtë rast, është deficit shtetëror dhe jo përparësi.

Së dyti, ky mision i Bashkimit Evropian që prej vitit 2008 kur u konceptua si i tillë, ushtron në Republikën e Kosovës disa kompetenca të natyrës ekzekutive, sidomos në fushën e drejtësisë në shtetin tonë. Kjo bie ndesh me thelbin e sovranitetit shtetëror.

Në Evropën e shteteve të lira e demokratike, nuk është i imagjinueshëm ushtrimi i kompetencave në sistemin e drejtësisë nga misionet e shteteve tjera.

Së treti, këta njerëz që brenda institucioneve të shtetit tonë marrin vendime të rëndësishme, nuk janë të zgjedhur as nga populli ynë as nga institucionet tona. Nuk janë as të emëruar. EULEX-i ishte një mision për të cilin nuk na pyeti askush, prandaj në këtë kuptim mund të thuhet lirisht se ky ishte një mision i imponuar.

Së katërti, njerëzit e EULEX-it të cilët veprojnë në shtetin tonë, pikërisht për shkak se nuk u zgjodhën e as nuk u emëruan nga institucionet tona, ata nuk japin llogari as për popullin e Kosovës as para institucioneve tona, në këtë rast as para Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Kjo do të thotë se mungon interaksioni elementar demokratik mes njerëzve të cilët përfshihen në vendime dhe vetë vendimmarrësve. Dhe kjo, nuk është në rregull.

Së pesti, misioni i EULEX-it vjen nga Departamenti i Bashkimit Evropian për Siguri dhe Politikë të Jashtme. Dihet fare mirë që misioni i EULEX-it, për nga definimi dhe për nga emri i tij është mision i sundimit të ligjit.

Këtu mund të vërehet një mospërputhje goxha domethënëse mes gjenezës së EULEX-it dhe mandatit të tij, sepse paradigma e sigurisë dhe e politikës së jashtme si të tillë është stabiliteti mbi të gjitha.

Dhe në atë rast kur vlerësohet se siguria dhe stabiliteti janë inkompatibile me drejtësinë, atëherë jo rrallëherë, sakrifikohet drejtësia.

Në një intervistë, për shembull, që e pat dhënë shefi i UNMIK-ut, Peterseni, në televizionin publik kjo ka qenë të Kosovës, intervista e tij, ai thotë se shpesh është sakrifikuar drejtësia në Kosovë për hir të stabilitetit.

Dhe, mua ma merr mendja se një paradigmë ka vazhduar edhe me EULEX-in, në Kosovë.

Kjo është në kundërshtim me thelbin e drejtësisë, sepse drejtësia është e verbër, apo së paku kështu duhet të jetë, ndaj pozitës politike, fuqisë financiare, ndikimit dhe kështu me radhë.

Drejtësia thotë: krimi është krim, shkelja është shkelje dhe duhet të ndëshkohet pavarësisht pasojave politike apo partiake.

Së gjashti, pikërisht për shkak të kësaj, EULEX-i përbën edhe një lloj të konfliktit të interesit. EULEX-i, pra vjen prej Departamentit për Siguri dhe Politikë të Jashtme, shefe e te cilit është baronesha Ashton, dhe ky sektor i BE-së është në të njëjtën kohë ai, i cili edhe po i ndërmjetëson negociatat ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Pra, në të njëjtën kohë

EULEX-i i zotëron edhe dosjet e korrupsionit të figurave politike të profilit të lartë në Kosovë.

Të njëjtëve njerëz t'u ua hetosh korrupsionin dhe t'u bësh tryzni për negociata me Serbinë, ky është një lloj konflikti i interesit, sepse njerëzit që janë nën hetime nuk mund ta mbrojnë interesin shtetëror, meqenëse nuk janë të lirë.

Këta njerëz nën hetime i nënshtrohen interesave tjera, meqë për ta mund të jetë, ta zëmë, më prioritare bashkëpunimi dhe dëgjueshmëria për shkak të jetëgjatësisë politike, sesa mos pajtueshmëria në pika të caktuara të cilat mund të kenë pasoja për karrierën e tyre politike.

Së shtati, ajo që duhet të konsiderohet si kundër produktive sa i përket efekteve të punës së EULEX-it ka të bëjë me perspektivën e pavarësisë dhe qëndrueshmërisë së drejtësisë vendore.

EULEX-I nuk është angazhuar seriozisht që kur të shkojë bile ta kemi një drejtësi qysh duhet, një drejtësi të fuqishme, një drejtësi të pavarur, e aftë dhe e guximshme për ta hetuar dhe ndëshkuar krimin, pavarësisht lartësisë së pozitës politike.

Drejtësia dhe prokurorët e Kosovës, fatkeqësisht më duhet ta them, se nuk janë as më të fuqishëm e as më të guximshëm se përpara ardhjes së EULEX-it në Kosovë.

Gjyqësori mbetet i dobët karshi pushtetarëve të plotfuqishëm, të cilët shpeshherë ngjiten edhe mbi ligjin. Edhe këtu ka njëfarë lloji konflikti të interesit. Në njërën anë EULEX-i nuk ka investuar që gjyqësori ynë të forcohet karshi krimit politik, e në anën tjetër na thotë se kemi nevojë për të edhe për dy vite tjera, sepse gjyqësori ende mbetet i dobët!

Pra, në njërën anë nuk investon për një gjyqësor më të fortë, në anën tjetër thotë duhet për të vazhduar, sepse e keni gjyqësinë e dobët.

Së teti, një prej problemeve më të mëdha të EULEX-it me Republikën e Kosovës është se ky mision përfundoi si neutral ndaj statusit të Kosovës, ndaj shtetësisë së Republikës tonë.

Për shkak të tryznisë së Serbisë dhe kushtëzimit për shtrirjen e EULEX-it edhe në veri të Kosovës, si dhe për shkak se 5 vendet e Bashkimit Evropian nuk e pranonin pavarësinë e Kosovës, EULEX-i u definua të qëndrojë neutral karshi shtetësisë dhe perspektivës së pavarësisë tonë.

Kjo është shumë problematike, sepse unë mendoj që një entitet i cili nuk të njeh, nuk ka mundësi të ndihmoj. Së pari është njohja. Pikërisht në njohje është reciprociteti dhe dinjiteti dhe prej njohjes rrjedhin edhe të drejtat politike dhe barazia.

Së fundi, nuk mund të mos e bëjmë edhe një bilanc të punës së EULEX-it në Kosovë. EULEX-i është qe 5 vjet në Kosovë vepron, dhe nëse i shohim rezultatet me të vërtetë do të thosha që janë të varfra, rezultate të varfra të këtij misioni në Kosovë. Mbi një miliard

euro janë harxhuar, na kanë thënë që janë duke e luftuar korrupsionin, por unë mendoj që korrupsioni ende ndodhet në majat më të larta të pushtetit në Kosovë.

Këto janë arsyet themelore të cilat e shtyjnë të mendojmë se ne nuk duhet t'ia japim përkrahjen vazhdimet të këtij mandati në Kosovë.

KRYESUESI: Faleminderit! Replikë, zoti Buzhala ka, 2 minuta, e dini.

BERAT BUZHALA: Kryesues,
Kabinet qeveritar,
Kolegë deputetë,

Glauk qenka shkruar për ta nisur këtë mandat dhe për ta përfunduar me ty, se edhe në fillim, fjalën e parë e kemi pasur unë e ti. Bile, nëse të kujtohet i ke përmendur burgjet e UÇK-së, në fjalën tënde të parë, këtu. Dhe të kisha thënë të shkosh e t'i tregosh Klint Williamsonit që ato njohuri që i ke pasur atëherë, tregoja prapë, se unë asnjëherë s'i kam përmendur e ti edhe kolegët tuaj të "Vetëvendosjes" i keni përmendur dhjetëra herë, mua personalisht, e keni përmendur një burg në Likoc. A keni shkruar të dëshmoni, Glauk? Shko, e ke, e kam këqyrë, është në arkiva. Dhe, do të kishte qenë mirë të dëshmoni, mbasi je, ke kredibilitet dhe je njeri që i njeh sendet. Kjo e para.

E dyta, e pata dëgjuar një biznesmen hungarez për revolucionin në Hungari, 1954. Edhe ai tha që kur erdhën komunistët në pushtet, erdhën me një premtim. Tha që të pasurit do t'i bëjmë më të varfër e të varfrit do t'i bëjmë më të pasur. Çka ndodhi tha në Hungari që të pasurit u bënë më të varfër e të varfrit u bënë edhe më të varfër. Pra, nuk e realizuan asnjëherë.

Unë mendoj që nëse ti vjen në pushtet, unë s'kisha pas qejf të jem në atë shtet, sepse ti synim do ta kesh t'i bësh të pasurit më të varfër e të varfërit t'i rrënosh krejt.

E sa i përket byrekut, unë hala ha byrek dhe mirë që i përmendi xhirollogaritë, nuk janë 400.000, i kam 100.000 e diçka euro në xhirollogari, e unë mendoj që ti ke në grup tëndin parlamentar njerëz që kanë blerë e kanë shitur jo përmes xhirollogarive bankare, por përmes fajdeve edhe krimit edhe gjakut. Keni blerë e keni shitur, ju si grup parlamentar, njerëz të juaj, keni privatizuar, po jo sikur unë, se unë kam bërë publikisht, se unë jam i dobët si target, nuk jam sikur ju komandantë. Unë kam qenë një njeri civil që kam hyrë këndeje dhe krejt transaksionet i kam bërë përmes xhirollogarive bankare.

(Ndërprerje nga regjia.)

KRYESUESI: Faleminderit! Kundër-replikë, një minutë.

GLAUK KONJUFCA: I kam tri gjëra për zotin Buzhala. E para, babën e tij as që e kam njohur kurrë, bile edhe këtë deri sa ia ka nisur të shkruajë.

Mirëpo, e para që dua t'i them është se për babanë e tij nuk kam dëgjuar prej tij, por prej kolegëve këtu të tij, të partisë të tij që i kam afër, ata më kanë treguar për babën e tij. Le t'i pyet ata.

E dyta, sa i përket revolucionit në Hungari, nuk është bërë në vitin 1954, po në vitin 1956.

Dhe sa i përket pasurisë, unë nuk kam asgjë kundër pasurisë të njerëzve të cilët e kanë fituar atë në mënyrë të ligjshme, po jam kundër pasurisë të atyre pushtetarëve të cilët i kanë shfrytëzuar privatizimet kriminale që kanë ndodhur në Kosovë apo tenderët me nga 5 e nga 10% për të krijuar pasurinë e tyre. Kjo është çështja.

Dhe mos të mendojë zoti Berat Buzhala që është bërë deputet, sepse e ka kalemin inteligjent, po për arsye se...

(Ndërprerje nga regjia.)

KRYESUESI: Fjalën e ka zoti Hydajet Hyseni.

(Ndërhyrje)

S'ka të drejtë. Me rregullore jo, me njoftësi po. Ta jap fjalën të diskutosh ti për këtë ligjin, e tani edhe ti mund ta shfrytëzosh diskutimin tënd siç e shfrytëzoi ai, dhe shfrytëzoje, por me Rregullore nuk kam të drejtë për ta dhënë fjalën.

Fjalën e ka Hydajet Hyseni.

HYDAJET HYSENI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Unë do të flas për ligjin dhe mendoj që më mirë se sa këto farë të shtënat personale do të ishte mirë të fokusohemi te çështjet shumë të ndjeshme e të rëndësishme që përfshin draftligji që na është sjell dhe më lejoni që të theksoj vërejtjen e parë procedurale që e thashë edhe në fillim, ky propozimligj është sjellë, dje është shpërndarë.

Jam i bindur që shumica dërmuese e deputetëve nuk kanë pasur mundësinë ta marrin më herët se sot dhe po e shqyrtojmë dhe miratojmë një ligj pa e lexuar.

Mendoj që kjo praktikë që çështje të rëndësishme të na serviren në mënyrë të vazhdueshme në këtë mënyrë, edhe po të mos e ketë qëllimin, krijon përshtypjen se po bëhet për ta kaluar pa shqyrtim, pa procedurë, për të qenë pa shqyrtim, për të qenë pa sitë.

Nuk besoj se ka arsye për të qenë që të veprohet kështu me Kuvendin. Nuk ka arsye që deputetët të vihen në situatë vazhdimisht ose të votojnë diçka që s'e kanë lexuar ose të kundërshtojnë diçka që përsëri s'e kanë lexuar.

Unë megjithatë e kam lexuar ligjin dhe më lejoni të bëj disa vërejtje.

Së pari ky ligj siç u tha edhe në prezantimin, e përshëndes dhe e përshëndes veçanërisht përpjekjen për të vënë theksin te karakteri institucional dhe i ndryshimeve që po bëhen, mirëpo shoh një mospajtim të madh, një diskrepancë në mes asaj që u prezantua në fillim dhe asaj që tash prezantohet si e modifikuar dhe ç'është e vërteta në masë të madhe është edhe në ligjin që e kemi përpara. Por, nuk e kuptoj pse kjo paqartësi, pse kjo mungesë saktësie? Janë çështje që duhen akribi juridike dhe kjo zakonisht po na mungon.

Së pari, është një derivat i asaj që ne e miratuam me të njëjtën procedurë, pa e lexuar, miratuam një letërkëmbim si marrëveshje ndërkombëtare. Për mua është e diskutueshme, është praktikë pa presedan.

Dhe, për më tepër, ky Kuvend ka miratuar tash vonë një raport të Komisionit të Jashtëm, pikërisht për marrëveshje ndërkombëtare. Ka pasur disa rekomandime që kanë pasur të bëjnë pikërisht me këto lëshime të institucioneve tona në radhë, edhe të institucionit të presidentit. Institucioni i presidentes, përsëri për mendimin tim, ka cenuar rënd madje edhe dispozitat kushtetuese në gjithë këtë qasje. E marr me mend që kjo i është imponuar, por si do që të jetë, ligji ka bartur pastaj brenda edhe disa anomali të tilla.

Nuk mendoj se është mirë t'i kalojmë ato kështu turbo, pa i shqyrtuar, sepse pas ndonjë viti, do të vijmë përsëri për t'i shqyrtuar siç po na ndodh tash të rishqyrtojmë rezolutën që ky Kuvend e ka miratuar ndonjë vit më parë, Ligjin për përmbylljen e misionit të UNMIK-ut që e ka miratuar në të njëjtën mënyrë dhe ato që kemi mund t'i korrigjojmë atëherë, tash duhet t'i kemi në tavolinë. Po vazhdojmë në të njëjtën praktikë që t'i kemi edhe pas ndonjë viti më vonë.

Më lejoni që t'i arsyetoj disa prej këtyre që thashë më përpara.

Ligji për gjykatat, e thotë shprehimisht se gjykatësit në Kosovë duhet të jenë shtetas të Kosovës. Në letërkëmbimin e saj me baroneshën Eshton, presidentja e Kosovës thotë se ajo do të emërojë gjyqtarët ndërkombëtarë të propozuar nga Këshilli Gjyqësor. Megjithatë mbetet një vakum, a ka mundësi në këtë mënyrë të legalizohet dhe a është kjo në përputhje edhe me dimensionin që po i jepen gjykatës, që po e quajmë, po e quajnë speciale edhe pse në letërkëmbim bëhet fjalë për një dhomë të veçantë, ose për dhoma të veçanta.

Ka dallim të madh zonja e zotërinj, midis gjykatës speciale ose tribunalit dhe një dhome të veçantë në kuadër të sistemit të drejtësisë së një vendi. Dhoma të veçanta kanë vendet përreth, por asnjë nuk ka gjykatë speciale. Nuk duhet të ketë as Kosova.

Po, megjithatë kjo çështje do sqaruar edhe kështu siç është në ligj.

Ose ta zëmë, kemi në një nen më vonë një ndryshim - prokurori special ndryshohet dhe bëhet prokuror me mandat të përgjeshëm. A është në rregull kjo me praktikën tonë dhe me praktikat tjera, me mandat të përgjeshëm prokurori special, dhe çka do të thotë kjo?

Ose ka një praktikë, e s'po i citoj të gjitha të gjuhës juridike që s'është juridike. Për shembull, mund të modifikohen, fjala është për struktura me vendim të përbashkët të EULEX-it dhe të Këshillit të Pavarur të Kosovës, për prokurorë të Kosovës edhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës, po nuk e sqaron ligji si bëhet kjo. Ligji s'mund të durojë formula - mund të bëhet, sepse shkakton probleme në interpretim pastaj më vonë.

Ose, ne themi që prokuroria e gjykata do të jenë në kuadër të sistemit të drejtësisë së Kosovës dhe kjo është mirë shumë dhe mendoj se duhet të insistohet në të. Por thuhet pastaj, në kuadër të sistemit juridik bëhet fjalë për gjykatës e prokurorë të cilët nuk do t'i nënshtrohen as mbikëqyrjes së Prokurorisë ose Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe madje as drejtuesve të tyre. Çka me llogaridhënien e tyre?

Në Asamblenë Parlamentare të Këshillit të Evropës jo më vonë a ma larg se 2 muaj më parë, është miratuar një raport dhe një rezolutë me rekomandime, pikërisht për përgjegjësinë dhe llogaridhënien e përfaqësuesve të organizatave ndërkombëtare në misionet paqeruajtëse dhe paqëndrues. Kosova është marrë si një shembull ku ka pasur lëshime të shumta. I duhet një llogaridhënie demokratike dhe një kontroll demokratik edhe përfaqësuesve të misionëve ndërkombëtare në vende të ndryshme të botës.

Ligji jo vetëm që s'e bën këtë, po praktikisht e legalizon shpëputjen e plotë edhe nga mbikëqyrja. Nuk e kuptoj si të drejtë.

Ose ta zëmë ka formulime të këtilla, po i marr edhe si ilustrim se duhet të punohet në amendamentimin e tij. Për shembull në nenin 6, me kërkesën e bazuar, në shqip, në anglisht reshenal, do të thotë të arsyeshme që s'është e njëjta gjë, çka është e arsyeshme, çka është e bazuar, kush e vlerëson? Te EULEX-i thotë, Këshilli Gjyqësor mund të vendosë që shumica të jenë me shumicë ndërkombëtare, por jo vetëm që është gjuha jo juridike, por edhe formula është problematike, nuk ka si zbatohet. Kush konsideron a është e arsyeshme, a është e bazuar, a është racionale dhe si mund të funksionohet në këtë mënyrë. Mund të kemi edhe vërejtje të tjera, por po e shkurtoj fjalën time, sepse edhe këto që i thashë i kisha më shumë si ilustrim të faktit që jam munduar ta them edhe në fillim të kësaj seance për nevojën e trajtimit të përgjegjshëm edhe të çështjeve që i shqyrtoam sot, edhe të ligjit që e kemi në procedurë.

Besoj që do ta bëjë komisioni, nëse i krijohet hapësirë. Praktikën që sot ta marrim ligjin pasdite e ta shqyrtojmë në lexim të parë e të dytë, pa pasur mundësi për të bërë amendamente, është dëshmuar në praktikën tonë si problematike, për të mos thënë edhe manipulative. Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti Idrizi e ka fjalën.

NIJAZI IDRIZI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Mua më shumë më interesoi ta di vetëm një fakt. Në njëfarë mënyre ne e kemi hequr mbikëqyrjen ndërkombëtare më 10 shtator 2012, por me këtë projektligj po del sikur një

gjë e tillë nuk ka ndodhur. Prandaj, edhe kam dëshirë ta di - a thua po rikthehet ajo mbikëqyrja, apo si është puna këtu? Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Buzhala e ka fjalën.

BERAT BUZHALA: Thonë, 'me çka i marri krenohet, të mençurit i vjen marre'. I marri, budalla po mendoj.

Unë filloj të dyshoj në begraundin tonë prej filozofi, kur ty të shoh duke u marrë me politika tribale të fshatrave dhe me thashetheme. Ti thua 'më ka thënë dikush, e kam dëgjuar dikë'. Shko, ja ku është Çabiqi, pyet dhe atë jo veç babanë tim, të cilin e përhëndes për çdo rast, dhe e kam xhan, por janë rrahur 50 veta në Çabiq në mënyrë tribale, në mënyrën më kriminale të mundshme.

Pra, po dua të të thënë që nuk është në dinjitetin tënd të merresh me këso çështje, por me që merresh po t'i them. Lotët e krokodilit, Glauk, nuk e di nëse e di pse qan krokodili - krokodili qan kur e han prenë e vet, dhe duke e përtypur prenë, fillojnë dhe i dalin lotët. Pra, kështu më duket mua kur ju shoh t'u qarë për këtë çështje, më duket se janë sikur lot të krokodili, se në anën tjetër e përjetoni njëfarë kënaqësie që ndoshta po realizohet ky tribunal dhe po shkojnë këta njerëz - pra lot krokodili.

Edhe çështja tjetër, a mund të më tregosh si u realizua kaq shpejt selia e juaj në Prishtinë, ku qiraja e PTK-së aty, ngjitur me ju, është diku 16 mijë euro në muaj. Kaq shpejt me këtë pushtet, plus e keni përzier pak biznesin edhe partinë. Në kuadër të objektit tuaj ka edhe objekte biznesore, tregtare e këso gjërash.

KRYESUESI: Futu në temë, Berat! Atëherë Glauku, replikë!

GLAUK KONJUFGA: Po shikoni, sa i përket punës së tribunalit, unë e di që këtu disa prej deputetëve të PDK-së, në të cilën është edhe zoti Buzhala, u qanë zemra për të votuar kundër tij. Mirëpo, për shkak të presioneve e kështu me radhë kanë votuar për, mirëpo thellësisht e di që disa prej tyre nuk pajtohen me këtë tribunal. Ama kur flasim për Berat Buzhalën, ky e ka edhe një satisfaksion të veçantë pse u votua ky tribunal, jo veç pse po voton për shkak se nuk ka mundësi ndryshe.

Edhe sa i përket kësaj se kush jemi për e kush jemi kundër tribunalit, unë më së miri mendoj se vota e tregon. Vota e sotme! Ju a e patët rastin të votoni kundër këtij tribunali, e këta janë lotët e krokodilit, nëse je duke folur për lotët e krokodilit. Të thuhet që shumë keq është të votohet për tribunalin, e kur të shikosh aty votën, e ke dhënë pro tribunalit. Tregoje me votë, tregoje me vendime që nuk i ke lotët e krokodilit kjo që po të dhimbset UÇK-ja.

KRYESUESI: Kundër-replikë, zoti Buzhala!

BERAT BUZHALA: Unë e kam veç një çështje: Nëse unë qenkam ai me satisfaksion, ku është ai nipi i atij 'stupcit', si e ka emrin ai Sherif Stupci, se edhe ai juaji, ai Florini, edhe

ai i përmendte burgjet e gjërat. Nuk ka përmendur, keni përmend ju. Pra, nuk është që unë e kam nisur këtë temë, e keni nisur ti dhe ai nipi i Sherif Stupcit. Ju dy e keni përmendur sefte në televizion dhe gjithkund. Nuk e kam përmendur unë. Nëse do të kishte qenë satisfaksion imi, unë do të kisha dërguar dosje siç keni bërë ju, por unë nuk kam dërguar dosje.

Unë, Glauk, për dallim prej teje, unë e kam kaluar komplet jetën time në mall, në luftë dhe e kam humbur dikë gjatë luftës, dikush më është vrarë në luftë. Çfarë ke humbur t'i, përveç pulave të atij axhës tënd, nëse ia kanë mbytur ndonjë, se asgjë nuk keni humbur në luftë. T'i nuk ke emocion për luftën!

GLAUK KONJUFCA: Po veç kur ke zbrit prej mali, nuk të ka rënë keq!

BERAT BUZHALA: Po, nuk më ka rënë keq se ndoshta kryet e kam pak më të mirë se ti, po mendoj.

KRYESUESI: Fjalën e ka zonja Haxhiu.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit, kryesues!

E para, për ne si subjekt politik është i papranueshëm edhe fakti që me procedimin e këtij projektligji në Kuvend janë shpërfillur gjitha procedurat e parapara me Rregulloren e Kuvendit, njëjtë sikur ndodhi edhe me Marrëveshjen e dëmshme Thaçi-Daçiq, gjithashtu edhe miratimin e Ligjit për amnistinë e krimineleve serbë dhe tash së fundi me miratimin e themelimit të Gjykatës Speciale, e cila, në fakt, e njollos luftën e drejtë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Kjo nguti dhe kjo shkelje e procedurave, pra shmangie e procedurave, siç po quhet, është absolutisht e paarsyeshme dhe e papranueshme. Pra, Kuvendi duke e keqpërdorur mekanizmin e shmangies po vendoset para mospërfilljeve të procedurave për çështje që kanë të bëjnë me aspekte shumë të rëndësishme për funksionimin e shtetit dhe për çështje të cilat janë të ndjeshme dhe shumë të dëmshme për Kosovën.

Në këtë rast, projektligji që e kemi para vetes përfshin gjithsej 8 ligje nga fusha e sistemit të drejtësisë, policisë dhe doganave.

Në nenin 2 parashikohet që prokurori special të transformohet në prokuror me mandat të përvetshëm. Mirëpo, këtë mandat në republikën tonë e ka vetëm kryeprokurori dhe atë mandat të përhershëm, e jo të përvetshëm. Me këtë sanksionim, Republikës së Kosovës do t'i shtohet një "kryeprokuror" i cili është paralel me atë të shtetit.

Më tej, ndryshimi i nenit 15 të ligjit në fuqi, pra ai për prokurorinë speciale në Republikën e Kosovës, konsiston në krijimin e mundësisë ligjore që brenda strukturës së Prokurorisë së Republikës së Kosovës, që përbëhet prej dhjetë prokurorëve publikë, që krahas këtyre prokurorëve të angazhohen edhe prokurorët e EULEX-it. Rregullimi i kësaj çështjeje është i bazuar, jo mbi bazën e numrit të caktuar ligjor, por është lënë në

konsultimin e autoriteteve të Kosovës me EULEX-in, gjë që është e dijshme se për këtë EULEX do ta shtrijë kontrollin në Prokurorinë e Republikës së Kosovës.

Në ligjin në fuqi, pra atë për Prokurorinë Speciale, nuk është paraparë shprehimisht se posti i zv.kryeprokurorit do t'i takojë një prokurori të EULEX. Tani me ndryshimin e nenit 15, kjo gjë do të sanksionohet. Sipas formulimit në projektligj, prokurorët special të EULEX-it do t'i përgjigjen këtij zv.kryeprokurori, çka lë të kuptohet se prokurorët e EULEX-it nuk do t'i përgjigjen fare kryeprokurorit të Republikës së Kosovës.

Praktikisht, pra Prokuroria e Republikës së Kosovës po kthehet në një sistem paralel brenda sistemit prokurorial të Kosovës. Dhe ne gjatë gjithë kohës e kemi dëgjuar kryeministrin dhe ministri e Drejtësisë që na ka thënë se do ti hiqen kompetencat ekzekutive EULEX-it, ndërsa në këtë projektligj shihet qartë se fare nuk po hiqen, por ato po fuqizohen dhe po instalohen brenda institucioneve vendore.

Gjithashtu sipas këtij projektligji do të shtohet një nen i ri me numër rendor 16, e që njeh të drejtën e themelimit të misionit të veçantë të EULEX-it në Kosovë, që do të materializohet me një marrëveshje ndërkombëtare ndërmjet të BE-së dhe Kosovës, që do të ratifikohet gjatë muajit prill. Brenda kësaj marrëveshjeje do të përfshihet edhe themelimi i Gjykatës Speciale dhe sipas kësaj del se ajo do të themelohet nën ombrellën e BE-së, jashtë juridiksionit të Kosovës.

Më tej, misioni i veçantë i cili do të veprojë në kuadër të EULEX-it (Task Forca Speciale Hetuese (SITF)), do të jetë njësi tërësisht autonome dhe e ndarë, jo vetëm nga mbikëqyrja vendore, por edhe ajo ndërkombëtare.

Pra, praktikisht, i është dhënë autonomi e plotë nga institucionet vendore dhe EULEX-i. Kjo njësi është duke u sanksionuar me ligj të Kosovës, si një entitet jashtë varësisë dhe hierarkisë së sistemit të drejtësisë. Pra, kjo më së paku kjo është e jashtëligjshme dhe më së shumti është jokushtetuese.

Neni 3 i projektligjit e tregon qartë zgjerimin e pushtetit të EULEX-it në Kosovë në krahasim me mandatin e kaluar. Vetë autonomia e plotë, të cilën e gëzon task-forca speciale hetuese brenda sistemit prokurorial më së miri e tregon që me të vërtetë ky mision do të ketë juridiksion të veçantë, e që realisht përfshin edhe kompetencën, edhe fushëveprimin.

Përderisa në ligjin bazik, përkufizimi i “EULEX KOSOVË” do të thotë Misioni i Politikës Evropiane për Siguri dhe Mbrojtje i vendosur në Kosovë nga Bashkimi Evropian; tani me ndryshimin e këtij ligji ky përkufizim është ndryshuar në “EULEX-i në KOSOVË”, e që nënkupton Misionin e Sigurisë dhe të Politikave të Përbashkëta të Mbrojtjes të vendosur në Kosovë nga Bashkimi Evropian.

Pra, misioni tani i ka ndërruar prioritetet, më parë ishte politika e jashtme e BE-së, ndërsa tani kjo politikë është duke u zëvendësuar me politikën e sigurisë. Nuk ka dyshim se zgjerimi i kompetencave ekzekutive, sidomos në gjyqësi, është duke e krijuar një situatë të re e cila i përgjigjet edhe themelimit të Gjykatës Speciale, që e bëtë më parë.

Më tej, ajo që do të vazhdojë të mbetet në shqyrtim nga gjyqtarët e EULEX-it janë çështjet që ndërlidhen me rastet që bien nën juridiksionin e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet që kanë të bëjnë me Agjencinë e Privatizimit dhe rastet që bien nën juridiksionin e Panelit të Apelit lidhur me vendimet e Komisionit të Kërkesave Pronësore të Kosovës sipas ligjit në fuqi. Me këtë shihet vazhdimësia e kontrollit të lëndëve të ndjeshme nga rastet civile, siç është rasti i Manastirit të Deçanit, e po ashtu edhe me çështjet pronësore me karakter etnik.

Neni 4, paragrafi 4, thuhet “EULEX-i në Kosovë do të emërojë gjyqtarë që ndihmojnë lidhur me zbatimin sipas marrëveshjes së dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë të ndërmjetësuar nga BE”. Ky paragraf ose kjo pikë është më e rrezikshmja e këtij projektligji, pasi ne kemi informacion që bëhet fjalë për emërimin e 300 gjyqtarëve të përkatësisë serbe. Kjo është marrëveshja që ka bërë Hashim Thaçi në Bruksel dhe që nuk e ka thënë publikisht. Pra, emërimi i këtyre 300 gjyqtarëve serbë nuk do të kalojë nga Këshilli Gjyqësor siç e kërkon ligji, por vetë EULEX-i do t’i emërojë, ose thënë më mirë do t’i caktojë.

Në këtë grup prej 300 gjyqtarësh as nuk dihet se kush janë këta individë, as cilat kritere i plotësojnë. Ky do të mbetet ekskluziviteti i EULEX-it, duke i dhënë një goditje të tmerrshme sistemit të drejtësisë në Kosovë.

Ndërsa në nenin 4 dhe 5 pritet të krijohet hapësira për formimin e Gjykatës së Apelit vetëm për serbët në veri, dhe jo vetëm. Më tej, sipas riformulimit të nenit 7 të ligjit bazik, me projektligj, prokurorëve të EULEX-it u është rezervuar prania në Prokurorinë Speciale, dhe në këtë mënyrë do të jenë kompetentë për ndjekjen e veprave penale që janë nën kompetencën e Prokurorisë Speciale, e që janë të përcaktuar me ligjin mbi PRKS-në.

Në këtë nen vendoset praktikisht dyfishësia e sistemit prokurorial, praktikisht në zbatimin e përditshëm apo në shqyrtimin e rasteve do të ketë një mbi-mbikëqyrje që do t’i qëndrojnë në kokë prokurorit vendor, derisa ta dobësojnë përfundimisht atë.

Në këtë projektligj po ashtu është shtuar një nen i ri me numër rendor 8, që në rrethana të jashtëzakonshme u njihet autoriteti prokurorëve të EULEX-it, që edhe jashtë kompetencave të përcaktuara me këtë ligj, në konsultim me kryeprokurorin, ta marrin një lëndë të caktuar, edhe pse fillimisht për to nuk janë zhvilluar procedurat hetimore.

Më tej, neni 11 i këtij projektligji do t’i rikonfirmojë kompetencat e policisë së EULEX-it brenda komponentit të veçantë. Madje, tani në mënyrë eksplicite, policisë së EULEX-it do t’i njihen kompetencat e plota që parashihen me Ligjin për Policinë, pra që t’i ushtrojnë ato kompetenca.

Po ashtu, në këtë nen konstatohet ekzistimi i njësisë së veçantë të hetuesve policorë në kuadër të SITF-it, i cili do të kontrollohet ekskluzivisht nga prokurorët e SITF-it. Kjo e konfirmon edhe një ndërhyrje të veçantë në sistemin e policisë, njëjtë sikur në atë të prokurorisë, që ka të bëjë me hetuesit e SITF-it në Prokurorinë e Republikës së Kosovës

dhe se baza për këtë citohet të jetë marrëveshja ndërkombëtare ndërmjet Kosovës dhe BE-së.

Në nenin 8 parashihet ndryshimi i ligjit për mbrojtjen e dëshmitarëve. Dhe, ky ndryshim parasheh asistencën e EULEX-it në mbrojtjen e dëshmitarëve, por çfarë asistence teknike mund të japë EULEX-i përderisa dëshmitarët në Gjermani nuk janë gjallë? Merreni me mend tash këtë!

Në fund, edhe një herë, ne e kundërshtojmë fuqishëm praninë e EULEX-it pikërisht duke u nisur nga parimi i shtetit sovran, pasi shteti sovran nuk mund të ketë brenda vetes formacione me kompetenca ekzekutive, e aq më tepër ato të cilat janë neutrale karshi statusit të shtetit, që i bie të mos e njohin vetë ekzistencën e shtetit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Topalli e ka fjalën.

FATON TOPALLI: Të nderuar deputetë,

Të nderuara deputete,

Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve ndërlidhen me mandatin e misionit të Bashkimit Evropian për sundimin e ligjit në Republikën e Kosovës vjen 5 minuta para orës 12:00, jo vetëm në përfundim të mandatit të EULEX-it, por edhe në përfundim të mandatit të Kuvendit të Kosovës, duke e detyruar Kuvendin që në afat prej 5 ditësh ta shqyrtojë një ligj me rëndësi të veçantë për integritetin e vendit.

Jo më shumë se 3 muaj më parë, Qeveria e Kosovës na thoshte se ishte e gatshme për t'i marrë kompetencat EULEX-it. Madje, ajo e kishte përgatitur një strategji të caktuar dhe një projektligj, i cili do të merrej me përfundimin e mandatit të EULEX-it. Sot, e njëjta Qeveri kërkon prej nesh t'ia zgjasim mandatin EULEX-it, duke i dhënë atij kompetenca shtesë dhe duke ia zgjatur mandatin pavarësisë së mbikëqyrur. Cilit qëndrim t'i besojmë - atij që Kosova ishte e përgatitur dhe e gatshme t'i marrë kompetencat e EULEX-it, apo qëndrimin të sotëm që kjo gatishmëri mungon dhe Qeveria nuk i ka kryer detyrat e shtëpisë për ta përfunduar suksesshëm këtë mision?

Misioni i EULEX-it në Kosovë, prej themelimit të Bashkimit Evropian e deri me sot, është misioni më i madh për siguri dhe mbrojtje. Prej vitit 2007 e deri në vitin 2011, Bashkimi Evropian ka investuar 1,2 miliard euro për sundimin e ligjit në Kosovë.

EULEX-i ka 2 500 punonjës të fushave të ndryshme, një numër i madh që u ofrohet edhe disa ushtrive të vendeve të vogla. Me gjithë përmasat e mëdha të misionit të EULEX-it për sundimin e ligjit, prej vitit 2008 e deri më sot nuk ka pasur ndonjë ndryshim përmbajtësor në arritjen e objektivave të përcaktuara prej tij, gjë që ka ndikuar në uljen e reputacionit të misionit të popullsisë vendëse, sidomos pas lajmeve që disa gjyqtarë dhe prokurorë të EULEX-it janë duke u hetuar për shkak të dyshimeve se kanë marrë rryshfet nga disa avokatë vendorë në lidhje me rastet e krimeve të luftës.

EULEX-i dështoi në fushat që i konsideronte me prioritet, si mbështetjen e gjyqësisë, policisë apo luftës kundër korrupsionit. Skandalet në Polici, si ai i 25 prillit të vitit 2009,

në Dhomën e Dëshmime të Policisë së Kosovës, ku u vodhën 50 kilogramë drogë, e disa qindra-mijëra euro e valutë e huaj, dosje hetimesh, apo rasti i vjedhjes së 25 kilogramë ari në stacionin e Policisë në Pejë, pastaj skandali i pasaportave në Ministrinë e Punëve të Brendshme, gjykatësit dhe prokurorët e korruptuar dëshmojnë dështimin e misionit të EULEX-it, e sidomos duke pasur parasysh edhe dështimin e tij në veri.

Kriminaliteti në strukturat e shtetit, të cilat duhet të reflektojnë siguri gjatë misionit të EULEX-it, jo vetëm që nuk është ulur, por ka ardhur duke u rritur. Nëse në vitin 2011 ka pasur 46 kallëzime penale për policë, në vitin 2012 numri i policëve të hetuar për vepra penale është rritur për afro 500%. Kjo jo për shkak të angazhimit të EULEX-it, por për shkak të shtimit të kriminalitetit të ne.

Gjykata Evropiane e auditorëve në raportin për punën e EULEX-it, në tetor të vitit 2012, konsideron se misioni nuk ka qenë mjaft efektiv. Auditori evropian thotë se, edhe pse Bashkimi Evropian ka ndihmuar në ndërtimin e kapacitetit, sidomos në fushën e Doganave, asistencë për Policinë dhe për Gjyqësorin, ka pasur një sukses shumë modest. Niveli i krimit të organizuar dhe korrupsioni në Kosovë ende mbeten të larta.

Gjyqësori vazhdon të vuajë nga ndërhyrja politike, joefikasiteti dhe mungesa e transparencës dhe implementimit, ndërsa autoritetet e Kosovës nuk i japin prioritet sundimit të ligjit.

Intervenimet e Bashkimit Evropian kanë pasur rezultate të kufizuara në ndalimin e korrupsionit, i cili ende mbetet një shqetësim i madh. Më 10 nëntor të vitit 2009, me rastin e fillimit të punës të misionit të EULEX-it në Kosovë, kryeministri i Kosovës patë deklaruar se në veri nuk do të ketë më struktura paralele jolegjitime për sundim të ligjit dhe një legjislacion të vetëm. Tre vjet më vonë, vetë Gjykata Evropiane e Auditorëve thotë se pothuaj se nuk ka pasur fare progres në sundimin e ligjit në veri të Kosovës. Ky bilanc i shkurtër i storieve të dështimit të misionit të EULEX-it shton pikëpyetjen para çdo qytetari të vetëdijshëm se a duhet vazhduar një mandat i cili lirisht mund të quhet “mandat i dështimit”. Bashkimi Evropian ashtu si edhe Lëvizja “Vetëvendosje” nuk kanë ndonjë dallim esencial sa i përket vlerësimit të situatës ku korrupsioni, dështimi i aparateve themelore të shtetit, si: gjyqësori, policia, prokuroria dhe doganat, kanë degraduar aq shumë sa kanë ngulfatur funksionimin e shtetit.

Dallimi thelbësor qëndron në rrugën që duhet ndjekur për ta ndryshuar situatën. Nëse i referohemi vlerësimeve të raportit të auditorit, por edhe të shumë politikanëve evropian se politika, kjo shprehje nënkupton qeverinë, po ndikon gjyqësorin, nuk ka prioritet luftën kundër korrupsionit, nuk mbështet sundimet e ligjit, atëherë qasja që këto probleme të rregullohen me një mision të sigurisë dhe mbrojtjes është e gabuar.

Sistemi gjyqësor në Kosovë është krijuar nga politika aktuale e Qeverisë dhe jo politika nga sistemi gjyqësor. Nëse duhet ndryshuar diçka, për të vënë bazat e një shteti juridik, duhet ndryshuar fillimisht politika dhe pas ndryshimit të politikës do të vjen edhe ndryshimi i gjyqësorit. Në këtë kuptim mbështetja më e mirë e Bashkimit Evropian dhe e Shteteve të Bashkuara për qytetarët e Kosovës, për sundimin e ligjit, për luftën kundër

korupsionit do të ishte një deklaram i qartë dhe pa keqkuptim se kjo qeveri është fajtori kryesor për korupsionin, për krimin e organizuar, për shkeljen e ligjeve dhe për dështimin total në funksionimin e shtetit.

Pikërisht, për shkak që kemi një qeveri çfarë është kjo sot, në Kosovë, misioni i EULEX-it ka dështuar dhe do të dështojë përsëri, sepse këta po i bien samarit dhe jo gomarit.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Ymeri e ka fjalën.

VISAR YMERI: Faleminderit, nënkryetar!

Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

U përmend këtu, por dua t'ua përkujtoj edhe njëherë që më 25 korrik të vitit 2013 ky Kuvend e ka miratuar një rezolutë të sponsorizuar nga Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e veçanërisht nga deputetët Kurtan Kajtazi dhe Valbona Dibra, në të cilin thuhej që, kërkojmë nga Qeveria, pra pikën 1 po e lexoj: "kërkojmë nga Qeveria e Republikës së Kosovës që deri më 1 shtator 2013 të sjell në Kuvend planin tranzicional drejt përfundimit të mandatit të EULEX-it, më 15 qershor të vitit 2014". Përfundimit, jo riformatimit, jo vazhdimit e veçanërisht jo trashjes që po na ndodh tash.

Pra, këta deputetë që e kanë votuar këtë rezolutë e më sa më kujtohet mu kanë qenë Grupi Parlamentar i PDK-së, Grupi Parlamentar i "Vetëvendosjes" edhe mbase edhe disa deputetë tjerë, dua t'i pyes tash a i kanë ra pishman apo nuk po e dinë se çfarë po ndodh? Pra, cila është arsyeja që tash po shprehen që janë për ta votuar ligjin që ia vazhdon edhe e riformaton mandatin e EULEX-it.

Pra, a e kanë ndryshuar qëndrimin prej në këtë periudhë që është diku 8 muaj, po besoj, çka i ka shtyrë për ta ndryshuar këtë qëndrim, a është ndonjë farë besimi i verbër që u përmend këtu apo vërtet janë bindur nga një arsye që duhet të vazhdohet mandati i EULEX-it, apo thjeshtë s'e kanë pasur sinqerisht as atëherë?

Thjesht, atëherë e kanë bërë për konsumim publik që po thuhet edhe pse s'ka qenë kohë fushate, por për ta është gjithë fushatë. Pra, cila është arsyeja? Sepse, kushdo që e ka lexuar ligjin për të cilin po flasim tash e po pajtohem këtu me deputetin Hyseni që tha që shumëkush s'e ka lexuar fare, sepse po shihet edhe nga fjalimet dorën në zemër, që s'kanë qa kokën fare as s'kanë kurrfarë interesimi për ta kuptuar çka po ndodh aty, e sheh që mandati i EULEX-it, përkundër formimit të gjykatës së veçantë po shkon duke u vështirësuar më shumë. Pra, po shkon duke u rënduar më shumë. Më kujtohet kur diskutohej këtu për Planin e Ahtisarit dhe për mandatin e EULEX-it, u pat përmend në këtë Kuvend, ne s'kemi qenë atëherë pjesë të Kuvendit, një pyetje: sa kilëshe na u ka bërë kjo prania ndërkombëtare, edhe tash unë po ju pyes a po e dini sa killa tash po bëhet EULEX-i këtu, apo e dini që po i shtohen kilogramët EULEX-it, sepse EULEX-i tash përveç që po e zgjeron fushëveprimin, pra po i jepet juridiksion i ndarë edhe çka është edhe më me rëndësi po futet në secilën instancë të institucionit të Kosovës.

Pra, ajo që e thashë më herët po përbrendësohet e jashtëmja edhe njëfarë mënyre këtu po përjetësohet e jashtëmja edhe pse në versionin anglisht thuhet “ po bëhet i përhershëm”, pra po bëhet i përhershëm ajo që është konsideruar të jetë e përkohshme.

Sepse, ju kujtohet që në fillim të mandatit të EULEX-it thuhej që EULEX-i do të rishikohet edhe lihej përshtypja pra për të tingëlluar mirë që ky rishikim përherë do ta bëjë edhe më të lehtë EULEX-in derisa të shkojë ai përfundimisht.

Kështu na është thënë edhe në procesin e decentralizimit, dorën në zemër, thuhej që do të rishikohej decentralizimi pas dy vjetëve dhe do të përmirësohet ai, në fakt decentralizimi nuk është që s’është rishikuar, u rishikua, u centralizua etnikisht, u krijua asociacioni i komunave me shumicë serbe nga komunat e decentralizuara me shumicë serbe. Dhe, tash edhe EULEX-i po rishikohet, po bëhet edhe më i vështirë.

Pra, rishikimi në fakt nuk po e bie përmirësimin, rishikimi nuk po i shton sovranitet Kosovës, por po i merr më shumë edhe atë pak sovranitet formal që e kemi pasur tash po e humbim me këto vendime të reja.

Kur te lexon letrën e Presidentes Jahjaga që ia ka dorëzuar Ketrin Eshtonit të Bashkimit Evropian e sheh që në fakt letra e Jahjagës është shkruar nga Ketrin Eshtoni. Pra, përpiluesi i tekstit të Jahjagës është Ketrin Eshton, e mbas saj Jahjaga e ka përpiluar letrën Eshtonit, atë tekstin e shkruar aty ku thotë që po e pranoj letrën tuaj. Mbas atë e ka shkruar Jahjaga, këtu nuk kam dyshim, mirëpo, ky tekst definitivisht nuk është i shkruar nga Jahjaga.

Po të kishte qenë do të ishte edhe më keq, sepse kur te lexosh tekstin e sheh në pak çka po thotë presidentja e një vendi sovran, po thotë që ne nuk po mund ta ndërtojmë sistemin e gjyqësisë apo jo, nuk po dimë ta funksionalizojmë atë e rrjedhimisht na duhet ndihma nga jashtë. Pra, presidentja e një vendi po e pranon që vendi i saj nuk po di të ndërtojë shtet.

Po a ka mëkat më të madh politik, edhe gabim më të madh politik se të thuhet që vendi im nuk po di të ndërtohet? Edhe ne e dimë se teze e kujt ka qenë kjo historikisht, apo jo.

Serbia ka thënë vazhdimisht që shqiptarët s’dinë të bëjnë shtet, nuk e kanë atë aftësi. Edhe tash presidentja e vendit po e thotë të njëjtën gjë, ne nuk po dimë për të bërë shtet pra hajdeni ju edhe këqyrni nëse mundeni të na bëni këtë sistem gjyqësie.

Sepse, sistemi i gjyqësisë, sistemi juridik është baza e shtetit, është d thelbi i shtetit, pa të natyrisht që s’mund të ketë shtet. Dhe pastaj në letër aty ka edhe shumë gjëra jashtëzakonisht brengosëse, po i kisha përmendur vetëm disa. Për shembull, thuhet që EULEX-it njëfarë mënyre i jepet një kompetencë për ta zbatuar marrëveshjen, natyrisht të arritur mes Kosovës dhe Serbisë, dhe në letrën e Jahjagës ajo thotë që me pranimin e dypalshëm EULEX-i do t’i marrë këto kompetenca. Pra, nëse ka pranim të dypalshëm, por në këtë rast edhe pse nuk e shpjegon qartë a është pranimi i dypalshëm ndërmjet Kosovës edhe EULEX-it apo mes Kosovës dhe Serbisë, pra që të dyja duhet të pajtohen që EULEX-i ta marrë një kompetencë të caktuar ta zëmë ashtu.

Po në këtë rast, Presidentja e Kosovës po shërben si presidente e të dyjave, pra po thotë që kur të pajtohem ne të dy palët, ju mundeni ta merrni këtë, por kjo nuk është kompetencë e presidentes për të folur edhe për atë se çka po pajtohet Serbia apo jo, edhe nuk ishte dashur presidentja jonë të merrej me çka pajtohet Serbia ose jo.

E keni vërejtur aty që thuhet në letrën e Jahjagës edhe për gjykatën e veçantë kur flitet që edhe Gjykata Kushtetuese do të shkojë jashtë për çështjet që kanë të bëjnë me gjykatën ose me vendimet e gjykatës së veçantë.

Pra, gjatë viteve të '90-ta kishim qeverinë në ekzil dhe tash pak a shumë po e bartin gjyqësorin në ekzil pra, po e qesim gjyqësorin jashtë vendit. Nuk po di cila është me e keqe.

Ka ekzistuar një entuziazëm i madh, dorën në zemër, edhe te qytetarët e Kosovës se me ardhjen e EULEX-it gjërat do të përmirësohen. Pra, u tha edhe këtu që po qe se nuk e votojmë tribunalin atëherë gjërat nuk do të jenë më mirë, pra u supozua që do të jenë më keq. Por, dorën në zemër, me këto vendime po shihet që gjërat nuk po bëhen më mirë apo jo, sepse po të ishin bërë gjërat më mirë, atëherë EULEX-i do të shkonte duke u reduktuar e jo duke u shtuar.

Pra, kjo është vetë sinjal i qartë që gjërat nuk po bëhen më mirë dhe ky entuziazëm për luftën kundër korrupsionit që do ta bëjë EULEX-i u shumua edhe mediatikisht, edhe me opinionin publik me aktakuza apo hetime që i nisi prokurori Van Vestervik, prokurori holandez që e ndiqte Fatmir Limën si ish- ministër i Ministrisë së Infrastrukturës atëherë, dhe kjo pastaj u hesht.

Pra, nuk po flitet më për atë punë, nuk ekziston më ky entuziazëm. Është dëshmuar qartë që EULEX-i deri sot është marrë vetëm me rastet e krime të luftës, mbase ka nisur ndonjë farë hetimi për korrupsion, por ato hetime për korrupsion disi edhe po shkojnë duke u zbutur edhe po shkojnë drejt vyshkjes. Edhe kjo ndodh për mendimin tim, për një arsye shumë të qartë që e dimë të gjithë, por natyrisht ju edhe s'po guxoni fort për të folur që në fund te korrupsioni edhe një ndërkombëtar po del zakonisht, edhe rrjedhimisht po ndalen hetimet.

Prandaj, po përfundojnë këto që s'po përfundojnë, sepse, e pat përmendur edhe nuk qenka këtu deputeti Limaj tha që nëse më ndjekin për korrupsion, në njëfarë mënyre e tha kështu në "Rubikon" të KTV-së, atëherë unë do t'i qes edhe disa emra ku ka edhe ndërkombëtarë edhe vendorë të niveleve të larta të përzier, apo jo. Kështu pat thënë, fatkeqësisht nuk foli ma, mirëpo, kjo pastaj po dëshmohej që në fakt ka aty të vërteta.

Ka diçka aty që po e ndal këtë luftë kundër korrupsionit që në start dhe ajo është pikërisht edhe përfshirja e ndërkombëtarëve, veçanërisht po flas për aferat e mëdha të korrupsionit, pra jo për ato të voglat ku besoj ato janë prodhim qind për qind vendor.

Sa i përket mandatit të EULEX-it dhe ligjit të cilin po e trajtojmë ne këtu, përveç shkeljeve procedurale aty shihet qartë që në fakt ka edhe shkelje të ndryshme edhe të

Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Dhe në këtë drejtim konsideroj që ky Kuvend do të duhej ta kishte për të thënë tash dinjitetin minimal që të paktën kur shkelet Kushtetuta e këtij vendi, të mos e pranojë me kaq lehtësi siç po e pranon. A të thuhet që po bëhet pak më mirë ose që në Kosovë sot është më mirë se sa që ka qenë, e këtu jemi plotësisht dakord. Domethënë, natyrisht që sot është më mirë se sa që ka qenë në kohën e Serbisë, por kjo është prapë një shkarje, sepse po matet situata sot me pretendimet e Serbisë, pra me qëllimin e Serbisë. Serbia natyrisht e ka dashur Kosovën, pa njerëzit këtu, ka dashur t'i zhbëjë shqiptarët nga këtu, ta marrë Kosovën si territor edhe veçanërisht si pasuri. Po ky është qëllimi i Serbisë, këtë e dimë. E të thuash tash që Serbia nuk mundi ta realizojë këtë është për ta matur megjithatë gjendjen aktuale me pretendimet edhe kërkesat e Serbisë.

Po ekziston edhe një matje tjerë në këtë ndikim, pra ta matësh gjendjen aktuale me qëllimin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës edhe të dëshmorëve që e kanë dhënë jetën për këtë vend. E nëse e matë me këtë siç e matë Lëvizja "Vetëvendosje" atëherë natyrisht që këtu puna del jo bash mirë, sepse nuk po themi që nuk u krye kurgjë, po sasia e punës që nuk u krye është shumë më e madhe se sa e asaj që u krye. Pra, mos e matin Kosovën me kutin e Serbisë, mos mendoni sikur Serbia kur e këqyrni Kosovën. Mendoni sikur Ushtria Çlirimtare e Kosovës, mendoni sikur dëshmorët që e dhanë jetën për këtë vend, ashtu mund ta matim Kosovën. E Kosovën nuk e kanë paraparë ata me EULEX-sa e me tribunale e gjykata të veçanta. Pra, as ju nuk duhet ta parashihni si të tillë. Faleminderit !

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka të tjerë të paraqitur.

Zoti zëvendëskryeministër dhe ministër i Drejtësisë e keni fjalën, që në emër të Qeverisë ta përmbyllni debatin e sotëm lidhur me këtë.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Faleminderit, i nderuar nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

Anëtarë të Qeverisë,

Ndoshta edhe për hir të disa sqarimeve që u thanë këtu ka nevojë që të diskutohet, por dua t'i them edhe dy -tri gjëra kur flasim për drejtësinë në tërësi.

E para, si në veçanti për ata që fillojnë prej çështjeve të trajtimit, për zotin Topalli e kam mendjen këtu, në kuptimin më të mirë akademik të përfundojnë në fjalë të odave të burrave.

Por, ajo çka dua të them është që kur të flasim për drejtësinë, nëse ne në këtë Kuvend flasim për drejtësinë, për ndërtimin e politikave të drejtësisë, është kompetencë e jona dhe e juaja. Nëse flasim për drejtësinë, për funksionimin e saj ndërhyrjen në drejtësi, nëse ne diskutojmë këtu dhe nëse ju kërkon llogari nga Qeveria.

Besoj ata që e kanë lexuar prej Montes Skijes, Xhon Llokut e më tutje e dinë që pushtetet janë të ndarë. Dhe nëse thoni që Qeveria ka përgjegjësi për drejtësinë duhet t'i thoni disa fusha. A ka gjyqësori i Kosovës ligje të mira? Unë po ju them që po, më të mirat në rajon.

E dyta a ka buxhet të mjaftueshëm, unë ju them që po dhe po ju them që pagat mandatin që jemi ne i kemi bërë në nivel të ministrave.

Nëse thoni dhe bëni pyetje, a kanë emërimin dhe disiplinimin e tyre të pavarur nga Kuvendi dhe Qeveria, unë ju them po, asnjë nga ne nuk ka fuqi në këtë drejtim. Si e bëjnë punën, duhet ta pyetni dikë tjetër, jo Ministrinë, jo Qeverinë dhe aq më pak as Kuvendin.

Në anën tjetër, u përmend këtu çështja e kompetencave. Unë po ju them që është vendim dhe qëndrim politik për ata të cilët mendojnë që EULEX-si duhet të jetë në Kosovë apo nuk duhet të jetë. Dhe unë e kuptoj plotësisht cilindo grupim parlamentar edhe “Vetëvendosjen”, në kuptim me prezencën ndërkombëtare, dhe nuk ka asgjë të keqe, në përmbajtjen e ligjeve duhet të jemi të kujdesshëm, në veçanti ata që janë juristë. Të thuash që prokurorë të përhershëm në këtë vend, është vetëm prokurori i shteti, është gabim zonja Haxhiu.

Ne kemi dy lloj të prokurorëve, ata që e kanë mandatin fillestar trevjeçar dhe të dytit që e kanë mandatin e përhershëm dhe kjo e bënë mandatin tim si ministër i Drejtësisë dhe është garanci e plotë për pavarësi dhe jo vetëm ata, të gjithë prokurorët e Republikës së Kosovës. Dhe kjo nënkupton që përmendi zoti Hyseni që në Prokurorinë Speciale kërkohet një profesionalizëm pak më i lartë, jo me qenë fillestar, por duhet ta kenë kaluar fazën fillestare tri viteve dhe të punojnë në këtë drejtim.

E dyta, thuhet që EULEX-si do t’i emërojë gjyqtarët serbë, është gabim. Edhe gjyqtarët e EULEX-sit edhe prokurorët e EULEX-sit do të kalojnë përmes Këshillit Gjyqësor të Kosovës me dekret nga presidentja e Republikës dhe ky është ai autoriteti i sovranitetit tonë. Por, të mos mendojmë që 100/100 kemi për t’i kontrolluar ata qysh i kontrollojmë në kuptimin, qysh kontrollohen ata vendorët. Por çka dua me thënë. Gjyqtarët, autoritetet kompetente të EULEX-it asnjë kompetencë nuk e kanë në emërim, disiplinim gjyqtarëve vendorë dhe kur të them vendorë, kam parasysh serbë, shqiptarë, turq kushdo që mund të jetë ai. Pra, është një kontrabandim nëse mendohet që po bëjmë një veprim të tillë.

Dhe unë po ju them në marrëveshjen për drejtësinë, keni për t’u befasuar për të mirën që krejt numri i gjyqtarëve nuk do të kalojë atë që e kemi miratuar në Kuvendin e Kosovës, 15% të numrit të tërësishëm të gjyqtarëve të Republikës së Kosovës. Por ne kemi rreth 400 gjyqtarë shqiptarë e 300 serbë atëherë, mos thuaj çka bëhet, nuk është kjo e vërtetë, dhe nuk dua të luajmë pak me opinion.

Një sqarim që u tha edhe në pjesën paraprake. Ne do të kemi Prokurori Speciale, do të kemi prokurorë vendorë dhe do të merren edhe te EULEX-si, do të merremi me pesë çështje se njerëzit menduan që herën paraprake po përfundon, po e marr si sugjerim edhe të zotit Lladrovci, duhet ta pranoj këtë fakt. Nuk përfundon hetimi i krimeve të luftës me këtë gjykatë speciale që u bë sot, ose që u dha pëlqimi. Jo. Ajo merret me një çështje.

Dy gjëra po ju them, krimet e luftës nuk parashkruhen kurrë, cilido etnitet që mund të jetë.

Dhe e dyta, Prokuroria Speciale, pesë kompetenca kryesore që unë do të insistoj t'i ketë: korrupsionin e nivelit të lartë, krimin e organizuar, terrorizmin, shpëlarjen e parave dhe krimet e luftës, dhe këtu do të vazhdojnë edhe me serbë edhe me të tjerë.

Ne kemi dy probleme me serbë, problemin e parë e kemi që ata nuk janë fizikisht dhe Kodi jonë penal nuk lejon gjykimin e personave në mungesë dhe e dytë skemë marrëveshje për ekstradim prej Serbie. Këto janë çështje që duhet t'i kemi parasysh gjithnjë dhe kur flasim për sistemin e drejtësisë unë mendoj që duhet të kemi njohuri bazike për atë sistem.

E në kuptimin e asaj që thonë janë ndjekje nga EULEX-si, unë habitem pak me zotin Ymeri, me qëllim po i përmendi emrat. Thotë EULEX-si është dashur të bëjë punë më shumë, në anën tjetër kundër. Nëse je kundër je kundër për të gjitha çka i bën EULEX-si, por po ju them një pavarësi të sistemit të drejtësisë në vend.

A ka një vend të BE-së, jo të rajonit që janë ndjekur njerëzit e pushtetit më shumë se sa në Kosovë? Shikoni.

Dhe e dyta, sado që mund të jeni opozitarë tonë, cilido grupim politik, asnjëherë s'keni pasur arsye për të thënë që po na bën partia në pushtet, po na ndjek neve. Shikoni, kjo pavarësi e gjyqësorit dhe këto janë fakte që ne do t'i marrim. A është funksionaliteti i mirë, unë po ju them një, ligje më të mira në rajon kurrkush nuk ka. Unë po ju them që strukturën më të mirë s'e ka askush, unë po ju them që emërimin e kemi bërë të plotë, funksionaliteti është i tyre. S'mund të shkoj unë as ju për t'ua kryer punën atyre e t'u themi: hajde qysh po e bëni, qysh po i gjykoni. Kërkoni llogaridhënie për diku tjetër.

Dhe krejt në fund, ajo çka dua të them, në politikë jetohet me perceptime dhe ne mund ta kemi perceptimin për dikën këtu më të mirë, pak më të mirë ose më të dobët, por në drejtësi jetohet vetëm me fakte. Në drejtësi ata që kanë fakte duhet të shkojnë, filani kështu, filani kështu, nuk punohet në drejtësi, në drejtësi punohet vetëm me fakte dhe unë i ftoj gjyqtarët dhe prokurorët të ndikohen prej fakteve dhe prej kurrkujt tjetër.

Përndryshe, ky propozim është rezultat i arritjes së marrëveshjes, nuk është propozim i imi. Ne kemi negociuar për këto propozime, propozimi im me siguri do të ishte më i avancuar. Por edhe nëse i lexojmë ligjet, 2012 edhe sot, i kemi disa karakteristika.

E para, të gjitha institucionet vendore do të udhëhiqen nga vendorët. Tani t'i gjejmë njerëzit me autoritet, me integritet, me profesionalizëm t'i udhëheqin mirë.

E dyta, ata do të jenë pjesë e sistemit këtu dhe s'do të jenë shumicë kurrkund, të EULEX-i.

E treta, do ta pranojmë kompetencën ekskluzive që e përmendi zonja Haxhiu, nuk ka kompetencë ekskluzive dhe ekzekutive më gjyqtari dhe prokurori i EULEX-sit dhe ajo kompetencë ka qenë se në zhvillim e sipër me ta marrë rastin. Nga 15 prilli dhe tutje raste të re nuk mundet të bëjë ashtu, këto kanë qenë.

Unë mendoj që është bërë një solucion i mirë në mes të asaj për ta ushtruar sovraniteti më i mirë për ta shfrytëzuar ekspertizën e BE-së. A do të avancohemi më shumë? Me siguri që afrimi jonë si shtet, veprimet tona kërkojnë edhe këtë veprim.

Unë jam i bindur që Kosova e ka sistemin e drejtësisë më të mirë në rajon. Zoti Konjufca një herë ma ka bërë një vërejtje pse po e krahason me rajonin. Unë e them kështu. Në kuptimin shkencor krahasimet bëhen në mes llojeve të njëjta.

Në kuptimin sportiv edhe gara bëhet mes kategorive të njëjta, nuk lufton dikush ose boks nuk bënë dikush që i ka 50 kilogram me dikun 200. Por ajo çka dua të them, ne me rajon jemi më së miri. E them dhe besoj zoti Kurti e ka dëgjuar në prezencë ka qenë kur edhe ministri i Drejtësisë i Shqipërisë e ka pranuar një fakt të tillë. Nuk e ka nga inferioriteti ai, po unë besoj këtë na ka ndihmuar edhe bashkësia ndërkombëtare, se kemi bërë veç vetë. Por, unë besoj që e kemi krijuar një sistem të mirë. Mos ta injorojmë, jemi detyruar të bëjmë veprime që nuk janë të mira dhe ato detyrime ato veprime i bëjmë si rezultat që disa shtete nuk na kanë njohur, disa tjera kanë dilema dhe unë i quaj disa kemi edhe njohje të buta. Kemi shtete, kur them njohje të buta na kanë njohur si shtet, por nuk janë në gjendje të na avancojnë pakufishëm. Në këtë drejtim besoj që unë kam mirëkuptimin tuaj.

Dhe në fund shmangia e Rregullores për zonjën Haxhiu po e them, nuk është shkelje e Rregullores. Unë kam qenë, kam pas fatin të jem kryetar i Komisionit të Rregullores, rregullorja e parë në vitin 2001 që është bërë, me shumë kolegë këtu dhe dua të them që kemi paraparë me qëllim që Kuvendi në momente të caktuara mund të bëjë, a është mirë a keq politikisht e arsyeton secili prej neve, po shkelje nuk është.

Nëse dikush mendon që është kundër kushtetuese, zoti Ymeri, Gjykata Kushtetuese është organi që e tregon a është a s'është. Unë e ftoj secilin ta shfrytëzoj mënyrën ligjore.

Ne kemi ndërtuar mekanizma aq të mirë në Kosovë që edhe ai që e bën shkelje të përgjigjet, por edhe ai që supozon shkelje, dikush të ketë mekanizëm që t'i tregojë a ka bërë shkelje apo jo. Faleminderit!

KRYESUESI: Replikë, zoti Ymeri.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryesues!

Së pari mendoj që ekziston një shkarje logjike në atë që e thotë zëvendëskryeministri, duke iu referuar pra fjalës sime, sepse unë mund të jem njëkohësisht edhe kundër EULEX-it dhe t'i konstatoj kundërthëniet e brendshme brenda EULEX-it. Pra, unë shumë lehtë mund të them, po jam kundër EULEX-it, po edhe EULEX-i s'po e kryen punën, sepse EULEX-i është këtu, apo jo dhe rrjedhimisht unë kam të drejtë, madje- madje edhe obligim si deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës, gjë që do të duhej ta kishit edhe ju që ta analizoni edhe punën e EULEX-it se çka po bën dhe çka nuk po bën.

Unë e thashë që entuziazmi i ndërtuar, edhe nga ju, dorën në zemër, pra edhe nga Qeveria, po edhe nga subjektet tjera që e kanë pranuar EULEX-in, nuk po realizohet. Pra,

entuziazmi te qytetarët edhe ky flamuri i madh me të cilin ka ardhur EULEX-i, do ta luftojmë korrupsionin, në fakt nuk po realizohet. Pra, ose të vijmë në përfundimin që s'paska korrupsion, krejt kjo paska qenë gënjeshtër, që besoj se zëvendëskryeministri do të kishte pasur dëshirë kështu të thuhet, ose EULEX-i nuk po funksionon në rolin e vet që e ka pasur ose që ka thënë do ta ketë si rol primar.

E dyta është që ju po thoni që kemi sistemin shumë të mirë juridik, apo jo se e thatë ashtu, domethënë, është funksional, i kemi ligjet më të mira në rajon, e kemi edhe sistemin i cili është plotësisht i pavarur, po funksionon tamam sipas parimit të Monte Skijes e kështu me radhë. Atëherë çfarë nevojë ka për EULEX-in, pse po e ftoni pra EULEX-in?

Mendoj se kjo është shpërputhje me atë që po veproni dhe që po e thoni. Nëse është kaq mirë, pse po na duhet EULEX-i, t'ia çojmë EULEX-in dikujt që e ka pak punën më keq, t'u ndihmojmë, për shembull Norvegjisë, Suedisë, e besoj se më mirë se ata i paskemi punët. Pra t' u ndihmojmë atyre, pse po e marrim, pse po bëhemi egoistë të marrim edhe diçka dhe t' ia shtojmë asaj të mirës tonë. Mendoj se këtua është gabim që po thoni.

Dhe, e treta, që po dua ta përfundoj me këtë, nuk është e vërtetë që nuk e keni përndjekur, keni përndjekur Lëvizjen "Vetëvendosje" si opozitë shumë më shumë se sa që ishte kanë dashur për ta përndjekur, apo jo, pra edhe me polici edhe me gjyqësi edhe me të gjitha tjerat. Nuk është që nuk e keni përndjekur, dhe ju e dini këtë. Që ku e ke ministrin Rexhepi kur ka dalë u ka thënë policëve: "hiqmini këta prej këtu" - deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës duke tentuar të hyjnë në....

(Ndërprerje nga regjia.)

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Kuçi, kundër-replikë. Mos përmend emra, nëse mundesh.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Po e bëjmë pak më atraktive. Shiko, zoti Ymeri, unë po e them kështu. Unë i kuptoj njerëzit, ndoshta edhe unë nganjëherë, i kuptoj njerëzit që pa e dëgjuar mendimin e tjetrit, e kanë përgjigjen nga vetja.

Dhe unë po ta them kështu, nuk e thashë që është funksional. Merre transkriptin, dhe unë thashë, kemi strukturë, kemi ligje, i kemi emëruar, por funksional duhet të jetë më mirë. Merre transkriptin, dhe nëse nuk dalin këto fjalët e mia, pastaj bisedojmë.

E dyta, çka desha të them. Suedia e Norvegjia nuk kanë nevojë për EULEX, por vendet e rajonit, besoj më shumë se ne. Dhe, unë e krahasova me rajonin. Dhe, unë jam i bindur që me punën që e bëjmë, bashkërisht me ata, e bëjmë një hap më tutje. Nëse më pyet mua personalisht, unë kisha pasur dëshirë për ta ushtruar sovranitetin qind për qind dhe unë e di, e kam përdorur një herë një thënie të zotit Ahtisari. Ai e ka thënë kështu: "misionet e huaja ndërkombëtare janë si cigarja. Kur e pi njeriu në fillim i duket që po e qetëson, më vonë bën efekte anësore, dikur bëhesh i varur prej tyre". Unë s'kam dëshirë të jem i varur prej tyre. Vendi im nuk duhet me qenë i varur.

E treta, dhe e fundit, duhet ta them, asnjëherë, kur thuash, ti e din mirë, s'i kemi ndjekur asnjë anëtar as s'jemi marrë me ato punë. Dëgjo. Ka emra të përveçëm dhe të përgjithshëm, zoti Ymeri. Bile me bë me fol unë, del që ju kemi ndihmuar. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka tjerë të paraqitur. Të nderuar deputetë, bazuar në vendimin paraprak për shmangien nga Rregullorja e punës së Kuvendit, neni 84 për shqyrtimin e parë të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që ndërlidhen me mandatin e misionit të Bashkimit Evropian për sundimin e ligjit në Republikën e Kosovës, vazhdojmë me votimin e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që ndërlidhen me mandatin misionit të Bashkimit Evropian për sundimin e ligjit në Republikën e Kosovës.

Konstatohet se në sallë janë 107 deputetë, që është numër i mjaftueshëm për procedim. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë tani:

Konstatohet se me 85 vota për, 14 kundër dhe 4 abstenime, Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që ndërlidhen me mandatin e misionit të Bashkimit Evropian për sundimin e ligjit në Republikën e Kosovës.

Kërkohet nga Komisioni për Legjislacion që në pajtim me vendimin e Kuvendit ta shqyrtojë projektligjin dhe Kuvendit t'i paraqet raportin me rekomandime për seancën e pas ditës. Pra, në orën 16:00 fillon seanca e pasdites. Faleminderit!

*E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*